



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Tretë Specializime Afatgjata
në “Gjinekologji dhe Obstetrikë”
ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë
Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Irena Kola
2. PhD. Juljana Xhindoli

Mars 2025

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Specializime Afatgjata në “Gjinekologji dhe obstetrikë” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Zoja e Këshillit të Mirë” (UKZKM)”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” (UKZKM)
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Kirurgjike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Studime Specializuese Afatgjata në “Gjinekologji dhe obstetrikë”
4	Urdhëri/ VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 678, datë 29.12.2017
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditohet për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i tretë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	300 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Italisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Universitetin e Romës “Tor Vergata”
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Në bashkëpunim me Universitetin e Romës “Tor Vergata”
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 8
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit:	30 PAE/ 8 PAK
18	Numri i studentëve:	21 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Specializim afatgjatë në "Gjinekologji dhe Obstetrikë" është organizuar nga IAL, Universiteti "Zoja e Këshillit të Mirë" (UKZKM) në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata", në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë".

Programi i studimit Specializim afatgjatë në "Gjinekologji dhe Obstetrikë" është hapur me Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 107 (118), datë 10.11.2017 (15.12.2017) dhe me Dekretin e Ministrisë Nr.664 (678), datë 29/12/2017. "Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë, Programe Specializimi"

Programi i Specializimit në "Gjinekologji dhe Obstetrikë" zhvillohet nga Departamenti i Shkencave Kirurgjike, Fakulteti i Mjekësisë, dhe zgjat pesë vjet. Ky program ofron formim teorik dhe praktik që zhvillohet njëkohësisht në një universitet të akredituar dhe në një institucion spitalor apo institucion shëndetësor të akredituar, për të arritur njohuritë e nevojshme kulturore dhe aftësitë profesionale.

Programi i Specializimit në Gjinekologji dhe Obstetrikë ka si qëllim zhvillimin e aftësive teorike, shkencore dhe praktike të specialistëve, duke ofruar një trajnim të plotë dhe multidisiplinar. Specialistët fitojnë njohuri të thelluara në patofiziologji, anatomi kirurgjikale dhe teknika të avancuara kirurgjikale, duke u përqendruar në menaxhimin e situatave emergjente, ndërhyrjet komplekse dhe kujdesin e integruar të pacientit. Programi vë theks të madh në praktikën klinike, kërkimin shkencor dhe bashkëpunimin ndërdisiplinor, duke përgatitur mjekët për të arritur standardet e larta, si në nivel kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar.

Objektivi kryesor i arsimit universitar ka qenë gjithmonë sigurimi i cilësisë dhe përputhshmërinë me standardet e Bashkimit Evropian. Ky qëllim është arritur përmes ndërkombëtarizimit dhe bashkëpunimit të ngushtë me Universitetin e Romës "Tor Vergata", një partner historik dhe i akredituar nga Ministria e Arsimit dhe Kërkimit i Italisë (MIUR), që garanton cilësinë ndërkombëtare të programit.

Nevoja e tregut për Specialist në Gjinekologji dhe Obstetrikë mbetet evidente në vendin tonë, duke patur një përqendrim më i madh i mjekëve të specializuar në gjinekologji dhe obstetrikë është në Tiranë dhe mungesa në rrethe.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm Për Programin e studimit Specializime Afatgjata në “Gjinekologji dhe obsetrikë” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti “Zoja e Këshillit të Mirë” (UKZKM)” është bërë nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) i ngritur nga ASCAL me 14.10.2024, Nr.293/1 prot. i cili ka përgatitur Raportin në përputhje me rubrikat e parashikuara në modelin e RVJ të hartuar nga ASCAL dhe miratuar nga Bordi i Akreditimit.

GVJ u njoh dhe shqyrtoi dosjen e vetvlerësimit duke u ndalur tek Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe evidencat përkatëse. Për të realizuar një vlerësim të plotë të dokumentacionit RVB dhe evidencave të ofruara nga institucioni, për të evidentuar konkretisht realizimin e standarteve dhe kritereve të programit, GVJ zhvilloi një vizitë dy ditore në datat 18 e 19 Nentor 2024 në institucionin Universiteti “Zoja e Këshillit të Mirë” (UKZKM).

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm është hartuar duke u bazuar në analizën e të dhënave të mbledhura nga drejtuesit e programit, personelin akademik (të plotë dhe të pjesshëm), anketat e studentëve, programet mësimore, personelin e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, zyrën e burimeve njerëzore, stafin për këshillimin e karrierës dhe kërkimin shkencor, regjistrat në sekretarinë mësimore, si dhe analizën e infrastrukturës mbështetëse (sallat e leksioneve, seminarëve, praktikave, biblioteka me literaturën përkatëse, etj).

Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof. Irena Kola dhe PhD. Juljana Xhindoli.

Gjatë këtij procesi vlerësimi GVJ është asistuar nga Msc. Arbri Ndreka dhe Msc. Aviola Bardhi, Koordinator Teknike të ASCAL.

Më datë 27.02.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 34/3 Prot., datë 28.02.2025, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” kthehu përgjigje më datë 11.03.2025 me shkresë zyrtare Nr. 374/7, datë 10.03.2025.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Tretë Specializime Afatgjata në “Gjinekologji dhe Obstetrikë”

I. KUADRI I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT SPECIALIZIM AFATGJATË

Standardi I.1	
Programi i studimit i ciklit të tretë Specializim afatgjatë në fushën e mjekësisë ofrohet nga institucione të arsimit të lartë që përmbushin kriteret ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Programi i specializimit afatgjatë ofrohet nga institucione me statusin universitet, i akredituar në Republikën e Shqipërisë.	Programi i specializimit afatgjatë ofrohet nga Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 670, datë 28.09.2011 dhe Akreditim Institucional nr. 112 del 15.12.2017, nga Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) në bashkëpunim me British Accreditation Agency (QAA) (Evidence 2) (Evidence 3) (Evidence 9) Evidence 2 - VKM nr. 670, datë 28.09.2011 Për ndryshimin e emërimit.pdf Evidence 3 - Vendimi nr.118 date 15.12.2017 Bordit te Akreditimit per Hapjen e SPA Gjinekologji dhe obstetrikë.pdf Evidence 9 - Certificate Akreditimi Institucional nr112 dt 15,12,2017.pdf
Kriteri 2: Programi i specializimit afatgjatë që ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit të jenë të akredituara në vendin e origjinës.	Programi i specializimit afatgjatë në “Gjinekologji dhe Obstetrikë” ofrohet në bashkëpunim me universitetin partner, Universitetin e Romës "Tor Vergata", i cili është i akredituar nga Ministria e Arsimit, Universitetit dhe Kërkimit (MIUR) dhe nga Agjencia Kombëtare e Vlerësimit të Sistemit Universitar dhe Kërkimit, ANVUR. (Evidence 5) (Evidence 10) (Evidence 6) Evidenza 10 - https://www.anvur.it/attivita/ava/accreditamento-periodico/linee-guida-per-laccreditamentoperiodico/rapporti-anvur-di-accreditamento-periodico/ Evidence 5 - Marrëveshje Kuadër bashkëpunimi UniZKM me Universitetin e studimeve në Romë Tor Vergata.pdf Evidence 6 - Link.pdf
Kriteri 3: Programi i specializimit afatgjatë hartohet nga njësitë bazë përgjegjëse/shërbimet përgjegjëse te institucionit nëpërmjet procedurave të brendshme transparente dhe miratohet në përputhje me statutin, rregulloren dhe aktet e tjera organizative të institucionit.	Grupi i monitorimit pas vlerësimit të dokumentacionit vëren se Programi i Specializimit afatgjatë në “Gjinekologji dhe Obstetrikë” është hartuar nga Departamenti i Shkencave Kirurgjike, në përputhje me statutin dhe duke u mbështetur në rregulloren e Specializimeve (Evidence 12), si edhe të standarteve europiane, bazuar në marrëveshjen me Universitetin “Tor Vergata” Romë. Evidence 12 - Rregullore e programit te studimit SPA ne Mjekesi,ne UKZKM,2023.pdf
Kriteri 4: Programi i specializimit afatgjatë përfshin formim teorik e praktik në fushën e specialitetit, i cili realizohet njëkohësisht në një universitet të akredituar, dhe në një institucion spitalor ose në një	Programi i Specializimit afatgjatë në "Gjinekologji dhe Obstetrikë" ofron një formim të kombinuar teorik (20%) dhe praktik (80%), i cili zhvillohet në një universitet të akredituar dhe në institucione spitalore të licencuara. Programi ka një kohëzgjatje prej pesë vjetësh duke synuar zhvillimin e aftësive profesionale dhe njohurive të nevojshme. Nga evidentimi i marrëveshjeve institucionale vërejmë se Programi i specializimit në "Gjinekologji dhe Obstetrikë" zhvillohet në struktura të akredituara, duke

institucion shëndetësor të akredituar nga institucioni shtetëror përgjegjës për akreditimin e institucioneve shëndetësore. Institucionet i arsimit të lartë duhet të kenë zhvilluar dhe akredituar/riakredituar programet e integruara të ciklit të dytë në fushën e mjekësisë në momentin e ofrimit të një programi të ciklit të tretë.	përfshirë spitale dhe klinika të lidhura me universitetin. Disa nga këto institucione janë Spitali Amerikan, Spitali Rajonal i Durrësit, dhe Qendra Universitare Obstetrike Gjinekologjike "Koço Gliozheni", si dhe disa spitale dhe institucione ndërkombëtare, përfshirë Spitalin M.G. Figlie di San Camillo G. Vannini në Romë dhe Spitalin e Madh "Bianchi Malacrino Morelli", duke siguruar përmbushjen e standardeve të cilësisë dhe legjislacionit në fuqi. (Evidencë 32) Evidenza 32 - http://asck.gov.al/lista-e-institucioneve-te-akredituara-nga-asck/			
Kriteri 5: Programi i specializimit afatgjatë kryhet me kohë të plotë dhe përfshin pjesëmarrjen në veprimtaritë mjekësore të departamenteve/shërbimeve ku ofrohet formimi, në përputhje me procedurat e përcaktuara dhe nën mbikqyrjen e autoritetit apo entit përgjegjës.	Programi i specializimit ofron një trajnim teorik dhe praktik në fushën përkatëse, i cili realizohet në strukturat e Universitetit UKZKM, si dhe në institucionet klinike dhe spitalore publike dhe private, të cilat kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me universitetin. Universiteti ka krijuar partneritete me institucione publike dhe private për realizimin e programeve afatgjata të specializimit në fushën e mjekësisë dhe për zgjerimin e rrjetit të tij të bashkëpunimit. Strukturat që kanë lidhur marrëveshje me UKZKM, që janë bërë pjesë e këtij rrjeti dhe për të menaxhuar programet e specializimit, sigurojnë nëpërmjet marrëveshjeve duke zbatuar standardet kombëtare të cilësisë dhe legjislacionin në fuqi. Grupi i monitorimit ka evidentuar marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione publike dhe private, të cilat përfshijnë: 1. Qendra Universitare Obstetrike Gjinekologjike Koço Gliozheni, Tiranë (Evidencë 13) 2. Spitali Rajonal i Durrësit, Durrës (Evidencë 14) 3. Spitali Amerikan, Tiranë (Evidencë 14.1) 4. Universiteti i Romës "Tor Vergata" (Evidencë 5) 5. Spitali M.G Figlie di San Camillo G. Vannini, Romë (Evidencë 15) 6. Eurosanità S.p.a Policlinico Casilino, Romë (Evidencë 16) 7. IGreco Ospedale Riuniti (Evidencë 17) 8. Spitali i Madh "Bianchi Malacrino Morelli" (Evidencë 18) 9. Poliklinika e Barit (Evidencë 19) 10. Fondazione Leonardo (Evidencë 20)			
Konkluzione	Bazuar në të dhënat e evidentuara shprehet se Universiteti "Zoja e Këshillit të Mirë" ka arritur të përmbushë kërkesat për cilësinë e arsimit dhe zhvillimin e programeve të specializimit, përfshirë krijimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të akredituara dhe përputhjen me standardet e arsimit të lartë ndërkombëtar. Programi i specializimit në "Gjinekologji dhe Obstetrikë" zhvillohet në struktura të akredituara dhe është mbështetur nga partneritete me spitale dhe institucione mjekësore, si dhe nga bashkëpunimi me universitete prestigjioze italiane, që përforcon cilësinë dhe përputhshmërinë me kërkesat e legjislacionit të arsimit dhe shëndetësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit specializim afatgjatë në mjekësi ofrohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1: Programi i studimit specializim afatgjatë hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të strategjisë së zhvillimit të institucionit.	Programi i studimit për specializimin afatgjatë zhvillohet dhe ofrohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit. Sipas nenit 9 të Statutit, Universiteti KZKM vepron në përputhje me rregullat e sistemit ligjor shqiptar dhe përmbush misionin e tij, duke realizuar aktivitetet brenda kuadrit të sistemit universitar kombëtar dhe rajonal (<i>Evidencë 21</i>). Universiteti ka bashkëpunime me institucione të arsimit të lartë dhe menaxhon autonomisht çdo marrëdhënie të lidhur me këtë bashkëpunim. Për realizimin e programeve mësimore, formuese dhe kërkimore, që mbulojnë fushat e ndryshme të ekspertizës së stafit akademik, Universiteti përgatit dhe implementon projekte shkencore dhe kërkimore, në partneritet me palë të treta, duke mbështetur zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të Shqipërisë, Ballkanit dhe Bashkimit Evropian.			
Kriteri 2: Programi i specializimit afatgjatë ka të përcaktuara qartë emërtimin, organizimin, strukturën, përmbajtjen, qëllimin dhe objektivat e tij, të harmonizuara me ato të institucionit/ institucioneve ofrues, në përputhje dhe me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve	Në këtë kuadër, programi i studimit i ofruar nga Universiteti Katolik ZKM, Specializim Afatgjatë në Gjinekologji dhe Obstetrikë, është i harmonizuar në përputhje me Statutin, Rregulloren e Fakultetit (<i>Evidencë 22</i>) dhe i përshtatur me strukturën e programeve të ngjashme që zhvillohen në vendet e BE-së, në përputhje me direktivat e BE-së për profesionet specifike, si dhe me standardet e cilësisë të përcaktuara në Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 824, datë 24.12.2021 Plani mësimor dhe literatura e përdorur synon ruajtjen e vlerave, të kulturës kombëtare dhe ndërkombëtarizimin, duke përfshirë mësimdhënien në gjuhën italiane, që gjithashtu kontribuon në përhapjen e kulturës evropiane në Shqipëri. Ky është një tregues i angazhimit të Universitetit për të ofruar arsim cilësor dhe formim profesional në përputhje me standardet evropiane, me qëllim mbështetje dhe përshpejtim të integritetit të arsimit universitar shqiptar në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë. Evidence 21 - Statuti i Universitetit.pdf Evidence 22 -Rregullore e Fakultetit të Mjekësisë.pdf			
Konkluzione	Universiteti Katolik ZKM ka arritur një nivel të kënaqshëm të përmbushjes së standardeve të cilësisë për programin e specializimit afatgjatë, duke vepruar në përputhje me ligjin, strategjinë e zhvillimit të tij dhe bashkëpunimin me institucione të arsimit të lartë të akredituara drejt ndërkombëtarizimit. Programi i studimit në Gjinekologji dhe Obstetrikë, është i harmonizuar me Statutin dhe Rregulloren e Fakultetit, duke kontribuar në ruajtjen e kulturës kombëtare dhe përhapjen e kulturës evropiane. Ky angazhim i Universitetit për të ofruar një arsim cilësor dhe formim profesional të nivelit evropian është një hap i rëndësishëm në mbështetje të integritetit të arsimit universitar shqiptar në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3				
Programi i studimit specializim afagjitë synon të plotësojë nevojat aktuale që ka vendi për specialistë në fushën e mjekësisë.				
Kriteret		Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1: Programet e studimeve specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë synojnë të plotësojnë kërkesat e tregut të punës në përputhje me nevojat për specialistë në fushën e mjekësisë.		Në studimin paraprak të realizuar nga Institucioni, vërehet se tregu i punës ka nevoja reale për specialist në Gjinekologji dhe Obstetrikë, një nevojë në rritje duke pasur parasysh edhe përqendrimin e specialistëve kryesisht në Tiranë dhe nevojën e mjekëve të tjerë për të mbuluar zonat e tjera të vendit. Krahësuar me vendet e tjera, Shqipëria ka një numër të ulët të gjinekologëve për 100,000 banorë, dhe është evidente që ka një nevojë për rritjen e numrit të specialistëve të këtij sektori. Duke marrë parasysh emigrimin e lartë të mjekëve dhe nevojën për të mbuluar boshllëqet në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, është e domosdoshme të ofrohen mundësi specializimi dhe të sigurohen kushte për të mbajtur mjekët e trajnuar në vend. Mendojmë se programi i Specializimit në “Gjinekologji dhe Obstetrikë” është një përgjigje e domosdoshme për këtë kërkesë, duke ofruar mundësi për zhvillimin e aftësive të mjekëve dhe sigurimin e një nivele të lartë cilësie në shërbimet shëndetësore. (Evidencë 23) (Evidencë 27) (Evidencë 28) (Evidencë 29) (Evidencë 35) Evidence 21 - Statuti i Universitetit.pdf Evidenza 27 - https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/434 Evidenza 28 - https://www.urdhrimjekeve.org.al/regjistri-i-mjekeve.html Evidence 35 - Studimi i Tregut.pdf		
Kriteri 2: Numri i përgjithshëm i specializantëve dhe numri i atyre që e ndjekin këtë program studimi çdo vit përcaktohet në përputhje me politikat shtetërore të zhvillimit të fushës së shëndetësisë dhe kapacitetet pritëse të strukturave të përfshira në rrjetin formues (në varësi të numrit të personelit, kapaciteteve pritëse, etj).		Grupi i vlerësimit të jashtëm, duke u bazuar në të dhënat e evidentuara si edhe gjatë vizitës në institucion, shprehjet se numri total i kuotave për programin e Specializimit në “Gjinekologji dhe Obstetrikë” përcaktohet çdo vit me Vendim të Senatit Akademik, me propozim të Fakultetit të Mjekësisë duke u bazuar në strukturat në dispozicion dhe me miratim nga MAS në përputhje me politikat e zhvillimit shëndetësor të vendit.		
Konkluzione		Bazuar në faktorët si rritja e nevojës së tregut të punës për specialist në këtë fushë, boshllëku i krijuar nga emigrimi i lartë i mjekëve, Strategjia e Ministrisë së Shëndetësisë për zhvillimin e sektorit të shëndetësisë në Shqipëri për rritjen e numrit të specialistëve dhe krijimin e mundësive të trajnimeve/specializimeve për mjekët në vend. Bazuar në këto faktorë, mendojmë se krijimi dhe ofrimi i Programit të Specializimit në Gjinekologji dhe Obstetrikë është një përgjigje e domosdoshme për këto nevoja dhe do të ndihmojë në mbështetjen e sistemit shëndetësor, duke siguruar një numër të mjaftueshëm dhe të kualifikuar të specialistëve për të përmbushur kërkesat e tregut të punës.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
				X

Standardi I.4**Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Programi i specializimit afatgjatë përfshin formim teorik e praktik në fushën e specialitetit, i cili realizohet njëkohësisht në një universitet të akredituar dhe në një institucion spitalor ose në një institucion shëndetësor të miratuar dhe akredituar për këtë qëllim nga Ministria përgjegjëse për shëndetësinë.	Programi i Specializimit afatgjatë është i ndërtuar mbi bazën e sistemit European të Transferimit të Krediteve dhe në përputhje me statutin e IAL dhe legjislacionin Shqipëtar në fuqi. Programi përbëhet nga 80% e krediteve (ECTS) nga aktivitete klinike profesionale, dhe 20% formim teorik të shpërndara në 5 vite studimi, sipas një planit mesimor të caktuar paraprakisht në fillim të programit të studimit. Plani mesimor ka në total 300 kredite, 60 kredite cdo vit akademik, 74 lëndë/ module të ndara specifikisht sipas lëndëve përkatëse dhe viteve të studimit. Programi teorik zhvillohet nga institucioni i akredituar Universiteti "Zoja e Këshillit të Mirë" (Vendim nr 112, 15/12/2017) dhe programi praktik zhvillohet në institucione shëndetësore spitalore, publike dhe private, të akredituara nga Ministria e Shëndetësisë dhe në përputhjen me standardet e arsimit të lartë. Pjesë e rrjetit për të menaxhuar programin praktik të specializimit janë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkombëtare me një sërë spitalesh në Itali, si një hap i rëndësishëm në mbështetje të integritetit të arsimit universitar shqiptar në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë. (Evidencë 31) (Evidencë 9) (Evidencë 32)
Kriteri 2: Programi i specializimit afatgjatë kryhet me kohë të plotë dhe përfshin pjesëmarrjen në veprimtaritë akademike, klinike/ diagnostikuese të departamenteve dhe/ ose shërbimeve ku ofrohet formimi, në përputhje me rregulloren e programeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.	Grupi i vlerësimit të jashtëm, pas vizitës në institucion edhe takimit me studentët e degës, shprehet se programi i specializimit afatgjatë kryhet në përputhje me rregulloren e Specializimit dhe planin mesimor, me kohë të plotë, duke përfshirë si lëndët e përgjithshme dhe lëndët e specialitetit. Specializantët u shprehën se kanë patur mbështetje të plotë për realizimin e programit praktik, si në spitalet publike/ private në Shqipëri edhe ato në Itali. Përvojat klinike/ praktike realizoheshin me rotacion sipas programit praktik të dokumentuara në librezën e studentit, procedurat e ndryshme mjekësore dhe shkalla e autonomisë së tyre, varionin nga një veprimtari në mbikëqyrje të plotë nga tutori deri tek një veprimtari e kryer në pavarësi të plotë. Specializantët ndjekin programin praktik në departamente dhe shërbime të ndryshme, si dhe ndjekin veprimtarinë mesimore dhe akademike nën mbikëqyrjen e udhëheqësve akademikë dhe pedagogëve, në përputhje me planin mesimor dhe rregulloren e programit. Raporti i lëndëve të përcaktuara në programin e specializimit afatgjatë përbëhet nga: 60% lëndë specifike të programit të specializimit, 30% lëndë karakterizuese të fushës ku bën pjesë programi specializues, 5% lëndë të formimit bazë, lëndë ndërdisiplinore ose plotësuese dhe 5% për provimin përfundimtar. Aktivitetet e detyrueshme të formimit profesional për përvetësimin e aftësive specifike vlerësohen në përfundim të çdo viti akademik, ku organizohet provimi vlerësues teorik dhe praktik, i cili vlerësohet me notë nga një komision prej 5 anëtarësh. Evidence 9 - Certificate Akreditimi Institucional nr112 dt 15,12,2017.pdf Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, në UKZKM, 2023.pdf
Konkluzione	<i>Programi i Specializimit afatgjatë në Gjinekologji dhe Obstetrikë i ofruar nga Universiteti "Zoja e Këshillit të Mirë" ka një përmbushje të</i>




	konsiderueshme të standardeve të kërkuara, duke iu përmbajtur rregullave të sistemit të Arsimit të Lartë në Shqipëri dhe atij europian. Programi është i strukturuar sipas sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS), dhe ndjek një plan mësimor të detajuar që përfshin 80% aktivitete klinike dhe 20% formim teorik, duke siguruar një balancë të mirë mes njohurive teorike dhe praktikës klinike. Programi i specializimit siguron mundësi për studentët të zhvillojnë aftësi klinike në institucione të akredituara, duke përfshirë spitalet publike dhe private në Shqipëri, si dhe një rrjet ndërkombëtar spitalësh në Itali, duke kontribuar kështu në përgatitjen e specialistëve të nivelit të lartë që përmbushin standardet ndërkombëtare. Vlerësimi i përgjithshëm i programit tregon një përputhshmëri të mirë me legjislacionin shqiptar dhe me praktikën më të mirë të arsimit të lartë, duke siguruar që studentët të zhvillojnë aftësi dhe njohuri të nevojshme për të përballuar kërkesat e tregut të punës dhe për të kontribuar në përmirësimin e sistemit shëndetësor kombëtar dhe ndërkombëtar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5

Programi i studimit i ciklit të tretë specializim afatgjatë në fushën e mjekësisë synon të plotësojë nevojat që ka vendi për specialistë në fushën e mjekësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Për hartimin e programit të specializimit afatgjatë, njësia bazë përgjegjëse/shërbimi përgjegjës, kryen studime dhe analiza mbi situatën, zhvillimet, nevojat, prioritetet në fushën e përgjithshme dhe specifike të programit dhe/ose të politikave shtetërore të zhvillimit të fushës së shëndetësisë, të cilat bëhen pjesë e projekt propozimit përpara hapjes së programit.	GVJ në takimin e realizuar në institucion me drejtuesit dhe evidencave në dispozicion konfirmon se Programi i specializimit afatgjatë në “Gjinekologji dhe Obstetrikë” është i hartuar nga specialistë me experience në të njëjtën fushë në universitete të njohura në BE (Universiteti i Romës “Tor Vergata”), pjesë të Departamentit të Shkencave Kirurgjike, në Fakultetin e Mjekësisë, në përmbushje të misionit të Universitetit. Misioni i Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, qëndron në koherencë me nevojat e zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor të vendit, duke: • Siguruar nivele cilësore të arsimit për të regjistruarit e tij dhe të formojë specialistët dhe profesionistët e rinj sipas standardeve evropiane për të mbështetur zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor të shoqërisë sonë dhe përparimin e arsimit universitar dhe kërkimit shkencor në nivel kombëtar. • Mbështetur prioritetet strategjike dhe interesat zhvillimore të vendit • Promovuar bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e arsimit. Programi është përgatitur sipas standardeve Shtetërore të Cilësisë për Specializimet Afatgjata të përshtatura me strukturën e programeve të ngjashme që zhvillohen në vendet e BE-së, në përputhje me direktivat e BE-së për profesionet specifike, si dhe me standardet e cilësisë të

	përcaktuara në Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 824, datë 24.12.2021. Programi është hapur pas një vlerësimi të nevojave të tregut të punës, i cili është realizuar fillimisht nga Zyra e Orientimit të Karrierës së Universitetit dhe ka vazhduar gjatë fazës së akreditimit. Ky vlerësim ka treguar se ka një kërkesë të madhe për specialistë të kualifikuar në këtë fushë, për të mbështetur zhvillimin e sektorit dhe për t'iu përgjigjur kërkesës gjithnjë në rritje për kompetenca shkencore në këtë fushë të Mjekësisë, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Evidence 5 - Marrëveshje Kuadër bashkëpunimi UniZKM me Universitetin e studimeve në Romë Tor Vergata.pdf Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, ne UKZKM, 2023.pdf Evidence 34 - Addendum i Protokollit Ekzekutiv.pdf Evidence 35 - Studimi i Tregut.pdf
Kriteri 2: Programi i specializimit afatgjatë ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e specialistëve në fushën e mjekësisë me njohuri të thelluara kërkimore, si dhe aftësi dhe kompetenca klinike/diagnostikuese në fushat përkatëse të mjekësisë, në përputhje me kërkesat dhe nevojat që ka vendi.	GVJ në takimin e realizuar në institucion me drejtuesit dhe studentët, konfirmoi se janë zbatuar plotësisht objektivat afatgjatë të përcaktuara në programin e formimit dhe planin mësimor. Duke përfshirë objektivat formuese bazë me përvetësimin e njohurive të thelluara teorike bashkë me aftësitë përkatëse të aplikueshme klinike- praktike, objektivat e fushës së specializimit për të përvetësuar njohuri gjithnjë e më të thelluara, objektivat plotësues për të diagnostikuar dhe trajtuar edhe në mënyrë kirurgjikale, patologjite e kompetencave të specializuara, si edhe veprimtaritë profesionale të detyrueshme që synojnë zhvillimin e kompetencave të plota specifike profesionale të mjekut obsetër gjinekolog në përputhje me nevojat që ka vendi. Evidence 27 - Link.pdf https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/434 Strategjia Kombëtare E Shëndetësisë 2021-2030 evidence 31 - Plani Mesimor.pdf Evidence 33 - Prezantim i Programit të specializimit.pdf
Kriteri 3: Programi i specializimit afatgjatë hartohet dhe harmonizohet me programe të ngjashme të ofruar nga institucione partnere vendase apo të huaja, udhëzues, direktiva të BE, të institucioneve dhe organizmave ndërkombëtare me të cilat është partner apo bashkëpunon vendi ynë.	Programi i specializimit afatgjatë në "Gjinekologji dhe Obstetrikë" ka si qëllim kryesor formimin e specialistëve me njohuri të thelluara shkencore dhe aftësi klinike në këtë fushë, duke përmbushur kërkesat dhe nevojat e sistemit shëndetësor në vend. Ndërkombëtarizimi dhe partneriteti shihen si një nga fushat strategjike të Institucionit. Për të realizuar këto qëllime dhe për të optimizuar procesin e formimit, programi mbështetet në bashkëpunimin ndërkombëtar me Universitetin e Romës "Tor Vergata", nëpërmjet një marrëveshjeje mes dy institucioneve. Ky bashkëpunim lejon harmonizimin e programit të specializimit me ofertën arsimore të universitetit partner, përshtatjen me standardet dhe direktivat e Bashkimit Evropian dhe rritjen e mundësive për shkëmbim dhe përfshirje të specialistëve të huaj në aktivitetet akademike, siç është përcaktuar edhe në Shtojcën e Protokollit Ekzekutiv të datës 17.05.2017. Evidence 34 - Addendum i Protokollit Ekzekutiv.pdf Evidence 5 - Marrëveshje Kuadër bashkëpunimi UniZKM me Universitetin e studimeve në Romë Tor Vergata.pdf Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, ne UKZKM, 2023.pdf

	Evidence 35 - Studimi i Tregut.pdf
Kriteri 4: Me qëllim rritjen e bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar, mobilitetit dhe përfshirjen në veprimtaritë akademike të programit edhe të specialistëve/profesionistë të huaj, programi mund të aplikohet pjesërisht ose i plotë edhe në një nga gjuhët e BE-së.	Programi i studimit zhvillohet në gjuhën italiane bazuar në marrëveshjen “Protokoll Ekzekutiv për hapjen dhe funksionimin e programit të specializimit afatgjatë në “Gjinekologji dhe Obstetrikë” me Universitetin e Romës “Tor Vergata” 2017. Kjo u evidentua edhe gjatë takimit të GVJ me përfaqësues të institucionit dhe me pedagogët e programit, të cilët shprehën përvojën e gjatë në fushën e programit të studimit, eksperiencën ndërkombëtare, nivelin e lartë të kërkimit shkencor. Studentët e specializimit referuan përfshirjen në punime kërkimore shkencore të përbashketa me pedagogët. Evidence 49 - CV.pdf Evidence 34 - Addendum i Protokollit Ekzekutiv.pdf evidence 39 - Tabela e stafit akademik.pdf
Kriteri 5: Programet e studimeve specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë synojnë të plotësojnë kërkesat e tregut të punës në përputhje me nevojat për specialistë në fushën e mjekësisë.	Vlerësimi i nevojave të tregut të punës nga Zyra e Orientimit të Karrierës së Universitetit, argumenton se nevoja për specialistë të kualifikuar në këtë fushë është në rritje, dhe program i specializimit afatgjatë në “Gjinekologji dhe Obstetrikë” përmbush nevojat dhe mbështet zhvillimin e sektorit dhe për t’iu përgjigjur kërkesës gjithnjë në rritje për kompetenca shkencore në këtë fushë të Mjekësisë. Kanceri i qafës së mitrës është një problem serioz shëndetësor në Shqipëri, ku shumë gra diagnostikohen çdo vit dhe një numër i konsiderueshëm humb jetën nga kjo sëmundje, ndërsa masat parandaluese si depistimi dhe vaksinimi po ndërmerren për të luftuar këtë problem. Për t’iu përgjigjur kërkesës në rritje për mjekë specialistë, qeveria shqiptare ka përfshirë përmirësimin e sektorit të shëndetësisë në planet e saj prioritare. Kjo përfshin rritjen e numrit të mjekëve të specializuar, zgjerimin e kapaciteteve të Universitetit të Mjekësisë dhe rritjen e kuotave për të mbuluar nevojat e vendit për specialistë në rajone të ndryshme. Në këtë kontekst, numri i specializantëve dhe kuotat për programet e specializimit në mjekësi, përfshirë programin në “Gjinekologji dhe Obstetrikë”, përcaktohen çdo vit në përputhje me politikat shtetërore dhe nevojat e kapaciteteve të sektorit shëndetësor, në përputhje me planifikimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Evidence 34 - Addendum i Protokollit Ekzekutiv.pdf Evidence 35 - Studimi i Tregut.pdf
Kriteri 6: Numri i përgjithshëm i specializantëve dhe numri i atyre që e ndjekin këtë program studimi çdo vit përcaktohet në përputhje me politikat shtetërore të zhvillimit të fushës së shëndetësisë dhe kapacitetet pritëse të Institucioneve të arsimit të lartë dhe strukturave shëndetësore të përfshira në rrjetin formues (në varësi kapaciteteve pritëse akademike/	Përcaktimi i numrit të specializantëve dhe kuotat për programet e specializimit në “Gjinekologji dhe Obstetrikë”, përcaktohen çdo vit në përputhje me politikat shtetërore dhe nevojat e kapaciteteve të sektorit shëndetësor, në përputhje me planifikimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

profesionale dhe infrastrukturore).				
Konkluzione	<i>Programi i specializimit afatgjatë në "Gjinekologji dhe Obstetrikë" është i hartuar nga Departamenti i Shkencave Kirurgjike, sipas standardeve Shtetërore të Cilësisë për Specializimet Afatgjata të përshtatura me strukturën e programeve të ngjashme që zhvillohen në vendet e BE-së, në përputhje me direktivat e BE-së për profesionet specifike, si dhe me standardet e cilësisë të përcaktuara në Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Ndërkombëtarizimi dhe partneriteti shihen si një nga fushat strategjike të Institucionit. Përcaktimi i numrit të specializantëve dhe kuotat për programet e specializimit në "Gjinekologji dhe Obstetrikë", përcaktohen çdo vit në përputhje me politikat shtetërore dhe nevojat e kapaciteteve të sektorit shëndetësor, në përputhje me planifikimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.6 Organizimi i programit të specializimit afatgjatë është në përputhje me fushën akademike dhe në bazë specialiteti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Programi i specializimit afatgjatë organizohet në nivel njësie bazë ose shërbimi (pjesë përbërëse e departamentit) të cilat janë përgjegjës për mbarëvajtjen dhe ecurinë e tij.	Programi i Specializimit Afatgjatë në "Gjinekologji dhe Obstetrikë" ofrohet nga Departamenti i Shkencave Kirurgjike, pjesë e Fakultetit të Mjekësisë, i cili siguron realizimin dhe zbatimin e tij. Ky program zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me Universitetin e Romës "Tor Vergata", përmes marrëveshjeve të rinovuara që mbulojnë të gjitha ciklet e programeve të studimit, përfshirë edhe të ciklit të tretë, si dhe specializimet në fushën e mjekësisë. Evidence 5 - Marrëveshje Kuadër bashkëpunimi UniZKM me Universitetin e studimeve në Romë Tor Vergata.pdf Evidence 35 - Studimi i Tregut.pdf Evidence 36 -Protokoll Ekzekutiv për hapjen dhe funksionimin e programeve të ciklit I, II, III të Universitetit KZKM.pdf
Kriteri 2: Njësia përgjegjëse ka profilin, përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike e mjekësore të specialitetit për ofrimin e programit të specializimit.	Bashkëpunimi me një institucion të njohur dhe me përvojë të gjerë si Universiteti i Romës "Tor Vergata", së bashku me kontributin e Drejtorit të Programit, Prof. E.P, pedagogëve dhe udhëheqësve klinikë që janë pjesë e programit të specializimit, ofron një mbështetje të fuqishme për të siguruar një standard të lartë arsimor, duke siguruar një profil të plotë shkencor, përvojë të pasur dhe aftësi profesionale. GVJ në takimin me personelin akademik i brendshëm i angazhuar në programin e specializimit konfirmoi se është i fushës përkatëse, me përvojë akademike dhe eksperiencën e duhur klinike, bazuar edhe në cv e tyre. Në përputhje me rregulloren e programit, neni 10, programi i Specializimeve Afatgjata ka në nivel departamenti: Pedagogë të angazhuar drejtpërdrejt në procesin e mësimdhënies brenda programit të

	studimit dhe Pedagogë të cilët nuk janë anëtarë të personelit akademik të Universitetit, por ushtrojnë profesionin në strukturat e rrjeteve formuese dhe kanë eksperiencë didaktike të dokumentuar (Viti Akademik 2023-2024 PAE-30/ PAK-8). Evidence 37 - Vlerësimi i Udheheqesve Klinik.pdf Evidence 38 - silabuse.pdf evidence 39 - Tabela e stafit akademik.pdf Evidence 49 - CV.pdf
Kriteri 3: Programet e studimit mbështeten mbi objektiva të qartë profesionale dhe janë të integruar me veprimtaritë klinike/ diagnostikuese.	Programi i specializimit në "Gjinekologji dhe Obstetrikë" është i ndërtuar mbi objektiva profesionale të qarta, të cilat janë të lidhura ngushtë me aktivitetet teorike (leksione 616 orë) dhe me përfitimin e aftësive praktike klinike dhe kompetencave të fushës (5200 orë praktikë profesionale). Fusha specifike e këtij programi përputhet me programet e tjera të specializimit të Departamentit të Shkencave Kirurgjikale dhe i përgjigjet kërkesave të përcaktuara nga udhëzimet dhe direktivat kombëtare dhe evropiane.
Kriteri 4: Fusha specifike e programit të specializimit afatgjatë është në përputhje me fushën akademike të specialitetet të njësisë përgjegjëse (departament/ shërbim) për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit në përputhje me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e europiane.	Evidence 38 - silabuse.pdf Evidence 33 - Prezantim i Programit të specializimit.pdf Tabela Permbledhese.pdf
Kriteri 5: Në rastet kur programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera, fusha e specifike e programit të specializimit është në përputhje me fushën akademike e të specialitetit të njësisë/ve përgjegjëse në institucionet respektive.	Gjatë vizitës në institucion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerësoi se Programi i Specializimit Afatgjatë në "Gjinekologji dhe Obstetrikë", i cili realizohet në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata", ndjek të njëjtat praktika dhe modele aktive të këtij institucioni. Universiteti i Romës ofron planet e studimit, silabuset dhe objektivat formues, ndërsa stafi akademik është i përzgjedhur me kujdes për të siguruar një nivel të lartë arsimor. Drejtori i Programit, Prof. Asc. G. S, ka autoritetin për të nënshkruar dhe certifikuar përmbajtjen e dosjes së programit të studimit. Po ashtu, strukturat e lidhura me këtë marrëveshje ofrojnë mundësi për specializantët për të ndjekur shërbime të specializuara, duke siguruar disponueshmërinë e udhëheqësve dhe duke u përputhur me standardet e kërkuara për zhvillimin e programit. Evidence 34 - Addendum i Protokollit Ekzekutiv.pdf
Konkluzione	<i>Programi i Specializimit Afatgjatë në "Gjinekologji dhe Obstetrikë" ofrohet nga Departamenti i Shkencave Kirurgjike, pjesë e Fakultetit të Mjekësisë, i cili siguron realizimin dhe zbatimin e tij. Personeli akademik i angazhuar në programin e specializimit është i fushës përkatëse, me përvojë akademike dhe eksperiencën e duhur klinike. Programi i specializimit në "Gjinekologji dhe Obstetrikë" është i ndërtuar mbi objektiva profesionale të qarta, të cilat janë të lidhura ngushtë me aktivitetet klinike dhe diagnostikuese. Programi i Specializimit realizohet në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata", ndjek të njëjtat praktika dhe modele aktive të këtij institucioni.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, STRUKTURA DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT

Standardi II.1 Organizmi i programit bazohet në rregullore dhe udhëzues të posaçëm të programit të specializimit afatgjatë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Njësia kryesore përgjegjëse për organizimin, zhvillimin e programeve të specializimeve, përcakton në mënyrë të detajuar rregullat e organizimit e të funksionimit të programeve të specializimeve dhe i përditëson ato në funksion të përmirësimit të cilësisë.	Fakulteti i Mjekësisë, në Universitetin “Zoja e Këshillit të Mirë” (UKZKM), përbëhet nga tre Departamente, përkatësisht Departamenti i Shkencave Kirurgjike, Departamenti i Shkencave Bio-mjekësore dhe Departamenti i Shkencave Mjekësore. Departamenti i Shkencave Kirurgjikale dhe Këshilli Drejtues i programit të specializimit janë përgjegjës për përgatitjen, monitorimin dhe organizimin e programit (neni 10 i rregullores). Specializimi në “Gjinekologji dhe Obstetrikë”, funksionon mbi rregullat e përcaktuara qartë në “Rregulloren për studimet afatgjata të Specializimit të Ciklit të Tretë në Mjekësi” të vitit 2017, e përditësuar në 2023. GVJ në takimin e realizuar në institucion me studentët, u informua se studenti njihet me rregulloren që prej fillimit të programit dhe nënshkrimin e kontratës. Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, në UKZKM, 2023.pdf Evidence 41 - Rregullore e studimeve të Specializimit të vitit 2017.pdf Evidence 42- Rregullore e programit të Specializimeve afatgjate në Mjekësi, UKZKM, 2019.pdf
Kriteri 2: Elementët e organizimi të programit, përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet, përcaktohen në rregulloren e specializimeve afatgjate dhe në akte të tjera të miratuara nga institucioni.	GVJ gjatë takimit në institucion dhe vlerësimit të evidencave përkatëse, vërejtë se programi i specializimit afatgjatë realizohet nëpërmjet një strukture organizative të përshtatshme, me kapacitetet e nevojshme profesionale dhe pedagogjike dhe me përfshirjen e pedagogëve, udhëheqësve dhe ekspertëve klinikë të fushës së specializimit. Institucioni ka në Rregulloren e vet njësitë akademike dhe administrative që bashkëpunojnë me njëra tjetrën sipas detyrave të përcaktuara. Programi ka në përbërje Përgjegjës të Programit të Specializimit, Këshillin Drejtues të programit të studimit të specializimeve afatgjata, i cili në bashkëpunim me Përgjegjësin e Programit të Specializimit, punon për përgatitjen, organizimin dhe monitorimin e programit të specializimit në fjalë. Ka Përgjegjës për menaxhimin ekonomik – financiar dhe një Përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm (Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë). Të gjithë elementët e strukturës së programit të studimit, pranimi i studentëve, mënyra e përzgjedhjes së kandidatëve, të drejtat dhe detyrat e studentëve janë të përcaktuara në Rregulloren e studimeve të specializimit. Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, në UKZKM, 2023.pdf Evidence 41 - Rregullore e studimeve të Specializimit të vitit 2017.pdf Evidence 42- Rregullore e programit të Specializimeve afatgjate në Mjekësi, UKZKM, 2019.pdf

Kriteri 3: Institucioni harton dhe miraton udhëzues, modele për raportimin, vlerësimin dhe arritjet e specializantëve gjatë gjithë vitit akademik dhe të studimeve.	Në Rregullore parashikohet organizimi i një provimi vlerësues teorik dhe praktik, në fund të çdo viti akademik. Vlerësimi bëhet nga një komision të parashikuar në nenin 14 të rregullores. Gjithashtu, në fund të çdo viti udhëheqësit klinikë përpilojnë raportin vjetore për aktivitetin praktik të specializantëve sipas evidences 43. Specializantët ishin të pajisur me Librezën e Studentit përgjatë 5 viteve si një detyrim ligjor, ku shënoheshin të gjitha notat dhe vlerësimet vjetore të tij, frekuentimi i praktikave sipas planit mësimor, dhe në përfundim të programit specializues dorëzohej në sekretari. Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, ne UKZKM,2023.pdf Evidence 41 - Rregullore e studimeve të Specializimit të vitit 2017.pdf Evidence 42- Rregullore e programit të Specializimeve afatgjate në Mjekësi, UKZKM,2019.pdf Evidence 53 - Libreza e Studentit.pdf			
Konkluzione	<i>Njësia kryesore përgjegjëse ka përcaktuar në mënyrë të detajuar rregullat e organizimit dhe të funksionimit të programit, duke i përditësuar ato në funksion të përmirësimit të cilësisë. Elementët e organizimit, përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet janë të përcaktuara në rregulloren e specializimeve dhe akte të tjera të miratuara nga institucioni. Institucioni ka hartuar dhe miratuar udhëzues dhe modele për raportimin, vlerësimin dhe arritjet e specializantëve gjatë gjithë vitit akademik. Programi realizohet në përputhje me "Rregulloren për studimet afatgjata të Specializimit të Ciklit të Tretë në Mjekësi" të vitit 2017, të përditësuar në 2023, dhe është e detyrueshme që studentët të njohin dhe nënshkruajnë këtë rregullore që në fillim të programit. Struktura e programit përfshin pedagogë, udhëheqës klinikë dhe ekspertë të fushës, të cilët sigurojnë mbështetje profesionale dhe pedagogjike. Po ashtu, programi ka një sistem vlerësimi dhe monitorimi të brendshëm, ku përfshihet një provim teorik dhe praktik në fund të çdo viti akademik, ndërsa raportet vjetore të aktiviteteve praktike të studentëve përpilohen nga udhëheqësit klinikë. Specializantët janë të pajisur me Librezën e Studentit, që shënon të gjitha notat dhe aktivitetet gjatë periudhës së studimeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Përmbajtja e programit të studimit specializim afatgjatë organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe në udhëzues të hapësirës evropiane në arsimin e lartë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Për kryerjen e programeve të studimeve specializuese afatgjata, studenti duhet të grumbullojë jo më pak se 120 kredite dhe kohëzgjatja	Programi i Studimeve Specializuese Afatgjata në "Gjinekologji dhe obstetrikë" ka një kohëzgjatje të programit të studimit 5 vjeçar dhe një numër total prej 300 kreditesh, e cila e përmbush kriterin për kryerjen e programeve të studimeve specializuese afatgjata, ku studenti duhet të grumbullojë jo më pak se 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e këtyre

normale e këtyre programeve të studimeve është jo më pak se 2 vite akademike, në përputhje me ligjin e profesioneve të rregulluara, dhe përcaktimeve në shtojcën 1.	programeve të studimeve është jo më pak se 2 vite akademike, në përputhje me ligjin e profesioneve të rregulluara, dhe përcaktimeve në shtojcën 1.
Kriteri 2: Kohëzgjatja e normale e programeve të specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë është sipas shtojcës nr 1 dhe kohëzgjatja maksimale nuk mund të jetë me shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të specializimit afatgjatë.	Programi organizohet në përputhje me Rregulloren për studimet afatgjata të specializimit në Mjekësi, në UKZKM, 2023, ku kohëzgjatja e programit të specializimit nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të programit. Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, në UKZKM, 2023.pdf
Kriteri 3: Përbajtja e programit, organizimi, vlerësimi dhe monitorimi përafrohen me shembuj të ngjashëm në institucione ndërkombëtare të hapësirës evropiane të arsimit të lartë.	Specializanti ka të drejtë që një pjesë të periudhës së specializimit, ta kryejë në strukturat e tjera jashtë shtetit që bëjnë pjesë në rrjetin formues të programit të Specializimit, me miratimin e Këshillit të Programit të Specializimit dhe Dekanit të Fakultetit, neni 42 i rregullores. Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, në UKZKM, 2023.pdf Evidence 5 - Marrëveshje Kuadër bashkëpunimi UniZKM me Universitetin e studimeve në Romë Tor Vergata.pdf
Kriteri 4: Programet e studimeve specializuese afatgjata përfshijnë të paktën 80% të ECTS-ve totale për aktivitete klinike/diagnostikuese e profesionalizuese, sipas specializimit përkatës, dhe 20% për studime të organizuara teorike të shpërndara në vite sipas një programi të paracaktuar në fillim të programit të studimit.	Programi i studimeve specializuese afatgjata organizohet nëpërmjet planit mësimor të programit, i cili ka të përcaktuar qarte shpërndarjen e lëndëve teorike në 20%, oreve përkatëse dhe pjesës së aktiviteteve praktike klinike/ diagnostikuese që përbën 80%. Specializanti zhvillon praktikën e udhëhequr nga drejtuesi klinik 5 ditë në javë, duke plotësuar të gjitha detyrat që i besohen duke respektuar Rregulloren dhe strukturat të rrjetit formues ku punon gjatë periudhës së specializimit. Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, në UKZKM, 2023.pdf evidence 31 - Plani Mesimor.pdf
Kriteri 5: Raporti i lëndëve (referuar totalit të ECTS) të përcaktuara në programin e studimit përbëhet, nga: 60% lëndë specifike; 30% lëndë karakterizuese të fushës; 5% lëndë të formimit bazë, ndërdisiplinore ose integruese dhe për aktivitete të tjera; 5% provimi përfundimtar etj. ; Jo me shumë se 15% e totalit e lëndëve vjetore duhet të jenë lëndë me zgjedhje, sipas kuadrit ligjor në fuqi.	Grupi i vlerësimit të jashtëm ka konkluduar se program i studimit të specializimit përmbush kërkesat e plota për përfundimin e studimeve, duke përfshirë kreditet e trajnimit (ECTS), disiplinat e përgjithshme të specializimit, përvojat klinike, sistemin e vlerësimit dhe rregulloren e diplomimit, të cilat janë të përfshira në rregullore. Programet e specializimit parashikojnë që 80% e krediteve formuese të jenë aktivitete klinike, ndërsa 20% të jenë studime teorike të ndara në vite të ndryshme. Lëndët përfshijnë lëndë bazë, karakterizuese, të ngjashme dhe plotësuese, kontroll periodik me provime vjetore 300 kredite totale, me leksione 616 ore dhe 5200 orë praktikë profesionale. Çdo ECTS korrespondon me 8 orë leksione frontale dhe 25 orë. Bazuar në planin mësimor në evidencat e derguara vëmë re se: Lëndët bazë përbëjnë 7% të programit (21 kredite), Lëndët karakterizuese përbëjnë 76 % të programit (228 kredite), Lëndët ndërdisiplinore përbëjnë 9% të programit (27 kredite),

	Lëndët plotësuese përbëjnë 2,6% të programit (8 kredite), Detyrimet përmbyllëse përbëjnë 5,3% të programit (16 kredite). <u>Gje e cila nuk perputhet me standartin II/; Kriteri 5</u> <i>Shenim: Sugjerojmë që të përshtatet plani mesimor sipas kriterit të përcaktuar për raportin e lëndëve formuese(<u>standartin II/; Kriteri 5</u>)</i> Tabela Permbledhese.pdf
Kriteri 6: Në përfundim të çdo viti organizohet provimi vlerësues teorik dhe praktik i lëndës i cili vlerësohet me notë. Vlerësimi vjetor i lëndës kryhet nga një komision i përbërë nga të paktën 2 (dy) pedagogë. Nder ta, te paktën njeri prej tyre duhet te jete pedagog me kohe te plote ne fushën përkatëse ndërsa pedagogu i dyte specialist me përvojë i fushës përkatëse ose të përafërt me të sipas moduleve të zhvilluara. Studentët që vlerësohen negativisht 5 herë marrin një dëshmi për modulet e zhvilluara, së bashku me kreditet e grumbulluara dhe i ndërpresin studimet e specializimeve afatgjata.	Në rregulloren për studimet afatgjata të specializimit në Mjekësi është e përcaktuar se në përfundim të çdo viti akademik, organizohet një provim vlerësues teorik dhe praktik, i cili vlerësohet me notë. Vlerësimi vjetor kryhet nga një komision i përbërë nga të paktën 5 (pesë) anëtarë me përvojë të fushës përkatëse ose të përafërt me të, sipas moduleve të zhvilluara. Specializantët që vlerësohen jo kalues 5 (pesë) herë rresht, marrin një certifikatë për modulet e zhvilluara, së bashku me kreditet e grumbulluara dhe i ndërpresin studimet e specializimeve afatgjata. Specializanti vlerësohet me notë në fund të çdo viti, notë e cila depozitohet në sekretarinë e ngarkuar për këtë qëllim. Studentit i jepet e drejta për të hyrë në provimin përfundimtar vetëm pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve vjetore, të parashikuara në program dhe pas miratimit të dosjes së tij nga Këshilli i programit të specializimit. Dosja e kandidatit përmban vlerësimet mbi praktikën dhe modulet mësimore të kryera si edhe vlerësimet periodike nga ana e udhëheqësi. Në rast vlerësimi negativ nga Këshilli i programit të specializimit, studentit i komunikohet vendimi si edhe pjesët që duhet të përsërisë në mënyrë që të mund të hyjë në provimin përfundimtar. Evidence 12 - Rregullore e programit te studimit SPA ne Mjekesi,ne UKZKM,2023.pdf NENI 14 I RREGULLORES. evidence 31 - Plani Mesimor.pdf Tabela Permbledhese.pdf
Kriteri 7: Studenti i nënshtrohet provimit përfundimtar/ final në përfundim të programit specializues i cili përfshin testimin praktik dhe me gojë të studentit dhe/ ose paraqitjen e temës të diplomës. Komisioni për vlerësimin përfundimtar të studentit përbëhet nga 5 specialistë të fushës pedagogë me kohe te plote të IAL që ofron specializimin, ose të një fushe të afërt, me eksperiencë të paktën 10 (dhjetë) vjeçare në fushën përkatëse. Kryetar i komisionit duhet te jete një pedagog me kohë te plote i fushës përkatëse, përgjegjës për programin e specializimit afatgjate ne ketë fushe.	Specializanti kryen provimin përfundimtar në fund të programit të specializimit, i cili konsiston në një testim praktik, një testim me gojë, prej të paktën 30 minutash, si edhe paraqitjen e temës eksperimentale – studimore të diplomës. Komisioni përbëhet prej të paktën 5 (pesë) ekspertësh të fushës, ose të një fushe të përafërt, me përvojë profesionale të paktën 10 (dhjetë) vjeçare dhe përvojë akademike në fushën përkatëse, ndër të cilët 2 përfaqësues nga MSHMS, 1 nga Urdhri profesional përkatës dhe 2 të përzgjedhur nga Fakulteti që zhvillon programin përkatës të specializimit, sipas akteve legjislative në fuqi. Pjesë e testimit përfundimtar janë disa nga njohuritë bazë si: a. Vlerësimi i arsytimit kritik në trajtimin e rasteve komplekse klinike; b. Lidhjet mes fushave të ndryshme të mjekësisë; c. Aftësi të zhvilluara për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës në klinikë; d. Aftësi për të menaxhuar kompleksitetin e situatave klinike dhe për të dhënë zgjidhje në raste emergjente. Gjatë vizitës së grupit të vlerësimit të jashtëm, u vlerësua se, sipas rregulloreve të programit, studentit duhet të demonstrojë njohuri të thelluara në fushën specifike dhe në disa fusha të afërta, si dhe aftësi profesionale dhe shkencore në përdorimin e teknologjisë bashkëkohore për zgjidhjen e problemeve klinike. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësi për të integruar njohuritë e fituara dhe për të zgjidhur situata komplekse

Disa nga njohuritë bazë për të cilat aplikanti testohet në provimin përfundimtar, janë: a. Zhvillimi i sensit kritik lidhur me situatat e ndryshme klinike; b. Lidhjet mes fushave të ndryshme të mjekësisë; c. Aftësi të zhvilluara për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës në klinikë; d. Kompetencë për të menaxhuar kompleksitetin e situatave klinike dhe për të dhënë zgjidhje në raste emergjente.	klinike, të ketë njohuri të përditësuara dhe të zgjeruara, autonomi dhe integritet shkencor, si dhe aftësi për të punuar në grup dhe për të respektuar sjelljen etike dhe profesionale. Përfundimisht, studenti duhet të dëshmojë se ka fituar aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të ushtruar profesionin në mënyrë të pavarur. Vlerësimi përfundimtar vjetor i specializantëve bazohet në rezultatet e vlerësimeve periodike, në provimin përfundimtar dhe në temën eksperimentale të Diplomës, si dhe në gjykimin e pedagogëve dhe të udhëheqësit dhe bëhet me anë të një sistemi notash deri në dhjetë, ku minimumi për të kaluar provimin është 5 ndërsa maksimumi është 10. Specializantit që shlyen të gjitha detyrimet teorike dhe praktike, sipas planit mësimor dhe që ka marrë vlerësimin përfundimtar, i lëshohet një Diplomë Specializimi në specialitetin përkatës duke fituar kështu të drejtën e ushtrimit të profesionit si specialist. Format i Diplomës, i miratuar nga Senati Akademik, komunikohet për efekt regjistrimi në regjistrin shtetëror të diplomave pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore, sipas parashikimeve të bazës ligjore në fuqi. Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, në UKZKM, 2023.pdf evidence 31 - Plani Mësimor.pdf			
Kriteri 8: Në kuadër të përmirësimit të programit, njësia përgjegjëse ka të drejtën e ndryshimeve në përmbajtje të formimit teorik të programit të specializimit, dokumenton procedurën në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nuk janë evidentuar ndryshime në përmbajtjen e programit të specializimit.			
Konkluzione	<i>Programi i specializimit në "Gjinekologji dhe Obstetrikë" është e detajuar dhe e organizuar në përputhje me Rregulloren për studimet afatgjata të specializimit në Mjekësi, në UKZKM, Specializanti ka mundësinë të kryejë një pjesë të periudhës së specializimit në struktura jashtë shtetit, me miratimin e Këshillit të Programit dhe Dekanit. Programi është i strukturuar me një plan mësimor që parashikon 20% të aktiviteteve teorike dhe 80% praktike, ku specializanti zhvillon praktikën klinike nën udhëheqjen e një drejtuesi klinik. Vlerësimi i progresit bëhet me nota çdo vit, dhe për të kaluar në provimin përfundimtar, studenti duhet të ketë përmbushur të gjitha detyrimet dhe të ketë miratimin e dosjes nga Këshilli i Programit. Provimi përfundimtar përfshin një testim praktik, një testim me gojë dhe paraqitjen e temës së diplomës, i vlerësuar nga një komision ekspertësh me përvojë profesionale dhe akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3**Pranimi i studentëve në një program studimi specializues afatgjatë në fushën e mjekësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Studenti i pranuar në programin e studimit specializues afatgjatë në fushën e mjekësisë ka përfunduar programin e integruar të studimeve universitare të integruara të ciklit të dytë me kohëzgjatje 5 vjeçare (300 ECTS) në Farmaci dhe Stomatologji dhe 6 vjeçare (360 ECTS) në Mjekësi e përgjithshme, pranë një universiteti të akredituar për programin në fjalë dhe ka fituar diplomën universitare “Master i Shkencave”. Për studentët e diplomuar në të njëjtat programe jashtë shtetit, duhet të paraqesin diplomën dhe lejen për ushtrimin e profesionit të njohur nga institucioni shtetëror përgjegjës.	Grupi i vlerësimit të jashtëm ka vlerësuar se procesi i pranimit në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dekretet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të cilat përcaktojnë procedurat e regjistrimit dhe afatet përkatëse për kandidatët që dëshirojnë të aplikojnë në Fakultetin e Mjekësisë dhe Programet e Specializimit afatgjatë. Universiteti publikon çdo vit në faqen e tij online informacion mbi konkursin për pranim, i cili përshkruan kriteret dhe metodat e pjesëmarrjes. Kandidatët që kanë përfunduar programin e ciklit të dytë në Mjekësi dhe kanë marrë titullin Master Shkencor mund të aplikojnë për studimet e specializimit afatgjatë, ndërsa ata me diploma të njohura ndërkombëtarisht nuk kanë kërkesë për notën mesatare. Kandidatët që aplikojnë duhet të kalojnë testin e pranimit dhe të vlerësohen nga Komisioni i pranimit, i cili i rendit sipas kërkesave të përcaktuara bazuar në Renditjen e Konkursit të Pranimit për Programet e Specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë Viti akademik. <i>GVJ sugjeron që për studentët e huaj, përveç dokumentacionit të plotë i cili ishte dorëzuar korrekt sipas legjislacionit shqiptar të ekuivalentimit të diplomës, të shoqerohet edhe me lejen e ushtrimit të profesionit të njohur nga institucioni i duhur Shqipëtar.</i> Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, ne UKZKM,2023.pdf (Evidence 45); (Evidence 46)
Kriteri 2: Kandidati që aplikon për të vazhduar programin e studimeve të ciklit të tretë, për specializim afatgjatë në fushën e mjekësisë, i nënshtrohet një konkursi pranimi për të testuar njohuritë në fushën përkatëse të studimit.	Konkursi i pranimit përbëhet nga një test me shkrim dhe një test i tjetër me gojë i ndjekur nga një intervistë. Për testin me shkrim komisioni do të përgatisë 60 pyetje me shumë alternativa dhe koha në dispozicion do të jetë 60 minuta. Testi me gojë fokusohet në diskutimin e kandidatit me komisionin për temat e kulturës së përgjithshme mjekësore, gjithashtu duke iu referuar atyre që trajtohen në testin me shkrim, si dhe temave që i përkasin fushës së specializuar për të cilën kandidati konkurron. Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, ne UKZKM,2023.pdf (Evidence 45) (Evidence 46)
Kriteri 3: Vlerësimi i studentit për pranimin në një program studimi bëhet me pikë kumulative duke vlerësuar të paktën elementët e mëposhtëm: notën mesatare (notën përfundimtare sipas tipologjisë së diplomës që ai disponon) për jo	Komisioni i Vlerësimit të pranimeve, I cili ngrihet nga Rektori i Universitetit, me propozim të Dekanit, bën Vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve përmes një testi konkurrues i cili përfshin një sistem vlerësimi bazuar në 100 pikë të ndara si më poshtë ¹: 30 pikë – testi mbi njohuritë e përgjithshme të lëndës; 40 pikë – testi mbi njohuritë specifike të programit të specializimit; 20 pikë – nota mesatare e ponderuar e kandidatëve që kanë marrë diplomën në Shqipëri dhe nota e diplomimit për kandidatët e diplomuar jashtë vendit.; 10 pikë – intervista me gojë.

¹ Evidence 47 - Lista e emrave të kandidatëve të pranuar në konkurs – Programet e Specializimit Viti Akademik 2023 - 2024




më shumë se 30% të pikëve totale, • testimin e përgjithshëm me shkrim për 30-40% të pikëve totale, • testimin me shkrim specifik sipas programit të specializimit për të cilin konkurren për 40-50% të pikëve totale.	Evidence 12 - Rregullore e programit te studimit SPA ne Mjekesi,ne UKZKM,2023.pdf
Kriteri 4: Kandidati që aplikon në programet e ciklit të tretë specializim afatgjatë duhet të ketë përfunduar me sukses provimin e shtetit në profesionin përkatës ose të ketë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në RSH ose jashtë saj (njohur në RSH). Studenti mund të riaplikojë për të konkuruar në një program tjetër specializues në një IAL sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Studentit mund t'i njihen ECTS-të e grumbulluara për studimet e organizuara teorike nëse gjykohet se përputhen me fushën e programit të ri ku ai ka aplikuar.	Grupi i vlerësimit të jashtëm gjatë intervistave me studentët dhe vizitën në sekretarinë mësimore, konstatoi zbatimin me saktësi të rregullores së specializimeve. Kandidatët mund të jenë shtetas shqiptarë, shtetas të Bashkimit Evropian si dhe ata që i përkasin shteteve që nuk janë pjesë e Bashkimit Evropian dhe që plotësojnë kriteret e mëposhtme: • Master Shkencor program i integruar në Mjekësi dhe Kirurgji/ Mjekësi e Përgjithshme, i akredituar ligjërisht në momentin e lëshimit dhe i njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit; • Kualifikim për të ushtruar profesionin e Kirurgut/Mjekut të Përgjithshëm (Vërtetim i Provimit të Shtetit dhe vërtetim regjistrimi në regjistrin profesional); • Ata që nuk kanë kualifikimin për të ushtruar profesionin e kirurgut/ mjekut të përgjithshëm mund të marrin pjesë dhe, nëse kanë sukses, pranohen me rezerva duke marrë përsipër, penalitetin e përjashtimit, të marrin kualifikimin brenda vitit të parë të programit të Specializimit.; Të njohë në mënyrë perfekte një nga gjuhët e huaja të mëposhtme: anglisht, italisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, të paktën në nivelin C1 të certifikuara me certifikata gjuhësore ndërkombëtare ose kualifikime ekuivalente të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Kandidatët që kanë marrë një diplomë në një program studimi të kryer në një nga këto gjuhë përjashtohen nga detyrimi i përcaktuar në këtë paragraf. Evidence 12 - Rregullore e programit te studimit SPA ne Mjekesi,ne UKZKM,2023.pdf
Kriteri 5: Kriteret minimale për t'u kualifikuar ne përzgjedhjen e programit të studimit specializim afatgjatë janë të pasqyruara në rregulloren e programeve të studimeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë dhe të aprovuara nga Senati Akademik.	GVJ konfirmon se kriteret minimale për t'u kualifikuar ne përzgjedhjen e programit të studimit specializim afatgjatë janë të pasqyruara në rregulloren e programit të studimeve. Për pjesëmarrjen në Konkursin e Specializimit si kriter minimal, për kandidatët e diplomuar në Shqipëri duhet të kenë një mesatare të ponderuar notash të të gjitha viteve të Programit të Studimit në Mjekësi, jo më të vogël se 5 (pesë). Evidence 12 - Rregullore e programit te studimit SPA ne Mjekesi,ne UKZKM,2023.pdf (Evidence 45)
Kriteri 6: Aplikanti njihet me rregulloren e specializimeve afatgjata të miratuar nga Senati	Grupi i vlerësimit të jashtëm gjatë vizitës në institucion, gjatë takimit me studentët dhe në sekretarinë mësimore, pohon se procesi i regjistrimit organizohet nga struktura e përcaktuar e Fakultetit, e cila mban një

akademik i IAL, me kriteret minimale të pranimit, në faqen zyrtare të IAL dhe/ose njësisë kryesore, para se të pranohet në të.	regjistër të veçantë ku kandidatë fitues nënshkruajnë në momentin e regjistrimit, duke shënuar datën dhe orën e regjistrimit. Në këtë regjistër, kandidati gjithashtu nënshkruan në rastin e çregjistrimit, duke humbur të drejtën për të vazhduar specializimin në të ardhmen. Me nënshkrimin e regjistrimit, kandidati deklaron se është njohur me planin didaktik-profesional të programit të specializimit, marrëdhëniet me strukturat klinike ku do të zhvillojë aktivitetin dhe me rregulloren përkatëse. Pas përfundimit të procedurës së regjistrimit, sistemi informatik dërgon automatikisht një e-mail mirëseardhjeje studentit, ku përfshihen kredencialet për hyrjen në portalin online dhe informacion mbi ecurinë didaktike-profesionale, duke mundësuar edhe shkarkimin e vërtetimit të regjistrimit. Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, në UKZKM, 2023.pdf (Evidence 45)			
Konkluzione	Gjatë intervistave me studentët dhe vizitën në sekretarinë mësimore arrin në përfundimin se se procesi i pranimit në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dekretet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të cilat përcaktojnë procedurat e regjistrimit dhe afatet përkatëse për kandidatët që dëshirojnë të aplikojnë në Fakultetin e Mjekësisë dhe Programet e Specializimit afatgjatë. Universiteti publikon çdo vit në faqen e tij online informacion mbi konkursin për pranim, i cili përshkruan kriteret dhe metodat e pjesëmarrjes. Kandidatët që kanë përfunduar programin e ciklit të dytë në Mjekësi dhe kanë marrë titullin Master Shkencor mund të aplikojnë për studimet e specializimit afatgjatë, ndërsa ata me diploma të njohura ndërkombëtarisht nuk kanë kërkesë për notën mesatare. Kandidatët që aplikojnë duhet të kalojnë testin e pranimit dhe të vlerësohen nga Komisioni i pranimit, i cili i rendit sipas kërkesave të përcaktuara bazuar në Renditjen e Konkursit të Pranimit për Programet e Specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë Viti akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Hartimi dhe miratimi i rregullores së specializimeve afatgjata.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Rregullorja është hartuar në përputhje me standardet e specializimeve në fushën e mjekësisë dhe me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	Grupi i vlerësimit të jashtëm gjatë takimit në institucion dhe rregullores së Specializimeve konfirmoi se rregullorja është e hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr.7961, i datës 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; me Statutin e Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" aprovuar me VKM Nr. 567, datë 27.08.2004; Dekretin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 824, datë 24.12.2021 "Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e

	programeve të studimeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në Institucionet e Arsimit të Lartë”; Dekretin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 1 të datës 14.01.2020, të ndryshuar “Për dokumentacionin dhe proce durat e hapjes, riorganizimit dhe mbylljes së institucionit të arsimit të lartë, degëve të tij, njërive të tij kryesore dhe programeve të tij të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë”. Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, ne UKZKM,2023.pdf			
Kriteri 2: Rregullorja hyn në fuqi në fillim të çdo viti akademik dhe përditësohet çdo vit të ri akademik. Nëse ska ndryshime, është në fuqi rregullorja e fundit e përditësuar.	GVJ konstaton se rregullorja në nenin 47 përcakton qartë se ajo mund të përditësohet çdo vit të ri akademik “rregullorja është e hartuar në përputhje me standardet e Specializimeve afatgjata në fushën e Mjekësisë dhe me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Rregullorja hyn në fuqi pas miratimit të saj dhe mund të përditësohet çdo vit të ri akademik”. Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, ne UKZKM,2023.pdf			
Kriteri 3: Përditësimet në rregulloren e specializimeve afatgjata i përkasin ciklit të specializimit që fillojnë për herë të parë me rregulloren e përditësuar deri në përfundim të tij. Nëse është të nevojshme, ndryshimet në rregulloret pasardhëse duhet të përjashtojnë shprehimisht ciklin e nisur të specializimit.	Bazuar në Nenin 47 të rregullores Kriteret e përcaktuara për një cikël specializimi në fillim të tij, nuk mund të ndryshojnë gjatë përditësimeve vjetore të rregullores deri në përfundim të atij cikli. Nëse janë të nevojshme, ndryshimet në rregulloret pasardhëse duhet të përjashtojnë shprehimisht ciklin e nisur të specializimit. Rregullorja mund të ndryshohet për t’iu përshtatur nevojave të Fakultetit dhe hynë në fuqi vetëm pas miratimit të Senatit Akademik. Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, ne UKZKM,2023.pdf			
Kriteri 4: Rregullorja propozohet nga Njësia kryesore që ofron programin e specializimeve dhe aprovohet nga senati akademik i IAL.	Grupi i vlerësimit të jashtëm në nenin 49 vërtetoi se Rregullorja mund të ndryshohet për t’iu përshtatur nevojave të Fakultetit të Mjekësisë me miratimin e Senatit Akademik dhe se ajo do të hyjë në fuqi menjëherë pas aprovimit nga ky Senat. Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, ne UKZKM,2023.pdf			
Konkluzione	<i>Rregullorja është hartuar në përputhje me standardet e Specializimeve afatgjata në fushën e Mjekësisë dhe me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Rregullorja hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik dhe mund të përditësohet çdo vit akademik. Kriteret e përcaktuara për një cikël specializimi në fillim të tij nuk mund të ndryshojnë gjatë përditësimeve vjetore të rregullores deri në përfundimin e ciklit. Ndryshimet në rregulloret pasardhëse, nëse janë të nevojshme, duhet të përjashtojnë shprehimisht ciklin e nisur të specializimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5 Rregullorja përcakton kriteret dhe mënyrën e përzgjedhjes së organeve drejtuese të programeve specializuese dhe tutorëve.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1: Në rregullore pasqyrohen qartë kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së përgjegjës të programit të specializimit, sipas përcaktimeve në këto standarde.	GVJ shprehet se në nenin 9 të rregullores së specializimit janë të përcaktuara kriteret dhe standartet e përzgjedhjes së përgjegjës I cili duhet “të ketë të paktën titullin “Profesor i asociuar”, ose një kualifikim të përfituar në vende perëndimore të barasvlershëm me këtë titull, dhe 10 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit lidhur me specializimin” Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, në UKZKM, 2023.pdf			
Kriteri 2: Në rregullore përcaktohen kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së mjekut përgjegjës/tutor për çdo specializant si dhe detyrat e tij.	GVJ shprehet se në nenin 12 të rregullores së specializimit përcaktohen kriteret e përzgjedhjes së tutorit ku “Specializanti ka një tutor/ udhëheqës klinik, që e ndjek atë gjatë gjithë periudhës së specializimit. Përvoja profesionale dhe klinike e udhëheqësit duhet të përputhet me atë të programit të specializimit që ndiqet nga specializanti. Numri maksimal i studentëve specializantë që mund të udhëhiqen nga një tutor është 3 (tre). Udhëheqësi (tutori) mund të punojë me kohë të plotë pranë njëres nga strukturat e rrjetit formues dhe duhet të ketë një kontratë bashkëpunimi me strukturën përkatëse gjatë kohëzgjatjes së programit të specializimit. Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, në UKZKM, 2023.pdf Evidence 50 - Emerimi i Udhëheqësve.pdf			
Konkluzione	<i>Rregullorja për përzgjedhjen e organeve drejtuese dhe tutorëve të programeve specializuese neni 9 përcakton kriteret për përgjegjës, duke kërkuar titullin “Profesor i Asociuar” dhe 10 vjet përvojë profesionale. Neni 12 përcakton kriteret për tutorët, duke kërkuar që ata të kenë përvojë të përshtatshme dhe maksimalisht një tutor 3 specializantë, me kontratë bashkëpunimi gjatë programit të specializimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6 Në rregullore është përcaktuar qartë mënyra e pranimit të studentëve në programin e specializimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1: Në rregullore janë përcaktuar kriteret për aplikim (niveli i studimeve të kryera, kohëzgjatja dhe titulli i diplomës që kërkohet etj) si dhe kriteret përjashtuese nëse ka të tilla.	GVJ konfirmoj se nga takimi i bërë në institucion me drejtues dhe studentë specializantë pranimi i studentëve bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e specializimit, në nenin 16, nenin 17 të kësaj rregulloreje. Evidence 41 - Rregullore për studimet afatgjata e specializimit në Mjekësi, në UKZKM, 2017 Evidence 42 - Rregullore për studimet afatgjata të specializimit në Mjekësi, në UKZKM, 2019 Evidence 12 - Rregullore për studimet afatgjata të specializimit në Mjekësi, në UKZKM, 2023 Evidence 12 - Rregullore për studimet afatgjata të specializimit në			

	<i>Mjekësi, në UKZKM, 2023</i> Evidencë 44 – Njoftim i Konkursit – Program i Studimit afatgjatë në fushën e Mjekësisë.pdf
Kriteri 2: Në rregullore përcaktohet qartë dokumentacioni që duhet të dorëzojë kandidati për aplikim, mënyra e dorëzimit të dokumentacionit dhe afati përfundimtar.	Nga bashkëbisedimi me studentët GVJ mori informacionin se dokumentacioni dhe rruga e ndjekur për kandidim nga studentët është e njëjtë me kriteret dhe standartet e përcaktuara në rregulloren e specializimit neni 19 dhe neni 20. Afatet dhe gjithcka mbi mënyrën e konkursit publikohet në faqen web të UKZKM-së dhe në ambientet e Departamentit. Dokumentacioni i duhur sipas kriterëve të vendosura në rregullore u gjet prezent në dosjet e cdo studenti specializant gjatë vizitës që u bë në sekretarinë mësimore nga GVJ. Evidence 12 - Rregullore e programit te studimit SPA ne Mjekesi,ne UKZKM,2023.pdf Evidence 47 -Lista e Kandidateve te pranuar ne konkurs.pdf Evidence 54 -Dosje e Studentit.pdf
Kriteri 3: Në rregullore janë përcaktuar qartë pikët maksimale që mund të grumbullojë kandidati dhe pikët që i jepen kandidatit për çdo kriter të plotësuar si dhe pikët maksimale dhe minimale që mund ti jepen kandidatit gjatë çdo testimi.	Në takimin me studentët GVJ mori informacionin se mënyra e përzgjedhjes së kandidateve është bërë nëpërmjet konkursit të pranimit dhe komisionit të vlerësimit të pranimeve prej 3 anëtarësh, sipas nenit 22 dhe nenit 24 të rregullores së specializimeve. Evidence 12 - Rregullore e programit te studimit SPA ne Mjekesi,ne UKZKM,2023.pdf 2023 Evidence 46 - emerimi i Komisioni i Vlerësimit për Pranim.pdf Evidence 45- Renditja e Konkursit të Pranimit për Programet e Specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë Viti Akademik. 2023 - 2024-4.pdf
Kriteri 4: Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e aplikimit, e konkurrimit e kandidati për specializim; përcaktohet sa kohë para datës së shpallur për testimet mbyllet pranimi i dokumenteve.	Mënyra dhe koha e aplikimit përcaktohen qartë ne nenin 19 të rregullores dhe është ndjekur prej studentëve gjatë konkurimit, ku kërkesat për pjesëmarrje në konkurs fillojnë pas publikimit të njoftimit dhe mbyllet 7 ditë para datës së konkursit. Lista e kandidateve publikohet 2 ditë para konkursit, ndërsa ora dhe vendi i konkursit publikohet 4 ditë para datës së tij. Evidence 12 - Rregullore e programit te studimit SPA ne Mjekesi,ne UKZKM,2023.pdf 2023
Kriteri 5: Në rregullore është përcaktuar qartë mënyra e zhvillimit të testeve dhe procedura e tyre.	Forma e testimit për kualifikimin e studentëve bëhet me një Sistem vlerësimi prej 100 pikësh, i cili është i ndarë në 4 elemente: 1. 30 pikë-testi mbi njohuritë e përgjithshme të lëndës; 2. 40 pikë-testi mbi njohuritë specifike të programit te specializimit; 3. 20 pikë-nota mesatare e ponderuar e kandidateve të cilët kanë marrë diplomën në Shqipëri dhe nota e Diplomës e kandidateve të diplomuar jashtë shtetit; 4. 10 pikë- intervista me gojë; Evidence 12 - Rregullore e programit te studimit SPA ne Mjekesi,ne UKZKM,2023.pdf
Kriteri 6: Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e vlerësimit të kandidateve për çdo testim dhe dokumentacioni i	Vlerësimi i kandidateve bëhet i ndarë në elementët e parapërcaktuar në rregullore, neni 24, cituar si më sipër. Evidence 12 - Rregullore e programit te studimit SPA ne Mjekesi,ne UKZKM,2023.pdf

përdorur i cili ruhet sipas procedurave të parashikuara në rregullore.	
Kriteri 7: Emërtimet e programeve të specializimeve të miratuara për vitin akademik, numri i specialistëve që do të pranohen për çdo program specializimi dhe tarifat që duhet të paguajë specialisti për çdo specializim publikohen të paktën 2 javë përpara datës së fillimit të aplikimeve.	Shpallja e specializimeve dhe kriteret e pranimi sipas rregullores publikohen në faqen ëeb të UKZKM-së, si dhe afishohen pranë Fakultetit dhe departamenteve përkatëse dhe në faqen ëeb përkatëse. Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA ne Mjekesi,ne UKZKM,2023.pdf neni 19 Evidence 44 - Njoftim për Konkursin e Programeve të Specializimit afatgjatë në fushën e Mjekësisë Evidence 45 - Renditja e Konkursit të Pranimi për Programet e Specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë Viti akademik 2023 - 2024 Evidence 46 - Emërimi i Komisionit për Konkursin e Pranimi – Programe Specializimi Afatgjata në Fushën Mjekësore, Fakulteti i Mjekësisë
Kriteri 8: Mënyra e vlerësimit mbi të cilat kryhet testimi duhet të përcaktohen në rregullore dhe të publikohen të paktën 2 javë përpara datës së fillimit të aplikimeve.	GVJ gjatë takimit me përfaqësues të institucionit mori informacionin se mënyra e vlerësimit është e përcaktuar paraprakisht në rregulloren e specializimeve dhe është e publikuar në faqen e Universitetit, sic edhe evidentohet në rregullore. Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA ne Mjekesi,ne UKZKM,2023.pdf Evidence 45- Renditja e Konkursit të Pranimi për Programet e Specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë Viti Akademik. 2023 - 2024-4.pdf Evidence 47 -Lista e Kandidateve të pranuar ne konkurs.pdf
Kriteri 9: Në rregullore është përcaktuar qartë mënyra dhe afatet e shpalljes së rezultateve të testeve dhe të listës përfundimtare me fituesit si dhe është përcaktuar vendi dhe data e shpalljes së rezultateve.	Neni 25 në rregullore përcakton mënyrën e shpalljes së rezultateve dhe regjistrimin e kandidatëve fitues Brenda 7 ditësh nga shpallja dhe afishimi i rezultateve online dhe në ambientet e departamentit. Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA ne Mjekesi,ne UKZKM,2023.pdf Evidence 45- Renditja e Konkursit të Pranimi për Programet e Specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë Viti Akademik. 2023 - 2024-4.pdf
Kriteri 10: Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e lidhjes së kontratës me specialistët fitues.	Gjatë vizitës në institucion, në diskutimin e zhvilluar me studentët dhe verifikimin e dokumentacionit në sekretarinë mësimore u verifikua qartë se kontrata e nënshkruar nga kandidatët fitues është e njëjta me përcaktimet e bëra në rregulloren e specializimit, neni 25. Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA ne Mjekesi,ne UKZKM,2023.pdf
Konkluzione	<i>Pas takimit me studentët dhe të shqyrtimit të matërialeve/evidencave në dispozicion, pasi standardet për pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve specialistë janë të përmbushura në përputhje me rregulloren e specializimit. Siç është përcaktuar në nenet 16 dhe 17 të rregullores, pranimi i studentëve bëhet sipas kriterëve të caktuara dhe është i njohur nga studentët, të cilët konfirmuan se dokumentacioni dhe procesi i kandidimit përputhen me ato kriterë. Afatet dhe informacioni mbi</i>

	konkursin publikohen në faqen ëeb të UKZKM-së dhe në ambientet e Departamentit. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet përmes një konkursi pranimi, i mbikëqyrur nga një Komision Vlerësimi 3-anëtarësh, sipas rregulloreve. Koha dhe mënyra e aplikimit janë të qarta dhe ndiqen nga studentët, me kërkesat që mbyllen 7 ditë para datës së konkursit. Rezultatet dhe regjistrimi i kandidatëve fitues realizohen në përputhje me rregulloren. Gjithashtu, kontrata e nënshkruar nga kandidatët fitues përputhet me përcaktimet e rregullores, duke garantuar përmbushjen e procedurave të përcaktuara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Në rregullore parashikohen element të procesit mësimor të programit specializues.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Parashikohen në rregulloren e specializimeve mënyra e frekuentimit, maksimumi i mungesave të lejuara dhe arsytet, leja e lindjes, dhe mënyra e rikuperimit të mungesave etj.	Grupi i vlerësimit të jashtëm, duke u bazuar në rregulloren e specializimit dhe diskutimet me studentët, vuri re se informacioni mbi mungesat është i përfshirë në nenin 35 të rregullores. Ky nen përcakton se për mungesat për arsye shëndetësore duhet depozituar raport mjekësor. Nëse mungesat kalojnë 30% të ciklit ose modulit mësimor, ai duhet të përsëritet. Po ashtu, në rast leje lindjeje, programi do të shtyhet për aq kohë sa është leja e lindjes, për të mundësuar përfundimin e plotë të programit. Në rast fatkeqësish familjare, specializanti mund të mungojë për më shumë se 30 ditë dhe do të shlyejë detyrimet në një moment të dytë. Specializimi nuk mund të zgjasë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes së saj zyrtare. Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, në UKZKM, 2023.pdf neni 35, neni 36
Kriteri 2: Parashikohen në rregulloren e specializimeve procedurat për transferimet për apo nga programe të tjera specializuese, ose për apo nga institucione të tjera që ofrojnë programe specializuese në mjekësi.	GVJ vëren se në rregullore është e shprehur se studentët gëzojnë të drejtën e transferimit në programe të tjera specializimi afatgjatë (neni 42). Kjo bëhet pas shqyrtimit të dosjes përkatëse nga Komisioni i ngritur nga Programi i Specializimit ku ka synim të transferohet. Transferimet mund të kryhen vetëm nëse janë parashikuar kuota specifike për këtë qëllim dhe procedurat e njehsimit dhe transferimit bëhen në përputhje me rregulloren dhe ligjin në fuqi. Nëse ka një numër më të madh transferimesh kualifikimi I kandidatëve fitues bëhet nëpërmjet konkurimit. Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, në UKZKM, 2023.pdf neni 42
Kriteri 3: Parashikohen në rregulloren e specializimeve kriteret dhe mënyra e pezullimit, zgjatjes ose përjashtimit të specializantit nga studimet specializuese.	GVJ shprehet se përcaktohet në rregulloren e specializimit se kur Specializanti nuk kalon vlerësimin përfundimtar, ka të drejtë t'i nënshtrohet edhe një herë tjetër këtij vlerësimi, por jo më vonë se 1 vit pas përfundimit të specializimit. Studenti regjistrohet si student përsëritës dhe ndjek/frekuenton aktivitetet përkatëse profesionale me kohë të plotë (neni 37). Humbasin të drejtën e marrjes së Diplomës së Specializimit nëse nuk I nënshtrohen vlerësimit përfundimtar brenda 1 viti nga përfundimi i specializimit, duke marrë një certifikatë që vërteton se ka kryer ciklin e

	plotë të studimeve të specializimit, përveç diplomimit, si dhe lista shoqëruese e notave. Nëve evidentohen thyerje ose shkelje disiplinore, i nënshtrohen si të gjithë mjekët e tjerë, masave disiplinore të marra nga Universiteti, Urdhri i Mjekut dhe organet e tjera kompetente (neni 39, neni 44). Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA ne Mjekesi,ne UKZKM,2023.pdf Evidence 57 - Aplikimi për statusin e pezulluar – Template.pdf Evidence 58 - Kërkese për të hequr dorë nga studimet – Template.pdf			
Kriteri 4: Rregullorja parashikon rastet kur specializimi mund të kryhet në një institucion tjetër që nuk është pjesë e rrjetit formues shqiptar, kohëzgjatjen e kësaj periudhe dhe organin aprovues të kësaj procedure. Këto institucione duhet të jenë të akredituara për kryerjen e programit specializues në vendin përkatës.	Grupi i vlerësimit të jashtëm, duke u bazuar në rregulloren e specializimit dhe diskutimet me studentët, vuri re se specializanti ka të drejtë të kryejë një pjesë të periudhës së specializimit në struktura jashtë shtetit që bëjnë pjesë në rrjetin formues të programit, me miratimin e Këshillit të Programit të Specializimit dhe Dekanit të Fakultetit. Institucionet ku specializanti kryen studimet janë të akredituara për realizimin e programit të specializimit në vendin përkatës (neni 38). Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA ne Mjekesi,ne UKZKM,2023.pdf			
Konkluzione	<i>GVJ mendon se duke evidentuar se elementët e procesit mësimor të programit specializues janë të parashikuara në rregullore, njihen dhe zbatohen nga studentët dhe strukturat përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.8	
Në rregullore parashikohen element të procesit mësimor të programit specializues .	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Rregullorja parashikon librezën e aktivitetit praktik së studentit, mënyrën e plotësimit të saj dhe mënyrën e zëvendësimit të saj në rast humbje. Libreza e studentit e shoqëron atë deri në përfundim të ciklit specializues dhe diplomimit të tij.	GVJ duke u bazuar në rregulloren e specializimit, në takimin me studentët mori informacionin se cdo student është i pajisur me librezë që në momentin e regjistrimit dhe plotëson në vëjimësi librezën e aktivitetit praktik deri në përfundimin e ciklit specializues dhe diplomimit të tij. Libreza është e parashikuar në rregullore (neni 43) Plotësimi i librezës është i detyrueshëm dhe plotësohet nga pedagogu që ka qenë përgjegjës për zhvillimin e atij aktiviteti. Kandidati nuk pranohet në aktivitetet përkatëse nëse nuk paraqet librezën. Në rast humbjeje, sekretaria e pajis studentin me librezë tjetër. GVJ në takimin në sekretarinë mësimore konfirmoi edhe librezën e dorëzuar të plotësuar në dosjen e studentit pas përfundimit të të programit të specializimit. Evidence 12 - Rregullore për studimet afatgjata të specializimit në Mjekësi, në UKZKM, 2023 Evidence 53 - Libreza e Studentit.pdf
Konkluzione	GVJ mendon se duke evidentuar se në rregulloren e specializimit afatgjatë të programit paraqitet qartë rregullorja e përdorimit të librezës, e cila

	<i>parashikohet se e shoqëron studentin që në momentin e rregjistrimit deri në diplomimin e tij, dhe dorëzohet në sekretari në përfundim të programit specializues. Fakt konkret ishte librezja e plotësuar në të gjitha detajet dhe e dorëzuar në sekretarinë mësimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.9

Në rregullore parashikohen procedurat për testimet vjetore dhe testimin përfundimtar si dhe formati i diplomës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Në rregullore përcaktohet mënyra e testimit vjetor të lëndëve dhe ai përfundimtar të specializantëve, pikët minimale dhe maksimale, lloji i testit, etj.	Në rregulloren e programit të specializimit GVJ vëren se është e përcaktuar mënyra e testimit vjetor dhe përfundimtar të specializantëve. Specializanti vlerësohet me notë në fund të çdo viti, e cila depozitohet në sekretari. Specializanti mund të hyjë në provimin përfundimtar vetëm pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve vjetore dhe miratimit të dosjes nga Këshilli i Programit të Specializimit. Dosja përmban vlerësimet për praktikant, modulet dhe vlerësimet periodike nga udhëheqësi. Në rast vlerësimi negativ, studentit i komunikohet vendimi dhe pjesët që duhet të përsërisë për të kaluar provimin përfundimtar. Vlerësimi përfundimtar bazohet në rezultatet e vlerësimeve periodike, provimin përfundimtar, temën e Diplomës dhe gjykimin e pedagogëve, duke përdorur një sistem notash nga 5 deri në 10. (neni 32) Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, ne UKZKM, 2023.pdf Evidence 61 - Këshilli Drejtues.pdf
Kriteri 2: Në rregullore përcaktohen rastet e mungesave të justifikuara në teste dhe mënyra e rikuperimit të testimit në këto raste.	Grupi i vlerësimit të jashtëm, duke u bazuar në rregulloren e specializimit vuri re se informacioni mbi mungesat është i përfshirë në nenin 35 të rregullores. Ky nen përcakton se për mungesat për arsye shëndetësore duhet depozituar raport mjekësor. Nëse mungesat kalojnë 30% të ciklit ose modulit mësimor, ai duhet të përsëritet. Po ashtu, në rast leje lindjeje, programi do të shtyhet për aq kohë sa është leja e lindjes, për të mundësuar përfundimin e plotë të programit. Në rast fatkeqësish familjare, specializanti mund të mungojë për më shumë se 30 ditë dhe do të shlyejë detyrimet në një moment të dytë. Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, ne UKZKM, 2023.pdf neni 35 Evidence 61 - Këshilli Drejtues.pdf
Kriteri 3: Në përfundim të studimeve të specializimit afatgjatë, I diplomuari pajiset me diplomën e specializimit. Diploma duhet të firmoset nga rektori i IAL dhe dekani i fakultetit përkatës	Në rregullore është e përcaktuar se në fund, pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve teorike dhe praktike, sipas planit mësimor, dhe pas marrjes së vlerësimit përfundimtar, specializantit i lëshohet Diplomë Specializimi në specialitetin përkatës. Format i Diplomës, i miratuar nga Senati Akademik, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore, sipas ligjeve në fuqi. (neni 32) Evidence 55 - Forma e Diplomes.pdf

Konkluzione	<i>GVJ mendon se duke evidentuar se në rregullore janë të përcaktuara qartë mënyra e testimit vjetor dhe përfundimtar të specialistëve, përfshirë pikët minimale dhe maksimale, si edhe formati i diplomes.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.10	
Të drejtat dhe detyrimet e specialistit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Rregullorja duhet të përmbajë detyrat dhe të drejtat që ka specialisti.	GVJ konfirmon se të drejtat dhe detyrimet e studentit Në programin e studimit të Specializimit afatgjatë janë përcaktuar në pjesën e 4 të rregullores së programit të specializimit, njihen dhe zbatohen prej studentëve specialistë, të konfirmuara gjatë takimit me studentët.
Kriteri 2: Në rregullore përcaktohet tipologjia dhe mënyra e sigurimit të specialistëve gjatë kryerjes së specializimit. Parashikohet tipi i policës së sigurimit dhe masa e mbulimit.	GVJ në takimin me drejtues të institucionit dhe me studentët konstaton se Studenti është i siguruar gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe për të gjitha aktivitetet e parashikuara në programin e specializimit. Polica e sigurimit, në favor të studentit, paguhet dhe lidhet nga Fakulteti përkatës me kompaninë e sigurimit dhe një kopje e policës së sigurimit i dorëzohet studentit në momentin e nënshkrimit. (neni 29) Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekesi, ne UKZKM, 2023.pdf Evidence 56 - Police Sigurimi.pdf
Kriteri 3: Parashikohen rastet kur mund të pezullohet specializimi nga ana e specialistit dhe periudha maksimale e lejuar për pezullim, si dhe procedurat për të hequr dorë nga specializimi.	Programi parashikon rastet kur specialisti për arsye të ndryshme kërkon një periudhë pezullimi nga specializimi sipas formateve të paracaktuara: Aplikim për statusin e pezulluar dhe Kërkese për të hequr dorë nga studimet. Specializimi nuk mund të zgjasë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes së saj zyrtare. Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekesi, ne UKZKM, 2023.pdf Evidence 57 - Aplikimi për statusin e pezulluar – Template.pdf Evidence 58 - Kërkese për të hequr dorë nga studimet – Template.pdf
Kriteri 4: Në rregullore përcaktohen tregues të matshëm lidhur me plagjiaturën të punimit të diplomës si dhe referenca lidhura me to duke u kujdesur që niveli i ngjashmërisë të punimit të diplomës të jenë nën 30%.	Në rregullore përcaktohet se Vlerësimi përfundimtar vjetor i specialistëve bazohet në rezultatet e vlerësimeve periodike, në provimin përfundimtar dhe në temën eksperimentale të Diplomës, si dhe në gjykimin e pedagogëve dhe të udhëheqësit dhe bëhet me anë të një sistemi notash deri në dhjetë, ku minimumi për të kaluar provimin është 5 ndërsa maksimumi është 10. <i>Sugjerohet që në rregullore të përcaktohen/ përfshihen tregues matës të plagjiaturës së punimit shkencor për mbrojtjen e Diplomës së specializimit, ku niveli i ngjashmërisë së punimit të diplomës të jetë më pak se 30%.</i>
Konkluzione	<i>Rregullorja përcakton qartë të drejtat dhe detyrimet e studentëve specialistë, sigurimin e tyre gjatë programit, rregullat për pezullimin ose ndërprerjen e specializimit, kohëzgjatjen maksimale të studimeve dhe kriteret e vlerësimit përfundimtar me sistem notash deri në 10.</i>

	<i>Sugjerohet përfshirja e treguesve matës për plagjiaturën e punimit të diplomës, duke kufizuar nivelin e ngjashmërisë në më pak se 30%.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.11 Njësia kryesore përgjegjëse për programin e specializimit administron të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për çdo specializant nga aplikimi, pranimi deri përfundim të studimeve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Njësia kryesore mban në formë elektronike dhe në letër të gjithë dokumentacionin e aplikantëve në fazën e aplikimit.	GVJ gjatë vizitës në institucion, në takimin me studentët specializantë, vizitën në sekretarinë mësimore dhe duke u bazuar në rregulloren e specializimeve cdo student kishte në dosjen e tij gjithë dokumentacionin e pranimit në konkurs: kërkesën për pjesëmarrje në konkurs, diplomën dhe listën e notave të noterizuar, Licencën Mjekut- Lejën e ushtrimit të Profesionit përkatës, Cv dhe certifikata të ndryshme. Neni 20 I rregullores. Evidence 12 - Rregullore e programit te studimit SPA ne Mjekesi,ne UKZKM,2023.pdf
Kriteri 2: Njësia kryesore mban në formë elektronike dhe në letër të gjithë dokumentacionin e procesit të përzgjedhjes dhe vendimmarrjes të kandidatëve aplikantë dhe fitues dhe garanton transparencë në vendimmarrje e proceset e ankimimit.	Në sekretarinë mësimore GVJ konstatoi se dokumentacioni i pjesëmarrësve në konkurs i përmbahej rregullores së programit. Procesi i konkurimit në cdo fazë të tij vihej në dispozicion të kandidatëve duke u shpallur në ambientet e Departamentit dhe në faqen ëeb të Universitetit. Në nenin 21 të rregullores përcaktohet se kur kandidati dorëzon dokumentacionin për pranimin në konkurs, atij i jepet Rregullorja e konkursit dhe linkun për ta konsultuar atë online, njëkohësisht i jepet informacioni për datën e kontrollit të dokumentacionit nga Komisioni i Vlerësimit dhe vendin dhe orën e konkursit, si dhe rezultatet përfundimtare. Evidence 12 - Rregullore e programit te studimit SPA ne Mjekesi,ne UKZKM,2023.pdf Evidence 44 - Njoftim për Konkursin e Programeve të Specializimit afatgjatë në fushën e Mjekësisë Evidence 45 - Renditja e Konkursit të Pranimit për Programet e Specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë Viti akademik 2023 - 2024 Evidence 47 -Lista e Kandidateve te pranuar ne konkurs.pdf
Kriteri 3: Njësia kryesore mban në formë elektronike dhe në letër të dhënat e çdo specializanti në lidhje me veprimtaritë akademike dhe kërkimore eksperimentale gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve.	GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore konstatoi se në zbatim të rregullores, neni 30 i saj, departamenti mban në formë elektronike dhe të shkruar të dhëna të përvitshme për specializantët. Konstatuam rregjistrin e përvitshëm të studentëve, të dhënat e tyre, të dokumentuara rastet e pezullimit dhe të terheqjes nga programi i studimit. Evidence 12 - Rregullore e programit te studimit SPA ne Mjekesi,ne UKZKM,2023.pdf
Kriteri 4: Njësia kryesore mban në formë elektronike dhe në letër raportimet, komunikimet	Në sekretarinë mësimore GVJ konstatoi të dokumentuar dhe ruajtur vlerësimet e përvitshme dhe të vlerësimit final, për vlerësimin në vazhdimësi të dijeve të studentëve, të përcaktuara në rregulloren e

zyrtare, vlerësimet e lëndëve dhe të progresit të specialistit.	specializimit dhe të bëra të ditura që në fillim të programit të studimit. (neni 30). Në rregullore përcaktohet se, pas përfundimit të procedurës së regjistrimit, sistemi informatik dërgon automatikisht një e-mail mirëseardhjeje studentit, ku përfshihen kredencialet për hyrje në portalin online dhe faqja e tij personale, e cila përmban informacione mbi ecurinë didaktike-profesionale dhe progresin e specialistit (neni 25) <i>Sugjerohet përfshirja e treguesve matës për plagjiaturën e punimit të diplomës, duke kufizuar nivelin e ngjashmërisë në më pak se 30%.</i> Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, ne UKZKM,2023.pdf			
Kriteri 5: Njësia kryesore ve në dispozicion të studentëve sistemin elektronik antiplagjiaturë si dhe mekanizma tjerë të vetëkontrollit për eliminimin e plagjiaturës dhe respektimin e të drejtës së pronësisë intelektuale.	GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mesimore dhe takimin me studentët konstaton se Specialistët, sipas përcaktimit në rregulloren e specializimit, ndiqen në vazhdimësi me vlerësime periodike nga ana e udhëheqësit dhe në përfundim të çdo viti akademik, organizohet një provim vlerësues teorik dhe praktik, i cili vlerësohet me note, notë e cila depozitohet në sekretarinë e ngarkuar për këtë qëllim (Neni 14. Neni 32). Fakulteti ndjek procedura të qarta për vlerësimin në vazhdimësi të dijeve të studentëve, të përcaktuara dhe të bëra të ditura që në fillim të programit të studimit. Neni 30.			
Kriteri 6: Njësia kryesore harton në mënyrë periodike raportime mbi ecurinë e programit të specializimit.	GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mesimore dhe takimin me studentët konstaton se Specialistët, sipas përcaktimit në rregulloren e specializimit, ndiqen në vazhdimësi me vlerësime periodike nga ana e udhëheqësit dhe në përfundim të çdo viti akademik, organizohet një provim vlerësues teorik dhe praktik, i cili vlerësohet me note, notë e cila depozitohet në sekretarinë e ngarkuar për këtë qëllim (Neni 14. Neni 32). Fakulteti ndjek procedura të qarta për vlerësimin në vazhdimësi të dijeve të studentëve, të përcaktuara dhe të bëra të ditura që në fillim të programit të studimit. Neni 30.			
Konkluzione	<i>Gjatë takimit me studentët dhe inspektimit në sekretarinë mesimore, konstaton se vlerësimi periodik i specialistëve realizohet në përputhje me rregulloren e specializimit. Njësia kryesore përgjegjëse administron dokumentacionin e nevojshëm për çdo student, nga aplikimi deri në përfundimin e studimeve. Çdo student ka dokumentacionin e plotë të pranimit në konkurs, dhe procesi i konkurimit është i disponueshëm për kandidatët përmes shpalljeve në ambientet e Departamentit dhe faqen ëeb të Universitetit. Po ashtu, janë dokumentuar regjistrat e studentëve, rastet e pezullimit dhe tërheqjes nga programi. Në sekretari janë ruajtur vlerësimet e përvitshme dhe vlerësimi final, të cilat janë bërë të njohura që në fillim të programit. Pas regjistrimit, sistemi informatik dërgon një e-mail mirëseardhjeje studentit, duke përfshirë kredencialet për portalin online dhe informacione mbi ecurinë e tij. Gjithashtu, vlerësimet periodike dhe provimet vjetore janë të dokumentuara dhe depozitohen në sekretari.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


III. BURIMET NË FUNKSION TË PROGRAMIT SPECIALIZIM AFATGJATË

Standardi III.1

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. « Q. Stafa », Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




Njësia përgjegjëse garanton personelin e nevojshëm akademik, administrativ dhe mbështetës për zhvillimin e programit dhe realizimin e objektivave të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Personeli akademik i angazhuar në programin e specializimit afatgjatë është i kategorisë profesor (profesor, profesor i asociuar), i kategorisë lektor (Dr/ PhD), të cilët janë të angazhuar me punë klinike/ diagnostikuese të paktën 10 vite eksperiencë.	GVJ në vizitën në institucion, në takimin stafin dhe me Drejtuesin e Programit të Specializimit Prof. Emilio Piccione, i cili i përket fushës së studimit dhe mban titullin Profesor Emeritus, u informuam se personeli akademik i angazhuar në programin e specializimit afatgjatë përfshin kategorinë profesor (profesor, profesor i asociuar) dhe kategorinë lektor (Dr/PhD), sipas përcaktimit në rregulloren e specializimeve afatgjata, Neni 10. Stafi akademik i angazhuar në programin e specializimit kanë mbi 10 vite eksperiencë dhe janë të angazhuar në punë klinike/diagnostikuese bazuar në Cv e tyre. Stafi akademik i programit afatgjatë të specializimit në Gjinekologji dhe Obstetrikë përbëhet 17 pedagogë (11-PAR dhe 6-PAK), prej të cilëve 5 profesorë (24%), 7 profesorë të asociuar (34%), 4 PhD (37%) dhe 1 MSC, me mbi 10 vite përvojë në aktivitete klinike dhe diagnostikuese. Programi në rolin e Drejtuesit të Specializimit, aktualisht ka Prof. Emilio Piccione, Profesor Emeritus në Gjinekologji dhe Obstetrikë, si dhe strukturat përgjegjëse si Këshillin Drejtues për organizimin dhe monitorimin e programit, Zyrën e Financës për menaxhimin ekonomik, dhe Njësinë e Vlerësimit të Cilësisë për monitorimin e brendshëm. Evidencë 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM evidence 39 - Tabela e stafit akademik.pdf Evidence 49 - CV.pdf Evidence 38 - silabuse.pdf Evidence 61 - Keshilli Drejtues.pdf
Kriteri 2: Në çdo program specializues përcaktohen: Një figurë drejtuese, përgjegjësi/drejtuesi i programit të specializimit. Përgjegjësi/drejtuesi i programit të specializimit duhet të jete pedagog me kohe të plote në fushën përkatëse, të ketë të paktën titullin "Profesor i asociuar" dhe jo më pak se 10 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Kjo figurë propozohet nga njësia baze përgjegjëse dhe miratohet në nivel të njësisë kryesore.	Bazuar në rregulloren e specializimeve afatgjata, Neni 9, Programi ka Drejtuesin e Specializimit, aktualisht Prof. Emilio Piccione, Profesor Emeritus në Gjinekologji dhe Obstetrikë, me më shumë se 10 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Evidence 22 -Rregullore e Fakultetit të Mjekësisë. Evidencë 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM Evidence 40 - Emerimi i drejtorit të programit.pdf Evidence 49 - CV.pdf
Kriteri 3: Personeli akademik i programit të studimit specializim afatgjatë përbëhet nga:	GVJ vëren se personeli akademik i programit të studimit specializim afatgjatë, si gjatë vizitës me ta edhe duke u bazuar në evidencat në dispozicion, është konform rregullores së specializimit afatgjatë dhe legjislacionit në fuqi, Neni 11.

i. personel akademik me kohë të plotë me tituj akademikë dhe grada shkencore, jo më pak se 50% të pedagogëve që mbulojnë programin e studimit. Të paktën 1 (një) pedagog me kohë të plotë, i kategorisë profesor, duhet t'i përkasë fushës së programit të studimit. ii. Personel akademik, i cili ushtron profesionin në strukturat shëndetësore universitare të përcaktuara, sipas legjislacionit në fuqi në masën jo më shumë se 50% e pedagogëve që mbulojnë programin e studimit. Ky personel akademik të ketë eksperiencë didaktike-formuese dhe eksperiencë profesionale-klinike diagnostike. Zhvillimi i aktivitetit mësimdhënës nga personeli i strukturave shëndetësore të rrjetit formues kërkon miratimin paraprak të drejtuesit të strukturës shëndetësore. Zhvillimi i aktivitetit mësimdhënës nga personeli i strukturave shëndetësore universitare, kërkon në çdo rast miratimin paraprak nga IAL përkatëse, ku struktura shëndetësore universitare është pjesë përbërëse e saj. iii. personel akademik me kohë të pjesshme, për disiplina të veçanta, jo më shumë se 10% e pedagogëve që mbulojnë programin e studimit, me të cilët lidhet një kontratë, sipas nevojave të strukturës së programit të studimit.	Stafi akademik përbëhet nga: • Personel akademik me kohë të plotë i cili përbën 96% të stafit dhe i përmbush kriteret e titujve akademik, ku sipas ligjit me tituj akademikë dhe grada shkencore, të jenë jo më pak se 50% e pedagogëve që mbulojnë programin. Prof. Emilio Piccione, është Profesor Emeritus në Gjinekologji dhe Obstetrikë, i cili përmbush edhe kriterin ku të paktën një pedagog me kohë të plotë i kategorisë profesor duhet t'i përkasë fushës së programit të studimit. • Stafi akademik në strukturat shëndetësore ka përvojën e duhur didaktike-formuese dhe profesionale-klinike diagnostike, bazuar në titullin/gradën, pozicionin e punës dhe cv shoqëruese të tyre. Zhvillimi i aktivitetit mësimdhënës nga ky personel zhvillohet duke u bazuar në miratimet e bëra me drejtuesit e strukturave shëndetësore dhe me miratimin e institucionit të arsimit të lartë përkatës sic janë marrëveshjet institucionale me Universitetin e Tor Vergata në Romë, me Qendrën Spitalorë Universitare Nënë Tereza, Spitalit Rajonal të Durrësit, etj • Personel akademik me kohë të pjesshme: Për disiplina të veçanta, përbën jo më shumë se 10% e pedagogëve që mbulojnë programin, me kontrata sipas nevojave të programit të studimit Evidence 22 -Rregullore e Fakultetit të Mjekësisë. Evidence 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM evidence 39 - Tabela e stafit akademik.pdf Evidence 43 - Vlerësimi i Udheheqesve Klinik.pdf Evidence 49 - CV.pdf Evidence 38 - silabuse.pdf Evidence 61 - Keshilli Drejtues.pdf evidence 13 - marreveshje Geraldina.pdf Evidence 14 - Marrëveshje midis UniZKM dhe Spitalit Rajonal të Durrësit.pdf Evidence 14.1 - Marrëveshje midis UniZKM dhe Spitali Amerikan.pdf Evidence 15 - Marreveshje me Spitalin M.G Figlie San Camillo G.Vannini.pdf evidence 16 - Marreveshje me Eurosanita.pdf Evidence 17- Marreveshje lGreco.pdf Evidence 18 - Marreveshje midis UKzKM dhe Spitalit Bianchi Malacrino Morelli.pdf Evidence 19 - Marreveshje me Polikliniken e Barit.pdf Evidence 20 - Marreveshje me Fondazione Leonardo.pdf
Kriteri 4: Programi i studimit specializim afatgjatë ka drejtuesin/përgjegjës e programit.	GVJ bazuar në rregulloren e specializimit afatgjatë, Neni 9 konstaton se Përgjegjësi i Programit të Specializimit është pedagog me kohë të plotë, me titullin "Profesor i Asociuar" dhe me mbi 10 vite përvojë në ushtrimin e profesionit në fushën përkatëse. Aktualisht Drejtor i Programit të

Përgjegjësi/drejtuesi i programit të specializimit duhet të jetë personel akademik me kohë të plotë. Përgjegjësi/drejtuesi i programit të specializimit është njëkohësisht dhe anëtar i njësisë bazë përgjegjëse/shërbimit përgjegjës për programin e specializimit afatgjatë. Përgjegjësi/drejtuesi i programit të specializimit zgjidhet nga anëtarët të asamblesë së njësisë bazë, me shumicë të thjeshtë (50%+1). Përgjegjësi/drejtuesi i programit në një IAL nuk mund të ngarkohet me përgjegjësinë e drejtimit të një tjetër programi studimi që realizohet nga IAL-të e tjera.	Specializimit 'Gjinekologji dhe Obstetrikë' është Prof. Emilio Piccione, I cili mbikëqyr dhe koordinon të gjitha aspektet e programit të specializimit, strukturën për procesin e edukimit dhe praktikës klinike për specializantët. Përgjegjësi siguron që programi të respektojë standardet e cilësisë dhe përputhet me politikat e zhvillimit të arsimit të lartë dhe shëndetësisë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar Evidence 40 - Emerimi i drejtorit te programit.pdf Evidence 61 - Keshilli Drejtues.pdf Evidence 49 - CV.pdf Evidence 22 -Rregullore e Fakultetit të Mjekësisë. Evidence 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM
Kriteri 5: Njësia përgjegjëse garanton se ka kapacitete për udhëheqjen e specializantit. Udhëheqësi i specializantit është: udhëheqës akademik dhe udhëheqës klinik diagnostik. Numri maksimal i studentëve që mund të ndiqet nga udhëheqës akademik/klinik diagnostik është sipas kuadrit ligjor ne fuqi. Drejtimi i specializantit i ngarkohet, në cilësinë e udhëheqësit, një pedagogu (udhëheqës akademik) dhe/ose një anëtar i personelit të strukturës shëndetësore të rrjetit formues (udhëheqës klinik/tutori) të programit të studimit, i cili/të cilët udhëheqin specializantin gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe janë përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit, si edhe	GVJ bazuar në rregulloren e specializimeve afatgjata, në Nenin 12 dhe nenin 13, dhe në takimin në institucion me stafin akademik konstaton se cdo Specializant ka një tutor (udhëheqës klinik) që e ndjek gjatë gjithë periudhës së specializimit, i cili është përgjegjës për orientimin, këshillimin dhe vlerësimin e nevojave të specializantit, për monitorimin e punës së tij si dhe për vlerësimin periodik të ecurisë së zhvillimit të aftësive profesionale të fushës. Përvoja profesionale dhe klinike e tutorit përputhet me atë të programit të specializimit që ndjek specializanti bazuar në Cv e Udhëheqësve klinikë të kontraktuar me marrëveshje institucionale. Numri maksimal i studentëve që mund të udhëhiqen nga një tutor është 3 (tre). Tutori mund të punojë me kohë të plotë pranë një nga strukturat e rrjetit formues dhe duhet të ketë një kontratë bashkëpunimi me strukturën përkatëse gjatë gjithë periudhës së programit të specializimit. Nëse tutori kryesor nuk është i disponueshëm, studentit i njoftohet kush do ta zëvendësojë atë. Sipas rregullores së specializimeve afatgjata, pedagogët jo anëtarë të personelit akademik të Universitetit janë profesionistë që punojnë në strukturat e rrjeteve formuese. Ata kanë eksperiencë didaktike-formuese të verifikuar në këto struktura dhe janë të angazhuar me kontrata bashkëpunimi me strukturën e lidhur gjatë kohëzgjatjes së programit të specializimit. Fusha e specializimit të udhëheqësit përputhet me atë të programit specializues që ndjek specializanti.

për zhvillimin dhe monitorimin e punës së studentit.

Fusha e specializimit të udhëheqësit duhet të përputhet me atë të programit specializues që ndjek. Udhëheqësi klinik/tutori ka një experiencë profesionale të paktën 10-vjeçare (dhjetëvjeçare) me përvojë klinike në fushën klinike përkatëse dhe ka të paktën gradën shkencare "Doktor". Numri maksimal i studentëve specializantë që mund të ndiqet nga udhëheqësi akademik/klinik është 3 (tre).

Udhëheqësi klinik/tutori është personel i punësuar me kohë të plotë pranë njëres nga strukturat e rrjetit formues dhe ka kontratë bashkëpunimi me IAL-në që ofron programin. Kur tutori nuk është pjesë e personelit me kohë të plotë të strukturës që ofron programin e specializimit, specializantit i caktohet edhe një udhëheqës akademik, anëtar i personelit akademik me kohë të plotë të institucionit. Për caktimin e udhëheqësit klinik merret vendimi i drejtuesit të strukturës shëndetësore dhe udhëheqja e tij klinike konsiderohet si pjesë e orarit të punës.

Aktiviteti i mësimdhënies kryhet njëkohësisht me aktivitetin asistencial/profesional, në përputhje me kërkesat e programit të studimit. Zhvillimi i aktivitetit mësimdhënës në selinë ku realizohet programi i studimit

GVJ vëren se edhe në rastin kur tutori nuk është pjesë e personelit akademik të institucionit që ofron programin e specializimit, studenti mund të ketë një udhëheqës akademik, i cili është anëtar i personelit akademik të institucionit dhe ka së paku titullin akademik "Doktor" apo "PhD" (të fituar në universitete të njohura ndërkombëtarisht) në fushën përkatëse të studimeve të specializantit.

Evidencë 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM

Evidence 13 - Marreveshje Geraldina.

Evidence 14 - Marrëveshje midis UniZKM dhe Spitalit Rajonal të Durrësit.

Evidence 14.1 - Marrëveshje midis Uni ZKM dhe Spitali Amerikan.

Evidence 15 - Marreveshje me Spitalin M.G Figlie San Camillo G.Vannini.

Evidence 16 - Marreveshje me Eurosanita.

Evidence 17- Marreveshje IGreco.

Evidence 18 - Marreveshje midis UKzKM dhe Spitalit Bianchi Malacrino Morelli.

Evidence 19 - Marreveshje me Polikliniken e Barit.

Evidence 20 - Marreveshje me Fondazione Leonardo.

nga personeli i strukturave shëndetësore universitare kërkon miratimin paraprak të drejtuesit të këtij shërbimi.				
Konkluzione	<i>Kriteret përzgjedhëse dhe udhëheqësit e programit të specializimit janë të përcaktuara qartë në rregulloren për specializimin afatgjatë në fushën e "Gjinekologjisë dhe Obstetrikës", në përputhje me legjislacionin aktual. Të gjitha kriteret sipas dispozitave në fuqi janë të përmbushura. Përgjegjësi/Drejtuesi i Programit të Specializimit plotëson kriteret e përcaktuara nga ligji. Përvoja profesionale dhe klinike e tutorit është në përputhje me kërkesat e programit të specializimit që ndiqet nga specializanti. Numri maksimal i studentëve që mund të udhëhiqen nga një tutor është 3 (tre). Tutori është i angazhuar me kohë të plotë në një nga strukturat e rrjetit formues dhe ka një kontratë bashkëpunimi me strukturën përkatëse për gjatë gjithë periudhës së programit të specializimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton infrastrukturën dhe logjistikën e nevojshme në funksion të programit të specializimit afatgjatë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore. Këto mjedise duhet të jenë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet.	Programi i specializimit afatgjatë në "Gjinekologji dhe Obstetrikë" veprimtarinë mësimore e zhvillon në strukturat universitare të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" (UKZKM) me seli në Tiranë, rruga "Dritan Hoxha" Kompleksi Spitalor në pronësi të Fondacionit ZKM, si dhe në struktura klinike-spitalore publike e private, të cilat kanë marrëveshje të posaçme. Gjatë vizitës në institucion, grupi i vlerësimit të jashtëm vuri re se Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" disponon një kampus modern prej 61,460 m², me ndërtesa që plotësojnë standardet teknike dhe evropiane, të pajisura me sisteme të avancuara të ngrohjes, kondicionimit, ventilimit dhe izolimit termik, si dhe me aktet përkatëse të autorizimit higjeno-sanitar dhe parandalimit të zjarrit, duke garantuar kushte optimale për zhvillimin e aktiviteteve mësimore dhe kërkimore. Evidencë 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM. neni 1. Evidencë 62 - Sigurimi i parandalimit të zjarrit Evidencë 63 - Akti i autorizimit higjeno-sanitar Evidence 5 - Marrëveshje Kuadër bashkëpunimi UniZKM me Universitetin e studimeve në Romë Tor Vergata.pdf
Kriteri 2: Institucioni duhet të ketë kapacitete të mjaftueshme infrastrukturore dhe teknologjike. Ai disponon struktura	Në vizitën që GVJ bëri në strukturat universitare të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" konstatoi një infrastrukturë mjaft cilësore administrative dhe teknologjike në shërbim të realizimit të plotë të procesit mësimor didaktik dhe formimit, klasat e mësimdhënies,

administrative dhe klinike, të mjaftueshme për aktivitetet e parashikuara në programin e studimit specializues sipas standardeve specifike bashkëngjitur këtij dokumenti (Shtojca 2).	biblioteka fizike me 250 vende dhe 25.000 tekste mësimore, më orar 08.00-21.00 në 7 ditë të javës, databaza të bibliotekave online me akses të plotë të studentëve, klinika Spitalore..
Kriteri 3: Institucioni disponon struktura shëndetësore të akredituara për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme klinike diagnostikuese, profesionale dhe didaktike. Akreditimi i këtyre strukturave bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.	GVJ në vizitën që bëri në institucion, në takimin me drejtues dhe me studentët specializantë u referua se aktivitetet klinike, profesionale dhe diagnostikuese zhvillohen sipas programit mësimor në struktura Spitalore të vendit dhe të huaja bazuar në marrëveshjet institucionale, të akredituara dhe të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR). Institucionet spitalore që janë pjesë e rrjetit formues dhe kanë informacion të plotë mbi strukturën didaktike dhe stafin profesional të angazhuar në program bazuar në marrëveshjet përkatëse dhe akreditimet përkatëse të bëra nga institucionet e posatshme. Institucionet spitalore pjesë e rrjetit formues janë: Qendra Universitare Obstetrike-Gjinekologjike “Koco Gliozheni” Tiranë, Spitali Rajonal i Durrësit, Spitali Amerikan, Tiranë, Universiteti i Romës “Tor Vergata”, Spitali M.G Figlie di San Camillo G. Vannini, Romë, Eurosanità S.p.a Policlinico Casilino, Romë, spitali IGreco Ospedale Riuniti, Spitali i Madh Bianchi Malacrino Morelli, Poliklinika e Barit, Fondazione Leonardo. Evidencë 64 - http://asck.gov.al/lista-e-institucioneve-te-akredituara-nga-asck/ 108 Evidencë 64 - https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2020/01/PUBLIKE-AKREDITIM-BAZE.pdf Evidence 13 - Marreveshje Geraldina. Evidence 14 - Marrëveshje midis UniZKM dhe Spitalit Rajonal të Durrësit. Evidence 14.1 - Marrëveshje midis Uni ZKM dhe Spitali Amerikan. Evidence 15 - Marreveshje me Spitalin M.G Figlie San Camillo G.Vannini. Evidence 16 - Marreveshje me Eurosanita. Evidence 17- Marreveshje IGreco. Evidence 18 - Marreveshje midis UKzKM dhe Spitalit Bianchi Malacrino Morelli. Evidence 19 - Marreveshje me Polikliniken e Barit. Evidence 20 - Marreveshje me Fondazione Leonardo
Kriteri 4: Institucioni mund të organizojë programe të përbashkëta të studimeve specializuese afatgjata me një a më shumë institucione të tjera, të njohura/akredituara sipas legjislacionit në fuqi.	Gjatë vizitës në institucion, grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi se programi i specializimit zhvillohet në bashkëpunim me Universitetin “Tor Vergata” dhe struktura shëndetësore shqiptare dhe italiane, të gjitha të akredituara dhe në përputhje me rregulloret dhe legjislacionin në fuqi. Evidence 5 - Marrëveshje Kuadër bashkëpunimi UniZKM me Universitetin e studimeve në Romë Tor Vergata.pdf

Konkluzione	<i>Institucioni garanton infrastrukturën dhe logjistikën e nevojshme për zhvillimin e programit të specializimit afatgjatë në "Gjinekologji dhe Obstetrikë", duke ofruar një mjedis cilësor mësimor në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" dhe strukturat e tij klinike bashkëpunuese, të akredituara dhe të miratuara nga MSHMS dhe MASR, me një infrastrukturë të avancuar, biblioteka fizike dhe online, si dhe aktivitete profesionale të zhvilluara sipas marrëveshjeve institucionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni mund të ofrojë programe mësimdhënieje në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1: Institucioni, që ofron programe mësimdhënie në gjuhë të huaj, plotëson të njëjtat standarde të përcaktuara për IAL-të që ofrojnë programet e studimeve specializuese të fushës së mjekësisë në gjuhën shqipe.	Gjatë vizitës në institucion, në takimin me stafin akademik dhe në dokumentacionin në dispozicion, grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi se programi i specializimit realizohet në bashkëpunim me Universitetin e Tor Vergata, me shumicën e pedagogëve që janë pjesë e stafit të këtij universiteti, duke pasur si gjuhë amtare italishten, çka e bën të panevojshme kërkesën për certifikatë gjuhësore, ndërsa një pjesë e tyre posedojnë certifikata për gjuhë të tjera të huaja. Evidencë 49 - Curriculum Vitae (CV) e Pedagogëve			
Kriteri 2: Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj disponon një certifikatë për njohje të gjuhës së mësimdhënies të njohur ndërkombëtarisht, sipas kuadrit ligjor në fuqi.				
Konkluzione	<i>Programi i specializimit ofrohet në bashkëpunim me Universitetin e Tor Vergata, me një staf pedagogjik të kualifikuar, shumicën e të cilëve kanë gjuhë amtare italishten dhe certifikata për gjuhë të tjera të huaja, duke garantuar një nivel të lartë mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Strukturat e përfshira duhet të disponojnë standardet e përgjithshme dhe specifike të parashikuara.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1: Strukturat qendrore dhe dytësore disponojnë standarde të përgjithshme në përputhje me kapacitetin infrastrukturor, teknologjik, organizativ dhe	Grupi i vlerësimit të jashtëm, gjatë vizitës në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", konstaton se strukturat qendrore përmbushin standardet infrastrukturore, teknologjike, organizative dhe asistenciale, duke siguruar hapësira të mjaftueshme, pajisje moderne dhe kompetenca profesionale për funksionet e parashikuara. Universiteti ofron ambiente			

asistencial sipas kriterëve të mëposhtme dhe sipas kriterëve specifike të parashikuara në shtojcën 2: a. Kapaciteti infrastrukturor: hapësira të mjaftueshme për ushtrimin e funksioneve të parashikuara; b. Kapaciteti teknologjik: pajisje të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të parashikuara; c. Kapaciteti organizativ: kompetenca të nevojshme profesionale; d. Kapaciteti asistencial: sasi dhe tipologji të caktuar të ndërhyrjeve klinike.	bashkëkohore si salla mësimi, laboratorë, bibliotekë dhe hapësira të tjera të përbashkëta, të pajisura me akses për personat me aftësi të kufizuara. Procesi mësimor dhe kërkimor zhvillohet në kushte të larta higjienike, ndërsa investimet në teknologji moderne vazhdojnë të mbështesin mësimdhënien dhe kërkimin shkencor.
Kriteri 2: Të gjitha strukturat (psh. Auditorët, biblioteka, sekretaritë, etj.) Plotësojnë standardet e përgjithshme.	Grupi i vlerësimit të jashtëm, gjatë vizitës në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", konstaton se auditorët dhe sallat e leksioneve plotësojnë standardet bashkëkohore, ndërsa sekretaritë dhe shërbimet mbështetëse janë në përputhje me standardet e përgjithshme. Biblioteka "Paolo Ruatti" ofron rreth 19,000 tituj monografikë dhe mbështet mësimdhënien dhe kërkimin shkencor me shërbime elektronike të avancuara, përfshirë akses në bazat e dhënash HINARI, JStore dhe platformën Cobiss, të cilat plotësojnë nevojat e studentëve dhe përdoruesve të tjerë.
Kriteri 3: Struktura bazë është e pajisur me ambientet/pajisjet e nevojshme: • sekretari didaktike • bibliotekë shkencore të pasur me botime dhe në formë elektronike • Infrastrukturë të plotë të IT-së. • laboratorë kërkimorë dhe didaktikë (nëse parashikohen në shtojcën nr.2) • ambulatorë dhe struktura asistencialë (me pajisjet e nevojshme teknologjike sipas specialitetit) • ambjente spitalore me shtretër (në rastet kur janë parashikuar në standardet specifike të specialitetit në shtojcën 2) Ambjentet më sipër duhet të sigurojnë standardet e sigurisë dhe ato higjienike dhe nuk kanë barrierë arkitektonike që pengojnë	Gjatë vizitës në bibliotekën e Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se biblioteka operon me kapacitet të plotë dhe oraret janë zgjeruar për të përmbushur nevojat e përdoruesve, duke qëndruar e hapur çdo ditë të javës, përfshirë festat publike, nga ora 08:00 deri në 21:00. Fondi i bibliotekës, i aksesueshëm në adresën https://biblioweb.unizkm.edu.al/, përditësohet rregullisht në bazë të sugjerimeve të pedagogëve, dekanëve, koordinatorëve, stafit mjekësor dhe studentëve. Biblioteka disponon një sallë leximi me rreth 220 vende, e cila ofron një mjedis të përshtatshëm për studim dhe hulumtim akademik. GVJ konstaton se universiteti ofron laborator informatike të pajisur për nevojat e studentëve, ku përfshihen: • PC të dedikuara në Bibliotekë, për akses në të gjitha platformat online të disponueshme dhe të abonuara. • 3 salla informatike në dispozicion të studentëve: Salla e Informatikës (48 PC), Zyra e Studentëve (2 PC) dhe Salla PC Gradua (11 PC), të gjitha me softuer të licencuar dhe lidhje të plotë interneti. • Akses në platforma ndërkombëtare si Jstor dhe Hinari, përmes "Sign in ëith Google" me llogari personale @stud.unizkm.al

aksesin në veprimtaritë e ndryshme të parashikuara nga programi i studimit.	(Student Account) ose @prof.unizkm.al (Teacher Account), të cilat mund të përdoren nga çdo pajisje, brenda apo jashtë rrjetit universitar. Këto pajisje dhe shërbime sigurojnë mbështetje të plotë teknologjike për mësimdhënien dhe studimin. Struktura bazë ofron Ambientet ambulatorë dhe strukturat asistenciale për programin e specializimit të Gjinekologjisë dhe Obstetrikës realizoheshin në Klinikën Universitare të Universitetit si struktura qendrore, i cili pritët të funksionojë edhe si spital me funksion të plotë, ndërkohë ofron shërbimin ditor ambulator, konsultues dhe diagnostikues. Evidence 66 - Lista e Librave.pdf Evidence 73 - Tabela e të dhënave të platformave online.pdf Evidence 67 - https://biblioweb.unizkm.edu.al/
Kriteri 4: Çdo program specifik i specializimit plotëson standardet specifike sipas tipologjisë së specializimit (psh. laboratorë specifikë, shërbime, shtrime spitalore, etj.) sipas shtojcës 2. Standardet specifike ndahen në: a. bazë: standarde që duhet domosdoshmërisht të përmbushen si nga struktura bazë dhe nga strukturat dytësore/satelite. b. dytësore: standarde që, për të plotësuar kriteret e akreditimit të strukturës, duhet të plotësohen si nga struktura qendrore edhe nga ajo dytësore ose nga strukturat tjera të IAL-së sipas një përqindjeje të caktuar të parashikuar për akreditimin. Nëse nuk plotësohen as nga struktura bazë e as nga ajo dytësore duhet të plotësohen nga strukturat komplementare me të cilat ka një marrëveshje bashkëpunimi. c. shërbime të përgjithshme: janë shërbimet operative që duhet të ketë struktura në të cilën bën pjesë struktura qendrore ose ajo dytësore që do të akreditohen.	Sipas elementëve të përshkruar më sipër në kriterin 3, struktura bazë disponon infrastrukturën e nevojshme me laboratorë specifikë dhe ambiente ambulatorë, duke përfshirë edhe strukturat asistenciale për programin e specializimit në Gjinekologji dhe Obstetrikë. Aktualisht, këto shërbime ofrohen në Klinikën Universitare të Universitetit si strukturë qendrore, e cila pritët të funksionojë plotësisht si spital, ndërkohë që aktualisht ofron shërbime ditore ambulatorë, konsultative dhe diagnostikuese. Për të plotësuar nevojat e programit të specializimit, strukturat dytësore përfshijnë rrjetin e spitaleve terciare apo universitare, të akredituara dhe të përshtatura sipas marrëveshjeve specifike dhe kapaciteteve pritëse. Gjatë takimit me studentët specializant, stafin udhëheqës të specializantëve dhe bazuar në evidencat e disponueshme të marrëveshjeve të bashkëpunimit me struktura spitalore të rëndësishme, grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se institucioni disponon kapacitete të mjaftueshme personeli shëndetësor, duke përfshirë mjekë, kirurgë, staf teknik, infermierë, ndihmës dhe administrativ. Ky personel mbulon plotësisht nevojat e specializimeve të ofruara, në përputhje me kapacitetet e përcaktuara. Strukturat disponojnë departamente të kirurgjisë së përgjithshme dhe speciale, anestezi-reanimacion dhe pediatri, ndërsa institucionet partnere me të cilat janë lidhur marrëveshje plotësojnë standardet e kërkuara për shërbimet e përgjithshme dhe diagnostikuese. Studentët specializantë gjatë takimit me GVJ konfirmuan se pjesa e aftësisë praktik realizohet sipas programit mësimor edhe përtej normave të kërkuara, pasi nevoja e përditshme dinamike dhe me fluks të madh në këto institucione i bën që ata të tejkalojnë objektivat e programit në Veprimtaritë profesionale të detyrueshme. evidence 31 - Plani Mesimor.pdf Evidenza 32 - http://asck.gov.al/lista-e-institucioneve-te-akredituara-nga-asck/ Evidence 33 - Prezantim i Programit të specializimit.pdf Evidence 34 - Addendum i Protokollit Ekzekutiv.pdf

	Evidence 36 -Protokoll Ekzekutiv për hapjen dhe funksionimin e programeve të ciklit I, II, III të Universitetit KZKM.pdf			
Kriteri 5: Institucioni që ofron programet specializuese garanton se ka kapacitete të mjaftueshme në personel shëndetësor, ndihmës dhe administrativ në strukturat qendrore dhe dytësore për të mbuluar nevojat e specialiteteve të ofruara, në bazë të kapaciteteve.	GVJ bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit në dispozicion dhe takimit në institucion me stafin akademik dhe drejtues vëren së Universiteti është i strukturuar dhe menaxhuar në mënyrë të organizuar, duke disponuar dokumentacion të plotë mbi strukturën organizative, menaxhuese dhe stafin, ku përcaktohen qartë titujt dhe rolet e stafit administrativ dhe akademik sipas përgjegjësi përkatëse. Evidence 50 - Emerimi i Udheheqesve.pdf Evidence 49 - CV.pdf			
Kriteri 6: Institucioni që ofron programet specializuese është i mirëorganizuar dhe disponon dokumentacion që tregon mënyrën e organizimit dhe strukturën drejtuese si dhe personelin administrativ dhe akademik me titujt përkatës si dhe rolet e parashikuara për secilin.	Evidence 39 - Tabela e stafit akademik.pdf Evidence 34 - Addendum i Protokollit Ekzekutiv.pdf Evidence 36 -Protokoll Ekzekutiv për hapjen dhe funksionimin e programeve të ciklit I, II, III të Universitetit KZKM.pdf			
Konkluzione	<i>Pas vizitës në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" dhe shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar, vlerëson se përmbushen standardet infrastrukturore, teknologjike dhe organizative. Universiteti ofron mjedise bashkëkohore për studentët, duke përfshirë salla leksionesh, laboratorë të pajisur me teknologji moderne, bibliotekën "Paolo Ruatti" me një fond të pasur dhe akses në baza të dhënash ndërkombëtare. Këto struktura sigurojnë kushte të favorshme për mësimdhënie, kërkim shkencor dhe zhvillim profesional.</i> <i>Në aspektin e specializimeve mjekësore, GVJ vëren se Universiteti ka kapacitete të mjaftueshme për të mbështetur programin e Gjinekologjisë dhe Obstetrikës. Struktura qendrore dhe ato dytësore, të mbështetura nga marrëveshje me spitale universitare dhe terciare, ofrojnë shërbime diagnostikuese asistenciale dhe kirurgjikale. Institucioni ka një staf të kualifikuar, duke përfshirë mjekë, kirurgë, dhe teknikë shëndetësorë, të cilët mbulojnë të gjitha nevojat e specializimeve dhe praktikave klinike. Procesi i aftësimit praktik i studentëve realizohet sipas normave të kërkuara, duke reflektuar një dinamikë të lartë të fluksit dhe angazhimit profesional. Gjithashtu, universiteti është i mirë-organizuar, duke ofruar dokumentacion të qartë mbi strukturën menaxhuese dhe përgjegjësitë e stafit administrativ dhe akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Rrjeti formues plotëson kriteret minimale të parashikuara dhe është i përshtatshëm për të ofruar programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Institucioni plotëson kërkesat minimale të përgjithshme të parashikuara në këtë dokument përsa i përket rrjetit formues.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pas vizitës në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, takimit me pedagogët e programit, studentët specializant dhe shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar, vlerëson se Programi i specializimit të Gjinekologjisë dhe Obstetrikës realizohet sipas programit të përcaktuar dhe rregullores së specializimit. Institucioni plotëson strukturat bazë të përmbushjes së programit teorik në strukturat bazë të Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, dhe programin e aftësimit praktik në shërbimin ambulator të Spitalit ditor të UNIZKM dhe në strukturat e rrjetit formues.
Kriteri 2: Institucioni duhet të plotësojë kërkesat minimale specifike për çdo specialitet të parashikuara në shtojcën 2 të këtij dokumenti përsa i përket rrjetit formues.	Programi i specializimit realizohet në Klinikën Universitare të Universitetit si struktura qendrore për shërbimin ditor ambulator, konsultues dhe diagnostikues dhe në strukturat e rrjetit formues sipas konfirmimeve nga studentët, dokumentacioni i mbajtur për realizimin e aftësimit praktik (librezat e studentëve, raportet vjetore të studentëve) i përkasin fushës së Programit të specializimit të Gjinekologjisë dhe Obstetrikës bazuar në marrëveshjet përkatëse.
Kriteri 3: Kërkesat e përgjithshme dhe specifike janë të organizuara sipas kriterëve të mëposhtme: a. Përshtatshmëria e strukturave dhe pajisjeve, me shërbimet përkatëse të përgjithshme dhe diagnostikuese dhe ekzistencën në to të specialiteteve të ngjashme b. Ekzistenca e numrit dhe procedurave praktike të mjaftueshme për një formim të plotë profesional c. Burime financiare të mjaftueshme d. Tutorë dhe pedagogë të përshtatshëm dhe ekspertë e. Strukturë organizative e përshtatshme, me kapacitetet e nevojshme profesionale f. Programim i aktiviteteve orientuese, analizuese sipas kërkesave të tregut dhe përcaktimi i një programi formues g. Seleksionimi dhe vlerësimi i studentëve h. Efikasiteti dhe efienca në aktivitetet e ndryshme të parashikuara.	Marrëveshjet për Programin e Specializimit afatgjatë në “Gjinekologji dhe Obstetrikë” janë konkretisht me Qendrën Universitare Obstetrike-Gjinekologjike Koco Gliozheni, Tiranë, Spitalin Rajonal të Durrësit, dhe spitalin Spitalin Amerikan në Tiranë. Marrëveshjet e rrjetit formues me Universitetin e Romës “Tor Vergata”, me Spitalim M.G Figlie di San Camillo G. Vannini, Romë, me Eurosanità S.p.a Policlinico Casilino, Romë, IGreco Ospedale Riuniti, Spitali i Madh Bianchi Malacrino Morelli, Poliklinika e Barit, Fondazione Leonardo të cilat kanë strukturat e pavioneve/reparte apo shërbimit ambulator në obstetrikë dhe gjinekologji të duhurat për programin e specializimit, të konfirmuara në takimin me stafin akademik të udhëheqësve të specializantëve të lidhur online në strukturat spitalore përkatëse në Itali edhe të cituara në marrëveshjet përkatëse. Në takimin me studentët specializantë, GVJ mori informacionin se pjesa e aftësimit praktik realizohet sipas programit mësimor edhe përmjet objektivave të paracaktuara, pasi nevojat e përditshme dinamike dhe me fluks të madh në këto institucione i bënë që ata të tejkalonin objektivat e programit në Veprimtaritë profesionale të detyrueshme. Institucioni disponon dokumentacion që dëshmon përbërjen e rrjetit formues dhe të gjitha strukturave të përfshira në procesin e formimit specializues (qendrore dhe bazë), duke u mbështetur në evidencat e përmendura në këtë material. Evidencë 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM Evidencë 13 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Qendrës Universitare Obstetrike-Gjinekologjike Koco Gliozheni Evidencë 14 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Spitalit Rajonal Durrës

Kriteri 4: Institucioni disponon dokumentacion që provon përbërjen e rrjetit formues dhe të gjitha strukturave të përfshira në formimin specializues (qendrore/bazë).	Evidencë 14.1 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe "American Hospital" Sh.a Tiranë Evidencë 5 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Universitetit të Romës "Tor Vergata" Evidencë 15 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Spitalit M.G Figlie di San Camillo G.Vannini Evidencë 17 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe IGreco Ospedale Riuniti. Evidencë 18 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Spitalit të Madh Bainchi Melacrino Morelli. Evidencë 19 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Poliklinikës së Barit Evidencë 20 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Fondacionit Leonardo. Evidencë 16 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Eurosanita S.P.A Policlinico Casilino. Evidence 33 - Prezantim i Programit te specializimit.pdf Evidence 53 - Librezë e Studentit.pdf
Kriteri 5: Strukturat qendrore dhe dytësore të përfshira në formimin specializues duhet të jenë të akredituara sipas legjislacionit në fuqi.	Strukturat qendrore dhe ato dytësore që marrin pjesë në rrjetin e formimit të specializimit janë të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi, bazuar në evidencat përkatëse të përmendura në këtë material. Evidence 9 - Certificate Akreditimi Institucional nr112 dt 15,12,2017.pdf Evidenza 10 - https://www.anvur.it/attivita/ava/accreditamento-periodico/linee-guida-per-laccreditamentoperiodico/rapporti-anvur-di-accreditamento-periodico/ Evidenza 11 - https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2020/01/PUBLIKE-AKREDITIMBAZE.pdf
Kriteri 6: Institucioni duhet të disponojë dokumentacion që sqaron ekzistencën e shërbimeve të përgjithshme dhe diagnostikuese të përfshira në formimin e specializantëve. Shërbimet e përgjithshme dhe diagnostikuese të pranishme në strukturat shëndetësore pjesë e rrjetit formues nuk mund të jenë të ndryshme apo inferiore nga ato të parashikuara në shtojcën 2 për akreditimin e strukturave.	GVJ vëren se, në marrëveshjet përkatëse, me cdo strukturë të rrjetit, janë të përcaktuara specifikimet e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore, më numrin e njësive si: pavione me numër shtretërisht obsetrike dhe gjinekologjie në spitale, qendra dhe kabinete ambulatorë, shërbime multidisciplinare, qendra e gruas, laborator klinik biokimik/mikrobiologjik dhe anatomo-patologjik, salla operacioni, salla lindjeje, reparte neonatologjie, shërbim reanimacioni, kabinete diagnostikimi ekografie, kolposkopie, grafi, skopi, CT, MRI, si edhe të burimeve njerëzore me mjeke obsetër-gjinekolog dhe mjeke neonate, staf shëndetësor infermieror, laborantë, imazherist, etj. GVJ shpreh se institucioni e disponon dokumentacionin e duhur të shërbimeve të përgjithshme dhe diagnostikuese të përfshira në formimin e specializantëve bazuar në evidencat e marrëveshjeve përkatëse të rrjetit formues dhe të strukturës së qendrës ambulatorë në Strukturën qendrore në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"
Kriteri 7: Institucioni disponon dokumentacion që sqaron ekzistencën e specialiteteve të ngjashme në strukturat shëndetësore pjesë të rrjetit	GVJ vëren se në dokumentacionet e marrëveshjeve të rrjetit formues gjenden specifikime të infrastrukturës dhe të burimeve njerëzore, sipas specialitetit të programit të specializimit dhe të shërbimeve diagnostikuese të dokumentuara, i bashkëngjitet marrëveshjeve me strukturat shëndetësore pjesë të rrjetit formues në tabelat përkatëse. Për

formues, shërbimeve të përgjithshme dhe diagnostikuese të përfshira në formimin e specializantëve (sipas shtojcës 2).	më tepër, përmendet që strukturat kanë procedura praktike të përshtatshme për formimin profesional, duke përfshirë burime organizative dhe pedagogë ekspertë.
Kriteri 8: Institucioni disponon dokumentacion që sqaron numrin e shërbimeve mjekësore që ofron për ushtrimin profesional të specializantëve (sipas shtojcës 2).	Dokumentacioni mbi shërbimet mjekësore që ofrohen për specializantët është i bashkëlidhur me marrëveshjet përkatëse sipas programit të specializimit dhe planit mësimor, bazuar në nenet përkatëse në cdo marrëveshje që përcakton detyrimet edhe të drejtuesve të praktikës të cilët mbikqyrin, drejtojnë, dokumentojnë dhe kontribuojnë në zbatimin dhe përbushjen me sukses të praktikës së specializantëve në institucion.
Kriteri 9: Institucioni duhet të disponojë dokumentacion që sqaron aktivitetin asistencial vjetor të strukturave të përfshira në rrjetin formues. Aktiviteti asistencial vjetor që kryhet nga specializantët në kuadër të formimit të tyre nuk mund të jetë më i madh se 30% e aktivitetit asistencial total që kryejnë strukturat e përfshira në rrjetin formues (sipas shtojcës 2).	Pjesë përbërëse e angazhimit të institucioneve të rrjetit formues është edhe plotësimi i karakteristikës/formulari i përshkrimit apo vlerësimit të praktikantit- i cili plotësohet nga spitali në përputhje me programin e praktikës për cdo student, në përfundim të praktikës duke përshkruar nivelin e përvetësimit të dijeve gjatë praktikës në institucion.
	Evidencë 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM Evidencë 13 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Qendrës Universitare Obstetrike-Gjinekologjike Koco Gliozheni Evidencë 14 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Spitalit Rajonal Durrës Evidencë 14.1 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe "American Hospital" Sh.a Tiranë Evidencë 5 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Universitetit të Romës "Tor Vergata" Evidencë 15 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Spitalit M.G Figlie di San Camillo G.Vannini Evidencë 17 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe IGreco Ospedale Riuniti. Evidencë 18 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Spitalit të Madh Bainchi Melacrino Morelli. Evidencë 19 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Poliklinikës së Barit Evidencë 20 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Fondacionit Leonardo. Evidencë 16 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Eurosanita S.P.A Policlinico Casilino. Evidence 33 - Prezantim i Programit të specializimit.pdf Evidence 53 - Libreza e Studentit.pdf
Konkluzione	<i>Programi i Specializimit në Gjinekologji dhe Obstetrikë në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" përbush standardet e kërkuara dhe është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe objektivat akademike. Programi realizohet sipas rregullores së specializimit dhe ofron një kombinim të balancuar midis teorisë dhe praktikës. Kjo mbështetet nga dokumentacioni përkatës si librezat e studentëve dhe raportet vjetore, të cilat dëshmojnë përbushjen e objektivave.</i>




	Marrëveshjet me qendrat kombëtare dhe ndërkombëtare (p.sh., Qendra Universitare Obstetrike-Gjinekologjike "Koço Gliozheni", Spitali Rajonal i Durrësit, dhe spitale të tjera në Itali) sigurojnë mundësi për aftësimin praktik. Këto struktura janë të pajisura me pavione të standardizuara dhe burime njerëzore të kualifikuara, të cilat ofrojnë mbështetje për formimin e specialistëve. Strukturat e rrjetit formues janë të akredituara dhe plotësojnë kërkesat ligjore, duke përfshirë infrastrukturën e nevojshme dhe personelin për ofrimin e shërbimeve diagnostikuese dhe trajtimit.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Njësia përgjegjëse për programin e specializimit afatgjatë dëshmon qëndrueshmëri financiare dhe siguron mjetet e duhura të financimit dhe mbështetjes së studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Institucioni nëpërmjet raporteve dhe auditeve financiare dëshmon ecure pozitive dhe qëndrueshmëri në gjenerimin dhe përdorimin e të ardhurave financiare.	GVJ konstaton se Institucioni, përmes raporteve dhe auditimeve financiare, tregon një ecure pozitive dhe qëndrueshmëri në gjenerimin dhe menaxhimin e të ardhurave financiare. Pasqyrat financiare janë të përgatitura çdo vit dhe janë subjekt i auditimeve të brendshme dhe të jashtme, duke siguruar një administrim të mirë të financave dhe përdorimin e tij në përputhje me qëllimet e institucionit.
Kriteri 2: Njësia përgjegjëse siguron nëpërmjet institucionit, projekteve ose financimeve nga subjekte të tjera fondet e nevojshme për zhvillimin e programeve të specializimeve.	Njësia përgjegjëse siguron fondet e nevojshme për zhvillimin e programeve të specializimeve, si përmes aktivitetit të vet ekonomik ashtu edhe përmes projekteve dhe financimeve të jashtme. Kjo e bën të mundur mbështetje të qëndrueshme për programet e specializimit. GVJ gjatë takimit me drejtues pedagogë dhe student mori informacionin e përfshirjes dhe financimin e projekteve të përbashkëta pedagogë dhe studentë.
Kriteri 3: Programi i studimeve të specializimit afatgjatë mbështetet nga një buxhet i mjaftueshëm i njësisë përgjegjëse.	Programi i studimeve të specializimit afatgjatë mbështetet nga një buxhet i mjaftueshëm, që përfshin të ardhurat nga tarifat universitare dhe shërbime të tjera të ofruara nga institucioni. Buxheti përfshin gjithashtu shpenzimet për menaxhimin e financimit të programeve të specializimit.
Kriteri 4: Struktura e shpërndarjes së buxhetit financiar të programit të studimeve të specializimeve përputhet me politikën dhe zhvillimin e institucionit.	Struktura e shpërndarjes së buxhetit financiar për programin e studimeve të specializimeve është e përputhshme me politikën dhe zhvillimin e institucionit. Pasqyrat financiare janë të detajuara dhe përputhen me strategjitë e zhvillimit të institucioneve, duke siguruar mbështetje për fakultetet dhe programet e studimit.
Kriteri 5: Përdorimi i mjeteve financiare të alokuara për zhvillimin e programit të specializimit është objekt i	Përdorimi i mjeteve financiare të alokuara për zhvillimin e programit të specializimit është objekt i raportimit dhe auditimit të vazhdueshëm, duke siguruar që çdo fond i alokuar të përdoret në përputhje me planifikimin dhe objektivat financiare të institucionit.

47

raportimit dhe auditimit të vazhdueshëm.				
Konkluzione	<i>Institucioni përmbush kriteret e menaxhimit financiar, duke demonstruar një ecuri pozitive dhe qëndrueshmëri në përdorimin e të ardhurave financiare përmes raporteve dhe auditimeve të brendshme dhe të jashtme. Fondet e nevojshme për zhvillimin e programeve të specializimit sigurohen nga burime të ndryshme financiare, duke mbështetur buxhetin e programit të studimit dhe aktiviteteve të tjera të nevojshme. Struktura e shpërndarjes së buxhetit është në përputhje me politikën e institucionit dhe përdorimi i mjeteve është objekt i auditimit dhe raportimit të vazhdueshëm.</i> <i>Përgjithësisht, institucioni tregon një menaxhim të qëndrueshëm të fondeve financiare, duke siguruar mbështetje për zhvillimin e programeve të studimit dhe specializimeve, si dhe duke garantuar një përdorim efikas të burimeve për vitet e ardhshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




IV. KËRKIMI DHE EKSPERIENCA KLINIKE /DIAGNOSTIKUESE

Standardi IV.1	
Specializanti ka një tutor që e ndjek atë gjatë gjithë periudhës së specializimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Studenti ka një udhëheqës klinik (tutor) të diplomuar dhe specializuar në fushën e programit të studimit të aplikantit i cili ka një eksperiencë të paktën 10 (dhjetë) vjeçare në fushën klinike diagnostike me gradën “Doktor”.	GVJ në takimin e realizuar në institucion me stafin akademik dhe me studentët , u informua se, cdo specializant ka një udhëheqës (kontakt klinik) me përvojë 10 vjeçare si dhe me titullin “Doktor”, i cili i ndjek gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe është përgjegjës për orientimin, konsulencën dhe vlerësimin e nevojave të tyre, si dhe monitorimin e punës së tyre. Udhëheqësi është me përvojë profesionale dhe klinike në fushën specifike të specializimit në programin e specializimit që ndjek specializanti. Tutori mund të ndjek maksimumi 3 specializantë dhe mund të punojë me kohë të plotë në një nga strukturat e lidhura në marrëveshje dhe duhet të ketë një kontratë bashkëpunimi me strukturën e lidhur për kohëzgjatjen e programit të specializimit. Kur udhëheqësi nuk është pjesë e stafit akademik të institucionit që promovon programin e specializimit, specializanti ka në dispozicion një përfaqësues akademik nga institucioni, i cili mban të paktën titullin akademik PhD, në lidhje me specializimin. Në rast se përfaqësuesi kryesor nuk është i disponueshëm, specializanti vihet në dijeni për emrin e përfaqësuesit që do ta zëvendësojë atë. Udhëheqësit (përfaqësuesit klinik) të aftë për të udhëhequr rrugëtimin klinik dhe kërkimin shkencor të specializantëve zgjidhen nga këshilli drejtues i programit të specializimit, pas marrjes së mendimit pozitiv të departamentit përkatës dhe të dekanit të Fakultetit të Mjekësisë, bazuar në vlerësimin e aktiviteteve klinike dhe kërkimore. Fusha e specializimit të udhëheqësit klinik duhet të korrespondojë me programin e specializimit të specializantit. Udhëheqësi është përgjegjës për vazhdimin e veprimtarisë klinike të specializantit dhe njëkohësisht kujdeset edhe për organizimin dhe ndjekjen e praktikave klinike në përputhje me programin mësimor. Evidence 21 - Statuti i Universitetit. Evidence 22 -Rregullore e Fakultetit të Mjekësisë. Evidence 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM Evidence 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM Evidence 45 - Renditja e Konkursit të Pranimit për Programet e Specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë Viti akademik 2023 – 2024 Evidence 46 - Emërimi i Komisionit për Konkursin e Pranimit – Programe Specializimi Afatgjata në Fushën Mjekësore, Fakulteti i Mjekësisë Vizitë në institucion
Kriteri 2: Njësia bazë përgjegjëse/shërbimi përgjegjës përzgjedh udhëheqësit klinikë, të	GVJ në vizitën në institucion dhe takimin me drejtues të institucionit u informua se, njësia bazë përgjegjëse/ (departamenti) përzgjedh udhëheqësit klinikë, të aftë për të drejtuar specializantët në vitet e

aftë për të drejtuar punën klinike e kërkimore të specializantëve, mbështetur në vlerësimin e veprimtarive klinike e kërkimore botuese të tyre, brenda e jashtë vendit.	studimit. Udhëheqësit klinikë mund të ndjek maksimumi 3 specializantë, sipas rregullores së Institucionit, rregullores së Fakultetit të mjekësisë dhe mund të punojë me kohë të plotë në një nga strukturat e lidhura në marrëveshjet e bashkëpunimit dhe po kështu ka një kontratë bashkëpunimi me strukturën e lidhur për kohëzgjatjen e programit të specializimit (5 vite akademike). Udhëheqësi klinikë e udhëzon dhe orienton specializantin në punën në klinikë, në punën kërkimore, në botimet e kërkimeve shkencore brenda dhe jashtë vendit. Kur udhëheqësi nuk është pjesë e stafit akademik të institucionit që promovon programin e specializimit, specializanti ka në dispozicion një përfaqësues akademik nga institucioni, i cili mban të paktën titullin akademik PhD, në lidhje me specializimin. Evidence 22 - Rregullore e Fakultetit të Mjekësisë. Evidence 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM Evidence 13 - Marrëveshje Geraldina. Evidence 14 - Marrëveshje midis UniZKM dhe Spitalit Rajonal të Durrësit. Evidence 14.1 - Marrëveshje midis Uni ZKM dhe Spitalit Amerikan. Evidence 15 - Marrëveshje me Spitalin M.G Figlie San Camillo G.Vannini. Evidence 16 - Marrëveshje me Eurosanita. Evidence 17 - Marrëveshje IGreco. Evidence 18 - Marrëveshje midis UKZKM dhe Spitalit Bianchi Malacrino Morelli. Evidence 19 - Marrëveshje me Polikliniken e Barit. Evidence 20 - Marrëveshje me Fondazione Leonardo.
Kriteri 3: Tutori është i punësuar me kohë të plotë pranë njëres nga strukturat e rrjetit formues dhe ka një kontratë bashkëpunimi me institucionin që ofron programin specializues.	Në takimin e bërë me drejtuesit e institucionit, shefin e departamentit, studentët si dhe stafin akademik, u referua se kur udhëheqësi nuk është pjesë e stafit akademik të institucionit që promovon programin e specializimit, specializanti ka në dispozicion një përfaqësues akademik nga institucioni, i cili mban të paktën titullin akademik PhD, në lidhje me specializimin. Drejtuesit e programit të specializimit marrin informacion nëse udhëheqësit e caktuar janë ose jo disponibël për të udhëhequr specializantin në rruëtimin e tij 5 vjeçar. Në rast se përfaqësuesi kryesor nuk është i disponueshëm, specializanti vihet në dijeni për emrin e përfaqësuesit që do ta zëvendësojë atë. Udhëheqësi klinik ka marrëveshje bashkëpunimi dhe një kontratë bashkëpunimi me strukturën e lidhur për kohëzgjatjen e programit të specializimit. Evidence 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM
Kriteri 4: Udhëheqësit klinikë punojnë për përditësimin e njohurive dhe aftësive të tyre, mbështetur në marrëveshjet institucionale, me qëllim mundësimin e shkëmbimeve të praktikave më të mira dhe dhënien	GVJ konstaton se udhëheqësit (përfaqësuesit klinikë) të aftë për të udhëhequr rrugëtimin klinik dhe kërkimin shkencor të specializantëve zgjidhen nga këshilli drejtues i programit të specializimit, pas marrjes së mendimit pozitiv të departamentit përkatës dhe të Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë, bazuar në CV, vlerësimin e aktiviteteve klinike dhe kërkimore. Fusha e specializimit të udhëheqësit klinikë duhet të

e këshillave në mbështetjen efektive të studentëve.	korrespondojë me programin e specializimit t afatgjatë në "Gjinekologji dhe Obstetrikë" të specializantit.
Kriteri 5: Udhëheqësi klinik ka ekspertizën, formimin dhe udhëzimet e duhura për rolin e tij në udhëheqjen e specializantit në realizimin e studimeve specializuese dhe në veçanti të pjesës praktike/klinike.	GVJ sic ttheksoi dhe më lartë konstatoi se Udhëheqësi klinik është minimum me gradën "Doktor", dhe në këto kushte ka përvojën në formimin dhe udhëzimet e duhura për rolin e tij në udhëheqjen e specializantit Udhëheqësi që mban titullin e përfaqësuesit klinik i mëson specializantit procedurat teknike dhe praktike duke e bërë atë të marrë pjesë drejtpërdrejt në të gjitha fazat e diagnostikimit dhe trajtimit të. Udhëheqësi mbikqyr në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e specializantit dhe nënshkruan librezën e specializantit çdo muaj, dhe bazuar në standardet e përcaktuara bën një vlerësim vjetor të specializantit mbi bazën e aftësisë për të kryer me sukses procedurat teknike të praktikës mjekësore. Udhëheqësit klinikë të përfshirë në monitorimin e specializantëve të regjistruar në programin e specializimit afat gjatë "Gjinekologji dhe Obstetrikë" plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi Evidencë 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM Referenca 124 neni 12,13
Kriteri 6: Udhëheqësi klinik nuk mund të mbikëqyrë më shumë se 3 (tre) studentë njëkohësisht.	Në Rregulloren e Institucionit, Rregulloren e Fakultetit të Mjekësisë si Rregulloren e specializimeve afatgjata "Gjinekologji dhe Obstetrikë", shprehet qartë se një mjek klinikist me gradën minimum "Doktor "mund të udhëheqi deri në tre specializantë. Evidencë 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM Referenca rregulloret
Kriteri 7: Fusha e specializimit të udhëheqësit përputhet me atë të programit specializues që ndjek specializanti.	GVJ sic është shprehur dhe në rubrikat e mësipërme, bazuar në Rregulloren e Institucionit, Rregulloren e Fakultetit të Mjekësisë si Rregulloren e specializimeve afatgjata "Gjinekologji dhe Obstetrikë", shprehet qartë se një mjek klinikist me gradën minimum "Doktor", duhet të ketë të njëjtin specializim me specializantin që po kryen studimet specializimit afatgjat "Gjinekologji dhe Obstetrikë".
Kriteri 8: Në të gjitha rastet, studenti ka vetëm një pikë të identifikuar kontakti, i cili duhet të jetë udhëheqësi klinik kryesor i tij. Nëse udhëheqësi kryesor nuk është në dispozicion, studentit i bëhet e ditur se cili do të jetë personi që do ta zëvendësojë.	Në takimin me drejtues të institucionit GVJ ju referua se drejtuesit e programit të specializimit marrin informacion nëse udhëheqësit e caktuar janë ose jo disponibël për të udhëhequr specializantin në rrugëtimin e tij 5 vjeçar. Në rast se përfaqësuesi kryesor nuk është i disponueshëm, specializanti vihet në dijeni për emrin e përfaqësuesit të ri , që do ta zëvendësojë atë dhe da ta udhëheqi në periudhën e specializimit. Udhëheqësi klinik ka marrëveshje bashkëpunimi dhe një kontratë bashkëpunimi me strukturën e lidhur për kohëzgjatjen e programit të specializimit.
Kriteri 9: Institucioni siguron që udhëheqësi të ketë kohën e mjaftueshme për ta mbikëqyrur specializantin.	Udhëheqësi klinikist që do të mbikqyri specializantin ka kohën e mjaftueshme për të udhëhequr specializantin pasi kjo punë futet në ngarkesën mësimore nga njëra anë si dhe është pjesë e stafit akademik definitive të fakultetit ose nëse është PAK ka marrëveshje dhe kontrata bashkëpunimi midis institucionit dhe udhëheqësit klinik. Evidencë 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM

	Evidencë 13 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Qendrës Universitare Obstetrike Gjinekologjike "Koço Gliozheni" Tiranë Evidencë 14 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Spitalit Rajonal Durrës Evidencë 14.1 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe "American Hospital" Sh.a Tiranë Evidencë 15 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Spitalit M.G Figlie di San Camillo G. Vannini Romë Evidencë 16 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Eurosanità S.p.a Policlinico Casilino Romë Evidencë 17 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe IGreco Ospedale Riuniti Evidencë 18 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Spitalit të Madh "Bianchi Malacrino Morelli" Evidencë 19 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Poliklinikës së Barit Evidencë 20 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Fondacionit Leonardo			
Konkluzione	<i>Në informacionin e mbledhur dhe vizitat në institucion konstatohet se, Specializanti ka një udhëheqës klinik me të njëjtin specializim që ndjek studentin-specializant, që e ndjek atë gjatë gjithë periudhës së specializimit, që udhëheqësi miratohet nga institucioni, i cili ka gradën "Doktor" si dhe mund të udhëheq deri në 3 specializantë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Objektiva të programit të studimit të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë janë angazhimi i vazhdueshëm në punën klinike e kërkimore dhe nxitja e punës në ekip e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Studenti angazhohet në punën klinike e kërkimore për aftësimin dhe përfundimin me sukses të programit të studimit.	GVJ në takimin me specializantët dhe drejtues të institucionit u konstatua se gjatë formimit të tij 5 vjeçar, specializanti fiton njohuritë teorike, aftësitë praktike dhe elementet e nevojshme etike dhe profesionale. Studenti ka detyrimin të marrë pjesë në zbatimin e programit teorik dhe praktik të specialitetit përkatës për të cilin vihet në dijeni që në fillim të specializimit dhe vlerësohet për lëndët përkatëse në cdo fundviti duke u plotësuar me 60 kredite. Objektivat kryesore të programit të specializimit afatgjatë në mjekësi të cilat shprehohen edhe në syllabuse, janë angazhimi për kërkimin klinik, punën shkencore dhe promovimin e punës ekipore. Studenti merr pjesë në aktivitete të ndryshme klinike- konferenca, kongrese të Gjinekologjisë & obsetrikës të lidhura ngushtë me fushën specifike të specializimit, me qëllim rritjen e aftësive të tij profesionale: Si fitimi i metodologjive dhe njohurive klinike, kërkimore për aktivitet shkencor autonome si: artikuj shkencorë, prezantime të rasteve klinike

	që specializanti i trajton gjatë viteve të specializimit. Po ashtu puna e pavarur në laborator/klinik/sallë operacioni/ rojeve 24 orëshe ndihmon në rritjen profesionale si dhe në pavarësinë e veprimeve ndaj pacientëve.; Institucioni zotëron një bibliotekë me literaturë fizike të larmishme ,por edhe bibliotekën on-line që ju sygjerohet specializantëve falas. Këto informacione bashkëkohore. bibliotekat dhe interneti, bazat e të dhënave shkencore/ klinike) dhe menaxhimi i informacionit; përdorimi i teknologjive moderne për prezantime shkencore; fitimi i metodave novatore të analizës dhe përpunimit të të dhënave; njohja dhe të zotërimi i terminologjisë së specializuar në lidhje me sektorin klinik të specializimit i japin mundësi specializantit në bashkëpunim dhe me udhëheqësin klinik që të jetë mjaft i përgatitur nga ana profesionale dhe të jetë i aftë të paraqes dhe të punoj mirë dhe për kërkimin shkencor. Specializanti i programit të specializimit merr pjesë në veprimtaritë e parashikuara nga programi i studimit jashtë punës së tij klinike. Specializanti është i lirë të marrë pjesë si dëgjues ose relator në: leksione ;seminare , laboratore që shprehen qartë dhe në përmbajtje të syllabusit dhe programit të specializimit afatgjatë në “Gjinekologji&Obstetrikë”
Kriteri 2: Studenti merr pjesë në aktivitete të ndryshme klinike të lidhura ngushtë me fushën specifike në të cilën ndjek studimet e specializimeve, të cilat e ndihmojnë të aftësohet për: a. Përvetësimin e metodologjive dhe njohurive klinike e kërkimore për veprimtari krijuese të pavarura si: artikuj shkencorë, prezantime, etj; b. Punën e pavarur në laborator/klinikë; c. Përdorimin e burimeve të informacionit (p.sh. bibliotekat dhe internetin, databazat me karakter shkencor/klinik) dhe administrimin e informacionit; d. Përdorimin e teknologjive bashkëkohore për prezantime publike; e. Përvetësimin e metodave të avancuara të analizës dhe përpunimit të të dhënave; f. Njohjen dhe përvetësimin e terminologjisë së specializuar	Specializanti ashtu sic parashikohet dhe në rregulloren e specializimit mund të marrë pjesë në tryeza të rumbullakta ndërdisiplinore të organizuara në kuadër të programit të specializimit, si dhe pjesëmarrja në konferenca, kongrese, ëork shope të natyrës klinike “Gjinekologji & Obstetrikë”. GVJ konstaton se studentëve të pranuar në programin e studimit të specializimit afatgjatë u ofrohet infrastruktura e nevojshme për të kryer programin e studimit akademik dhe klinik. Programi i specializimit afatgjatë , infrastruktura e vënë në dispozicion , synon të sigurojë përputhjen e objektivave të programit të studimit, në fushën e kërkimit klinik dhe shkencor dhe në fund të programit 5 vjecar , specializanti të ketë gjithashtu mundësinë për një karrierë profesionale të sukseshme dhe mundësi punësimi. Specializantit i sigurohet vazhdimisht mbështetje teknike për zhvillimin e aktiviteteve klinike dhe kërkimore. Udhëheqësi klinik në mënyrë të vazhdueshme mbikqyr gjatë gjithë programit të specializimit kryerjen e detyrave profesionale të specializantit. Gjithashtu specializanti duhet të ketë sjellje korrekte etike dhe profesionale me pacientët, pedagogët dhe kolegët, në përputhje me rregullat e etikës mjekësore, duke fituar aftësi për komunikim korrekt me të tjerët: kompetencën për të përshkruar në mënyrë të qartë rastet klinike; përdorimin e argumenteve bindëse dhe artikulimin e qartë të ideve para pacientit dhe kolegeve; zotësinë për të debatuar dhe mbështetur të tjerët, të përfshirë, në klinikë, mbikqyrje ose demonstrime. Në rast të shkeljeve disiplinore, specializanti i nënshtrohet, si të gjithë mjekët e tjerë, masave disiplinore të marra nga Universiteti, Urdhri i Mjekëve dhe organet e tjera kompetente.

lidhur me fushën klinike të specializantit.	GVJ bazuar në rregullorene specializimit , takimit me drejtues të institucionit , takimi me specializantët konstatoi që specializanti para diplomimit , në përmbyllje të specializimit të ketë realizuar në bashkëpunim me udhëheqësin klinik të ketë botuar ose të jetë pranuar të paktën një artikull kërkimor shkencor/eksperimental në një revistë shkencore brenda ose jashtë vendit, ku garantohej sistemi antiplagjaturë me një ngjashmërisë të artikullit të jetë nën 30%. Po ashtu ai duhet të ketë marrë pjesë në jo më pak se 2 aktivitete shkencore kombëtare / ndërkombëtare në fushën përkatëse të specializimit “Gjinekologji & Obstetrikë”.
Kriteri 3: Studenti i programit specializues merr pjesë në aktivitetet e parashikuara të programit të studimit jashtë punës së tyre klinike. Specializanti është i lirë të marrë pjesë si dëgjues apo si referues në: a. Ligjërata; b. Seminare; c. Debate ndërdisiplinore, të organizuara në kuadër të programit të studimit të specializimeve; d. Mundësi të tjera të të mësuarit si: ndjekja e prezantimeve të konferencave dhe seminareve të ndryshme me karakter klinik. Udhëheqësit i këshillojnë studentët të marrin pjesë në aktivitete dhe konferenca shkencore që i ndihmojnë në punën e tyre dhe klinike.	Evidencë 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM Evidencë 68 - Certifikata Konferencash Specializantë(Neni 26, 27, 28, 39) Evidencë 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM Evidencë 31 - Plani Mësimor i Programit të Specializimit “Gjinekologji dhe Obstetrikë” Evidencë 38 - Silabuse Evidencë 39 - Tabela e Stafit Akademik Evidencë 34 - Shtojcë e Protokollit Ekzekutiv “Për Hapjen dhe Funksionimin e cikleve I, II dhe III të Universitetit të Romës “Tor Vergata” pranë Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”” ‘Evidencë 40 - Emërimi i Drejtorit të Programit të Specializimit Afatgjatë në “Gjinekologji dhe Obstetrikë
Kriteri 4: Studenti para diplomimit të tij, duhet të ketë botuar ose të pranuar të paktën një artikull kërkimor shkencor/eksperimental në një revistë shkencore brenda ose jashtë vendit, ku garantohej që niveli i ngjashmërisë artikullit të jetë nën 30%. Po ashtu ai duhet të ketë marrë pjesë në jo më pak se 2 aktivitete shkencore kombëtare dhe/ose ndërkombëtare në fushën përkatëse të specializimit.	

Kriteri 5: Studenti fiton aftësi për komunikimin e duhur me nivel profesional.				
Kriteri 6: Studenti ndjek rregullat e sjelljes etike dhe profesionale me pacientët dhe kolegët dhe fiton aftësi për komunikim korrekt me të tjerët.				
Konkluzione		Në programin e studimit të specializimit afat gjatë "Gjinekologji & Obsetrikë" objektivat e programit të studimit të specializimeve afatgjata në fushën e "Gjinekologji & Obsetrikës". Janë shprehur qartë kriteret dhe kompetencat që duhet të plotësoj specializanti në fund të studimeve, për tu futur në provimin e diplomës duke nxitur maksimalisht punën kërkimore me udhëheqësin klinik si dhe bashkëpunimn në grup.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT

Standardi V.1	
Studenti që ka përfunduar një program të integruar të studimeve në fushat e mjekësisë, farmacisë, stomatologjisë, plotëson standardet akademike të kriterëve të pranimit të institucionit respektiv dhe gëzon të drejtën për t'u regjistruar në programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Aplikanti që kërkon të pranohet në programin e studimeve specializues i nënshtrohet provimit të pranimit në programin e studimit specializues për të cilin ka aplikuar.	GVJ në takimin me drejtues të institucionit , në referencat e vëna në dispozicion, konstaton se procesi i pranimit në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” organizohet në përputhje me legjislacionin aktual dhe dekretet e nxjerra çdo vit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, të cilat përcaktojnë procedurat e regjistrimit dhe afatet përkatëse për të gjithë kandidatët që dëshirojnë të aplikojnë në Fakultetin e Mjekësisë dhe Programet e Specializimit afatgjatë. ZKM publikon çdo vit në faqen e tij online njoftimin e konkursit, i cili përcakton kriteret, objektivat, kërkesat dhe metodat për pjesëmarrje në konkursin për pranim në ciklin e tretë në Fakultetin e Mjekësisë. Mund të aplikojnë për tu pranuar në studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë të “Gjinekologji dhe Obstetrikë” kandidatët që kanë përfunduar programin e studimeve universitare të integruara të ciklit të dytë në: Mjekësi e Përgjithshme ose Mjek Kirurg, në institucionet universitare të akredituara për programin e sipërpërmendur, dhe që kanë marrë titullin Master Shkencor në programin e studimit të sipërpërmendur, ose dhe ata që kanë marrë titullin Master Shkencor jashtë Republikës së Shqipërisë, të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Për studentët e diplomuar në vendet perëndimore që kanë marrë diploma ekuivalente, nuk është e nevojshme për notën mesatare për t'u pranuar në programet e specializimit afatgjatë në Mjekësi. Lista e këtyre vendeve perëndimore të sipërpërmendura përcaktohet me një Dekret konkret ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale <i>Evidencë 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM</i> <i>Evidencë 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM</i> <i>Evidencë 45 - Renditja e Konkursit të Pranimit për Programet e Specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë Viti akademik 2023 - 2024</i> <i>Evidencë 46 - Emërimi i Komisionit për Konkursin e Pranimit – Programe Specializimi Afatgjata në Fushën Mjekësore, Fakulteti i Mjekësisë</i>
Kriteri 2: Institucioni disponon një model teorik të informatizuar për përcaktimin e njohurive, kapacitetit, aftësive të aplikantëve në këndvështrime të ndryshme (operativ, konjitiv e relacionues).	GVJ bazuar në rregullore të Institucionit, të specializimeve afat gjata vë re se ZKM ka të detajuara dhe të mirëstrukturuara ,të gjithë elementët e strukturës së programit të studimit, pranimi i studentëve, mënyra e përzgjedhjes së kandidatëve, të drejtat dhe detyrat e studentëve përcaktohen në Rregulloren e studimeve të specializimit. Rregullorja parashikon gjithashtu se në fund të çdo viti akademik do të

	organizohet një provim vlerësues teorik dhe praktik. Vlerësimi bëhet nga një komision sipas nenit 14. Gjithashtu, në fund të çdo viti udhëheqësit klinikë përpilojnë raporte vjetore për aktivitetin praktik të specializantëve Kandidatët që synojnë të marrin pjesë në përzgjedhjen e pranimi duhet të paraqiten për të kryer testet e pranimi dhe janë subjekt i vlerësimit nga Komisioni, i cili vlerëson pikët sipas kërkesave të përcaktuara në njoftimin e pranimi, duke renditur kandidatët për të njëjtin program specializimi në një renditje sipas meritës (Neni 18). Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një komision i posaçëm i caktuar me dekret të Rektorit <i>Evidencë 41 - Rregullore për studimet afatgjata e specializimit në Mjekësi, në UKZKM, 2017</i> <i>Evidencë 42 - Rregullore për studimet afatgjata të specializimit në Mjekësi, në UKZKM, 2019</i> <i>Evidencë 12 - Rregullore për studimet afatgjata të specializimit në Mjekësi, në UKZKM, 2023</i> <i>Evidencë 12 - Rregullore për studimet afatgjata të specializimit në Mjekësi, në UKZKM, 2023</i> <i>Evidencë 43 – Vlerësim i Udhëheqësve Klinik</i> <i>Evidencë 44 - Njoftim për Konkursin e Programeve të Specializimit afatgjatë në fushën e Mjekësisë</i> <i>Evidencë 45 - Renditja e Konkursit të Pranimi për Programet e Specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë Viti akademik 2023 - 2024</i> <i>Evidencë 46 - Emërimi i Komisionit për Konkursin e Pranimi – Programe Specializimi Afatgjata në Fushën Mjekësore, Fakulteti i Mjekësisë</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 3: Institucioni shpall paraprakisht programin e parashikuar për provimin e pranimi dhe instrumentat që përdor për përcaktimin e njohurive, kapacitetit, aftësive të aplikantëve në këndvështrime të ndryshme.	GVJ në takimin me drejtues të institucionit , bazuar dhe në rregulloren e specializimeve afatgjata konstatoi se Institucioni paraprakisht shpall kuotat , kriteret e pranimi si dhe programin ku do të bëhet testimi i kandidatëve. Vlerësimi i kandidatëve dhe përzgjedhja e tyre do të bëhet përmes një konkursi pranimi, i cili parashikon një sistem vlerësimi të përbërë nga 100 pikë, të ndara në: 30 pikë – test mbi njohuritë e përgjithshme të lëndës 40 pikë – test mbi njohuritë specifike të programit të specializimit; 20 pikë – nota mesatare e ponderuar e kandidatëve që kanë marrë diplomën në Shqipëri dhe nota e diplomës për kandidatët e diplomuar jashtë vendit. 10 pikë – intervistë me gojë Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet sipas rankimit dhe rankimimi bëhet nga një komision i posaçëm i caktuar me dekret të Rektorit në përbërje të të cilit janë (Dekani, 2 anëtar të departamentit, dhe një specialist obsetër& gjinekolog). <i>Evidencë 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM, neni 16, neni 17, neni 20</i>

	<i>Evidencë 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM, 2023, neni.24</i> <i>Evidencë 44 - Njoftim për Konkursin e Programeve të Specializimit afatgjatë në fushën e Mjekësisë</i> <i>Evidencë 45 - Renditja e Konkursit të Pranimit për Programet e Specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë Viti akademik 2023 - 2024</i> <i>Evidencë 46 - Emërimi i Komisionit për Konkursin e Pranimit – Programe Specializimi</i>			
Kriteri 4: Institucioni vlerëson në mënyrë të vazhdueshme politikat e pranimiit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit.	GVJgjatë vizitës në institucion, referencave të vëna në dispozicion konstatoi se Institucioni ka infrastrukturën e duhur për përpilimin e politikave të pranimiit. Institucioni ka një zyrë të pranimiit të studentëve , e cila njofton kandidatët për programet e specializimit që ofron institucioni i ZKM, informon lidhur me procedurat e pranimiit, kohëzgjatjen e programit, aktivitetet mësimore dhe praktike të planifikuara, metodat e vlerësimit, kriteret për marrjen e diplomës dhe informacione të tjera përkatëse. Procedurat e pranimiit në Universitetin KZKM publikohen në faqen zyrtare të Universitetit www.unizkm.al nëpërmjet njoftimeve specifike të pranimiit, të cilat përmbajnë informacion të detajuar për kuotat, kriteret e pranimiit etj. Njoftimi publikohet në faqen zyrtare të Universitetit në fillim të cdo viti akademik <i>Evidencë 44 - Njoftim për Konkursin e Programeve të Specializimit afatgjatë në fushën e Mjekësisë</i> <i>Evidencë 45 - Renditja e Konkursit të Pranimit për Programet e Specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë Viti akademik 2023 - 2024</i> <i>Evidencë 46 - Emërimi i Komisionit për Konkursin e Pranimit – Programe Specializimi Afatgjata në Fushën Mjekësore, Fakulteti i Mjekësisë</i> <i>Evidencë 69 -</i> https://www.unizkm.al/uploads/media/university/0001/06/914050529769f8137b854fd1b71bb5124b4bc803.pdf Vizita në institucion			
Konkluzione	<i>Ekzistojnë rregullore, praktika në këtë Institucion i cili në mënyrë korrekte bën që cdo Student që ka përfunduar një program të integruar të studimeve në fushat e mjekësisë/ kirurgjisë plotëson standardet akademike të kriterëve të pranimiit dhe ka të drejtën për aplikuar/ konkuruar në programin e specializimit afatgjat në "Gjinekologji dhe Obsetrik".</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin dhe të dhënat e studentëve që ndjekin programet e studimit specializuese afatgjata.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																			
Kriteri 1: Institucioni ka një pasqyrë të përvitshme për numrin e të diplomuarve, në programet specializuese afatgjata, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik.	Gjatë vizitës në institucion, takimit me koordinatoren e specializimeve afatgjata në ZKM, zyrën e pranimeve dhe sekretarinë mësimore GVJ, konstatoi se ky program studimi i specializimeve afat gjata në “Gjinekologji dhe Obsetrik” ka nisur që në vitin akademik 2018-2019 , akoma nuk është diplomuar brezi i parë pasi nuk është bërë akreditimi i programit përkatës. GVJ konstatoi se ka një pasqyrë të përvitëshme sipas viteve akademike për kuotat e kërkuara , aplikantëve, të rregjistruar dhe që kanë vazhduar rregullisht procesin mësimor sipas tabelës së mëposhtme: <table><tr><th>Viti akademik</th><th>kuota</th><th>Të rregjistruar</th><th>Të transferuar</th><th>Raporti shqiptar/ të huaj(italian)</th></tr><tr><td>2018-2019</td><td>4</td><td>2</td><td></td><td>shqipëtar</td></tr><tr><td>2019-2020</td><td>4</td><td>4</td><td></td><td>2 shqiptar/2 italian</td></tr><tr><td>2020-2021</td><td>4</td><td>5</td><td>1 i tërhequr</td><td>2 shqiptar/2 italian</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>4</td><td>5</td><td></td><td>4 shqipëtar/1 italian</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>4</td><td>4</td><td>1 i rregjistruar</td><td>3 shqipëtar/1 italian</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>4</td><td>3</td><td></td><td>3 shqipëtar</td></tr></table>	Viti akademik	kuota	Të rregjistruar	Të transferuar	Raporti shqiptar/ të huaj(italian)	2018-2019	4	2		shqipëtar	2019-2020	4	4		2 shqiptar/2 italian	2020-2021	4	5	1 i tërhequr	2 shqiptar/2 italian	2021-2022	4	5		4 shqipëtar/1 italian	2022-2023	4	4	1 i rregjistruar	3 shqipëtar/1 italian	2023-2024	4	3		3 shqipëtar
Viti akademik	kuota	Të rregjistruar	Të transferuar	Raporti shqiptar/ të huaj(italian)																																
2018-2019	4	2		shqipëtar																																
2019-2020	4	4		2 shqiptar/2 italian																																
2020-2021	4	5	1 i tërhequr	2 shqiptar/2 italian																																
2021-2022	4	5		4 shqipëtar/1 italian																																
2022-2023	4	4	1 i rregjistruar	3 shqipëtar/1 italian																																
2023-2024	4	3		3 shqipëtar																																
Kriteri 2: Institucioni zotëron të dhëna individuale për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi (notat e mëparshme p.sh. vlerësimin e studentëve në programin e mëparshëm të studimit, etj.).	GVJ gjatë takimit në institucion me sekretarinë dhe kordinatoren e studimeve të specializimit afatgjatë “Gjinekologji dhe Obsetrikë” , konstatoi se në sekretari ka informacion të detajuar për rregjistrimet, crregjistrimet, mbarvajtjen vjetore , të dhënat ishin edhe fizikisht në rregjistra edhe në mënyrë elektronike në kompjuter. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore disponon të gjithë dokumentacionin që lidhet me ecurinë akademike të studentit si procesverbalet e provimeve që marrin të gjithë në fund të çdo viti akademik, raporte mbi veprimtarinë praktike të udhëheqësve/ tutorëve klinikë; çdo kualifikim dhe certifikatë pjesëmarrjeje në punime shkencore të botuara në revista të specializuara, në projekte kërkimore, kurse gjuhësore, Master, Doktoraturë, etj. Janë në dosjen individulale të cdo specializanti. GVJ konstatoi se nuk kishte rregjistra që nga 2018 e në vazhdim , të cilët duhet të vijnë nga QSHA për të hedhur vlerësimin vjetor në vazhdim të specializantëve , pavaresisht kërkesës së bërë nga institucioni. GVJ konstatoi se nuk kishte nota për cdo lëndë apo modul sipas viteve akademike dhe sipas programit të studimit, por vetëm një provim përfundimtar vjetor, sipas urdhërit të Dekanit prot6-1/20 datë20/02/2020, në këtë provim përmbledhet matëriali i të gjitha lëndëve/ moduleve sipas viteve akademike.																																			

	Sygjerime: 1- Institucioni të insistojnë të paise me rregjistrat model për vlerësimin në vazhdim nga QSHA Evidencë 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM, neni 16, neni,17, neni 20, neni 24 Evidence 31 - Plani Mesimor.pdf Evidencë 44 - Njoftim për Konkursin e Programeve të Specializimit afatgjatë në fushën e Mjekësisë Evidencë 61 - Procesverbal i Këshillit Drejtues të Programit të Specializimit në Gjinekologji dhe Obstetrikë / Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM Evidencë 72 - Portali i Studentëve			
Konkluzione	<i>Institucioni/ sekretaria disponon të dhëna të plota statistikore në lidhje me numrin e studentëve dhe të dhënat për cdo student, në ecurinë vjetore që ndjekin programet e studimit specializuese afatgjata "Gjinekologji dhe Obsetrik" sipas rregulloreve të in stitucionit dhe e studentëve</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Studenti informohet në mënyrë të detajuar për programin e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit.	GVJ në takim me kordinatoren e specializimeve si studentët e specializimit afatgjatë në "gjinekologji dhe Obsetrik", u informua se student informohet në mënyrë të dtajuar për programin 5 vjecar të studimit. Lëndët, modulet, ktreditet, kohëzgjatja, detyrimet jo vetëm financiare , por edhe detyrimet për përmbylljen me sukses të viteve akademike. Mënyrën e vlerësimit , provimin përfundimtar për cdo vit akademik. Detyrimet për mbylljen dhe punimin e diplomës. Cdo informacion merret on-line, ne takimet në institucion si dhe në rregulloren e Institucionit, rregulloren e specializimeve afatgjata. studentët e specializimit afatgjatë që në fillim të rregjistrimit u bëhet me dije program mësimor, i organizuar në 5 vite akadem8ike, cdo vit ka 60 kredite të ndara në dy semestral me nga 30 kredite për cdo semestër, dhe në fund të 5 viteve studenti i specializimit afatgjatë"Gjinekologji dhe Obsetrik" , ka në total 300 kredite. <i>Evidencë 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM, neni 16, neni,17, neni 20, neni 24</i> <i>Evidence 31 - Plani Mesimor.pdf</i> <i>Evidencë 44 - Njoftim për Konkursin e Programeve të Specializimit afatgjatë në fushën e Mjekësisë</i>

	<i>Evidencë 45 - Renditja e Konkursit të Pranimit për Programet e Specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë Viti akademik 2023 - 2024</i> <i>Evidencë 46 - Emërimi i Komisionit për Konkursin e Pranimit – Programe Specializimi Afatgjata në Fushën Mjekësore, Fakulteti i Mjekësisë</i> <i>Evidencë 69</i> https://www.unizkm.al/uploads/media/university/0001/06/914050529769f8137b854fd1b71bb5124b4bc803.pdf <i>Vizita në institucion</i>			
Kriteri 2: Studenti informohet nga njësia përgjegjëse për rezultatet e vlerësimit.	Në vizitën në institucion GVJ u informua se studentët bëjnë një provim përfundimtar cdo vit akademik ku në këtë provim përmbledhen të gjitha lëndët sipas viteve, ra në fund të 5 vjetorit studenti ka ne listën e notave 5 nota të provimeve vjetore. Studentët e specializimit afatgjatë "Gjinekologji dhe Obstetrik" pasi janë regjistruar, kandidati konsiderohet i regjistruar zyrtarisht dhe që në fillim të programit, Universiteti do t'i komunikojë menjëherë çdo kandidati emrin e tuorit/ udhëheqësin klinik dhe strukturën shëndetësore ku do të duhet të kryejë aktivitetet klinike-praktike si dhe paiset me librezën e praktikës, ku do të dokumentohet praktika nëpër struktura të ndryshme spitalore. Vlerësimi i aftësive kryhet nga të gjithë pedagogët dhe udhëheqësit që kanë mbikëqyrur studentin në periudha kohore të ndryshme , të cilat dokumentohen në librezën personale të praktikës të studentit. Të gjitha vlerësimet në lidhje me çdo mjek përmbledhen në një vlerësim përfundimtar vjetor, i cili ratifikohet nga Këshilli i Programit nëse ky gjykim është pozitiv, atëherë studenti kalon më pas në provimin vjetor përfundimtar. Moskalimi i provimit vjetor nga studenti sjell përsëritjen e vitit aktual. Nëse vazhdon mos të kalojë, mjeku në formim do të përjashtohet nga programi. Gjithashtu, ashtu sic parashikohet edhe në rregulloren e institucionit si dhe në rregulloren e specializimeve, specializantët informohen për rezultatet e vlerësimit kur përfundon provimi dhe komisioni komunikon vlerësimin edhe nëpërmjet portalit ku secili prej specializantëve ka kredencialet e tij. <i>Evidencë 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM, neni 16, neni 17, neni 20, neni 24</i> <i>Evidence 31 - Plani Mesimor.pdf</i> <i>Evidencë 44 - Njoftim për Konkursin e Programeve të Specializimit afatgjatë në fushën e Mjekësisë</i> <i>Evidencë 61 - Procesverbal i Këshillit Drejtues të Programit të Specializimit në Gjinekologji dhe Obstetrikë / Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM</i> <i>Evidencë 72 - Portali i Studentëve Vizita në institucion</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni në mënyrë të vazhdueshme që në fillim të vitit akademik informon studentët për planin mësimor, kohëzgjatjen, semestrat, kreditet si dhe mënyrën e vlerësimit në mënyrë të detajuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Studenti ka të gjitha kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Studenti i pranuar në programin e studimeve specializuese afatgjata ka kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit me karakter akademik e klinik.	GVJ konstatoi se Institucioni plotëson kushtet për realizimin e programit mësimor , bazuar në infrastrukturën e vënë në dispozicion të studentëve, stafi akademik i kualifikuar. I gjithë plani i realizimit të programit mësimor i specializimit fatgjatë në “gjinëkologji dhe Obstetrikë” , mbështet për tu zbatuar në rregullore të institucionit dhe të programit mësimor. Në fund të çdo viti akademik organizohet një provim vlerësues teorik(ku përfshihen të gjitha lëndët) dhe praktik, i cili vlerësohet me notë përfundimtare. Drejtori i programit të specializimit së bashku me Koordinatorin përcaktojnë datën, mënyrat e zhvillimit të provimit dhe materialet që duhet të përgatishë sekretaria. Pas përfundimit të provimit, Komisioni (i përbërë nga të paktën 5 anëtarë) mbledhet për të vendosur për vlerësimin, i cili i komunikohet me gojë dhe me shkrim secilit prej specializantëve e cila afishohet dhe në portalin e studentit . Sipas rregullores së specializimeve afatgjata në “Gjinëkologji dhe Obstetrikë”, specializanti që nuk kalon provimin 5 (pesë) herë radhazi, i ndërpriten studimet dhe marrin vërtetimin e moduleve të përfunduara së bashku me kreditet formuese të fituara .Në rast vlerësimi pozitiv, procesverbalet i dorëzohen sekretarisë të plotësuar dhe firmosura me rezultatet përkatëse. Gjithashtu, udhëheqësit klinikë përpilojnë një raport për veprimtarinë praktike të specializantëve, i cili i bashkëngjitet dosjes së tyre në sekretari. Studenti mund të hyjë në provimin përfundimtar vetëm pas miratimit të dosjes së tij personale nga Këshilli i Specializimit (neni 32) - <i>GVJ konstatoi se mungonte rregjistri model që duhet të vinte nga QSHA edhe pse institucioni kishte bërë kërkesën në QSHA.</i> <i>Evidencë 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM</i> <i>Evidencë 43 - Raportet e specializantëve</i> <i>Evidencë 31 - Plani Mesimor</i> <i>Evidencë 61 - Procesverbal i Këshillit Drejtues të Programit të Specializimit në Gjinëkologji dhe Obstetrikë / Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM</i> <i>Evidencë 72 - Portali i Studentëve</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 2: Programi i studimeve specializuese afatgjata siguron harmonizim të synimeve të studentit në fushën klinike/diagnostike dhe kërkimore-shkencore dhe, në përfundim të tij, edhe të mundësisë për karrierë profesionale ose punësim.	GVJ bazuar në rregulloren e institucionit, strategjinë e institucionit , rrregulloren e specializimit afatgjatë “Gjinëkologji dhe Obstetrikë”, programin mësimor , vrehet se ka objektiva dhe qëllime të qarta mbi gërshetimin e procesit mësimor në auditor dhe në struktura të specializuara spitalore , nisur dhe marrëveshjet e bashkëpunimit ndër institucional, aty ku janë dhe udhëheqësit e tyre klinik të cilët në vazhdim ju japin studentëve autonomi profesionale hapa pas hapi.<i>Evidencë 12 - Rregullore e programit të studimit SPA ne Mjekesi,ne UKZKM,2023.pdf</i> <i>Evidencë 13 - Marreveshje Geraldina.pdf</i>

	<i>Evidence 14 - Marrëveshje midis unizkm dhe Spitalit Rajonal të Durrësit.pdf</i> <i>Evidence 14.1 - Marrëveshje midis unizkm dhe Spitali Amerikan.pdf</i> <i>Evidence 15 - Marreveshje me Spitalin M.G Figlie San Camillo G.Vannini.pdf</i> <i>Evidence 16 - Marreveshje me Eurosanita.pdf</i> <i>Evidence 17- Marreveshje igreco.pdf</i> <i>Evidence 18 - Marreveshje midis ukzkm dhe Spitalit Bianchi Malacrino Morelli.pdf</i> <i>Evidence 19 - Marreveshje me Polikliniken e Barit.pdf</i> <i>Evidence 20 - Marreveshje me Fondazione Leonardo.pdf</i> <i>Evidencë 43 - Raportet e specializantëve</i> <i>Evidence 31 - Plani Mesimor</i> <i>Evidencë 61 - Procesverbal i Këshillit Drejtues të Programit të Specializimit në Gjinekologji dhe Obstetrikë / Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM</i>
Kriteri 3: Studenti që ndjek programet specializuese afatgjata të studimit ka në dispozicion bibliotekë shkencore të pasur me botime në letër dhe në formë elektronike si dhe infrastrukturë të plotë të IT-së.	GVJ gjatë vizitës në institucion , vëzhgimit të bibliotekës konstatohet se , biblioteka ka koleksionin fizik me libra mbi 19,000 tituj, të përditësuar vazhdimisht me botime të reja . Biblioteka funksionon cdo ditë nga ora 8 deri ora 16 edhe të shtunave,. Biblioteka ka libra fizik me shumicë dhe portale on-line falas për studentët të cilët kanë kredencialet e tyre dhe të futen on-line në <u>Biblioteka Online</u>. Zyra e IT ka vënë në dispozicion të të gjithë studentëve 3 stacione PC të dedikuara për përdorim në Bibliotekë me një 200 venede akomodimi në bibliotekë. Institucioni ka rreth 3 salla për përdorim nga studentët (salla IT, Zyra e Studentit, salla PC e Gradua) me kapacitete përkatëse prej 48, 2, 11 PC të pajisura me licenca softueri dhe akses në internet për përdorimin e burimeve online. Studentët e specializimeve Afat gjata “Gjinekologji dhe Obsetrik” kanë akses në disa portale si Jstor, Himnari , përmes “Sign in with Google”, me llogari personale të tij.
Kriteri 4: Studenti ka mbështetje teknike të mjaftueshme për zhvillimin e aktivitetit klinik dhe kërkimor të lidhur me të.	Studentët e specializimeve Afat gjata “Gjinekologji dhe Obsetrik” kanë kabinete të punëve të tyre kërkimore në bashkëpunim edhe me udhëheqësit klinik të punësuar në strukturat universitare brenda dhe jashtë vendit. Punimete tyre publikohen në konferenca të ndryshme si domosdoshmëri për para provimit të diplomimit .Studentët e specializimeve afat gjata “Gjinekologji dhe Obsetrik” duhet të kenë marrë pjesë në në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare jo më pak se 2 aktivitete.
Kriteri 5: Hulumtimet që kanë të përfshira kërkime laboratorike mbështeten me bazë laboratorike të mjaftueshme.	GVJ sic u shprehëm dhe në standartet e mësipërme ka infrastrukturë , me aparatura bashkëkohore në shërbim të studentëve, ku student mund të realizojë kërkime laboratorike shkencore. Kabinete dhe laboratorët ju vihen në dispozicion studentëve të specializimit afat gjata “Gjinekologji dhe Obsetrik” edhe në strukturat spitalore universitare ku specializantët ndjekin ciklin e praktikave mësimore profesionale. Institucioni kishte objektiv hapjen e shërbimit të obsetrik gjinekologjisë në spitalin Zoja E Këshillit të mirë si strukturë mbështetëse për Universitetin e Mjekësisë.

Kriteri 6: Studenti është i siguruar gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe për të gjitha aktivitetet e parashikuara në programin specializues. Për këtë disponohet dokumentacion i mjaftueshëm nga institucioni. Një kopje e policës së sigurimit i dorëzohet studentit në momentin e lidhjes së saj.	GVJ në takim me stafin akademik, koordinatoren u informua se të gjithë studentët e specializimeve afat gjata “Gjinekologji dhe Obsetrik” janë të siguruar dhe një kopje e policës së sigurimit i jepet studentit në momentin e nënshkrimit. Studenti është i siguruar për përgjegjësinë profesionale për dëmet që mund t’u shkaktojë të tretëve, si dhe për dëmet që mund të pësojë, gjatë periudhës së specializimit dhe ushtrimit të specializimit. Polica e sigurimit në favor të studentit përcaktohet dhe paguhet nga Fakulteti kundrejt Kompanisë së Sigurimeve. <i>Evidencë 56 - Policë sigurimi</i> <i>Vizita në institucion</i>			
Kriteri 7: Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar dhe vendet e punësimit.	Në takimin me zyrën e Orientimit të Karrierës, GVJ u informua dhe konstatoi se Institucioni mban një data bazë të dhënash të të diplomuarve në UZKM (megjithëse akoma nuk është diplomuar brezi i parë 2018-2019). Në rregulloren e funksionimit të zyrës së Orientimit të Karrierës të UZKM, ka të dhëna se rreth 96% e të Diplomuarve janë në një marrëdhënie pune ndërsa 4% e të papunëve përbëhen kryesisht nga të sapodiplomuar në mjekësi në pritje për të dhënë provimin, ose nga ata që ndjekin studime të mëtejshme dhe që për momentin preferojnë të përqendrohen në studimet e tyre sesa të hyjnë në botën e punës këto të dhëna përfshijnë të gjitha fakultetet e UZKM, pasi sic u shprehëm më lart akoma nuk janë diplomuar studentët e specializimeve afat gjata “Gjinekologji dhe Obsetrik”.			
Konkluzione	<i>Institucioni siguron, gërsheton studimin teorik dhe klinike dhe rrit mundësinë për karrierë profesionale , falë marrveshjeve të bashkëpunimit, falë infrastrukturës institucionale (laboratore, IT, biblioteka, auditore, staf akademik etj), duke bërë të mundur realizimin e programit të studimit “Gjinekologji dhe Obsetrike”.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.5

Institucioni ndjek procedura të qarta për vlerësimin e njohurive të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Institucioni ndjek procedura të qarta dhe transparente për vlerësimin në vazhdimësi të dijeve të studentit, të përcaktuara dhe të bëra të ditura që në fillim të programit të studimeve në rregulloren e specializimit.	Në rregulloren e studimeve afatgjata në “Gjinekologji dhe Obsetrik” është e shprehur qartë mënyra e vlerësimit të studentëve. Në fund të çdo viti akademik institucioni bën një provim vlerësues teorik dhe praktik, i cili vlerësohet me notë përfundimtare. Drejtori i programit të specializimit së bashku me Koordinatorin e programit përcaktojnë datën, mënyrat e zhvillimit të provimit dhe materialet që duhet të përgatitë sekretaria. Pas përfundimit të provimit, Komisioni (i përbërë nga të paktën 5 anëtarë) mbledhet për të vendosur për vlerësimin, i cili i komunikohet me gojë dhe me shkrim secilit prej specializantëve dhe hidhet dhe në portalin e studentit. Në rast vlerësimi pozitiv, procesverbalet i dorëzohen sekretarisë të plotësuar dhe firmosura me rezultatet përkatëse. Studenti që nuk merr provimin 5 herë radhazi humbet të drejtën e vazhdimin të studimeve dhe merr një vërtetim mbi

	kreditet e marar deri në atë moment. Këtë mënyrë të vlerësimit studentëve ju bëhet më dije që në fillim të vitit akademik. Evidencë 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM Evidencë 43 - Raportet e specializantëve Evidence 31 - Plani Mesimor Evidencë 61 - Procesverbal i Këshillit Drejtues të Programit të Specializimit në Gjinekologji dhe Obstetrikë / Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM Evidencë 72 - Portali i Studentëve Vizita në institucion
Kriteri 2: Institucioni disponon një sistem të informatizuar për kontrollin dhe vlerësimin e njohurive të marra nga studentët gjatë programit të studimit.	UZKM zotëron një sistem të informatizuar për studentët që nga dita e parë e specializimit deri në përfundim të studimeve. Studenti nëpërmjet portalit të studentit shikon të gjithë mbarëvajtjen e tij në vazhdimësi. Studenti sipas rregullores së specializimeve mund të hyjë në provimin përfundimtar vetëm pasi të ketë përmbushur të gjitha detyrimet vjetore të përcaktuara në program dhe pas miratimit të dosjes së tij personale nga Këshilli i Specializimit . UZKM ka në sistemit informatik, i ka një softuer të menaxhimit të universitetit të quajtur UniMS (University Management System), për dixhitalizimin e të gjithë informacionit/të dhënave të prodhuara gjatë proceseve mësimore dhe administrative të punës në UZKM. Baza e të dhënave përfaqëson në mënyrë dixhitale të gjithë informacionin në letër dhe elektronik , kryesisht në gjuhën italiane dhe pak shqip. Gjithashtu , dokumenteve janë të skanuara (hardcopy) në format PDF. UniMS ruan informacionin e kërkuara nga Regjistri Kryesor i Studentëve, në mënyrë të ngjashme me atë në letër, sipas indikacioneve të Ministrisë. GVJ konstatoi se UNIZKM zotëron informacionin kryesisht në gjuhën italiane , për shkak të bashkëpunimit me universitetin Tor Vegata TË Romës dhe me spias nevojës edhe dokumenta shqip (sic vrehen dhe referencat e vëna në dispozicion). <i>GVJ sygjeron: Të gjitha matërialet duhet të jenë edhe shqip ashtu sic janë edhe italisht, pasi jemi në institucion shqipëtar dhe punojmë sipas legjislacionit shqipëtar të arsimit, pavarësisht bashkëpunimit me universitetin e Romës, Itali</i>
Kriteri 3: Konkluzionet e vlerësimit në vazhdimësi, janë të qarta dhe transparente, përfshirë pezullimin, zgjatjen ose përjashtimin nga studimet specializuese.	GVJ gjatë vizitës në institucion , takimin me stafin , koordinatoren e specializimeve, studentët konstatoi se UNIZKM k një infrastrukturë bashkëkohore të vlerësimit sa më transparent të studentëve e cila ndihmon pedagogët në vlerësimin dhe kontrollin e njohurive për provimet me shkrim ose me gojë sic janë: Lexuesi optik e cila mund të korrigjojë 60 pyetje me 5 alternativa ku njëra është e sakta. Pajisja garanton anonimitetin duke përdorur barkodet dhe korrigjimin automatik të fletëve të përgjigjeve Exam Online, Një platformë për dhënien e provimeve me shkrim, me pyetje të shumëfishta ose të hapura, online, duke përdorur mjete kontrolli audio dhe video, në modalitetin “Safe Exam Browser”; Google Meet dhe Microsoft Teams për kryerjen e




	provimeve me gojë, në distancë ose hibride. Sallë telematike e cila lejon lidhjen peer-to-peer me videokonferencat e dedikuara për provimet me gojë me universitetet partnere.			
Kriteri 4: Vlerësimi i studentëve bëhet sipas lëndëve që ka ndjekur specializanti gjatë atij viti akademik.	GVJ gjatë vizitës në sekretari konstatoi se në rregjistrat e vlerësimit janë vetëm nga një provim vjetor, pra në fund të 5 vjeçarit 5 nota dhe jo sipas programit të studimit me lëndë dhe module. Kjo praktik pune kishte vite që aplikohesh sipas një urdhëri të Dekanit prot 6-1/20 datë 20/02/2020, në këtë provim përmbledhet materiali i të gjitha lëndëve/ moduleve sipas viteve akademike. <i>Sygjerohet: Të bëhet vlerësimi i studentëve -specializantë sipas lëndëve/ moduleve, sipas programit të specializimit, sipas emërtesave dhe krediteve përkatëse dhe jo një provim vjetor.</i> Evidencë 12 - Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM, neni 16, neni, 17, neni 20, neni 24 Evidencë 31 - Plani Mesimor.pdf Evidencë 44 - Njoftim për Konkursin e Programeve të Specializimit afatgjatë në fushën e Mjekësisë Evidencë 61 - Procesverbal i Këshillit Drejtues të Programit të Specializimit në Gjinekologji dhe Obstetrikë / Rregullore për studimet e specializimit afatgjatë të ciklit të tretë në Mjekësi, pranë UKZKM Evidencë 72 - Portali i Studentëve			
Konkluzione	<i>Institucioni ndjek procedura të qarta dhe transparente për vlerësimin në vazhdimësi të dijeve të studentit dhe ka bazën materiale- infrastrukturën e duhur për këtë vlerësim, zotëron portalin e studentit, systemin e IT-së si dhe zbaton vlerësimin përfundimtar-vjetor bazuar në programin mesimor të studimit "Gjinekologji dhe Obsetrike" të miratuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË NË PROGRAMIN E SPECIALIZIMIT AFATGJATË

Standardi VI.1

Institucioni dhe njësia përgjegjëse lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të specializimit afatgjatë, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi, dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJmendon se institucioni menaxhon organizon mbarevajtjen e procesit mësimor bazuar në rregullore të ndryshme, ashtu sic është dhe rregullorja e funksionimit të Njësia e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë. Në takim me zyrën e NJSBC GVJ, u informua se NJSBC është krijuar në zbatim të Ligjit 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe në zbatim të nenit 22 të Statutit të Universitetit KZKM. NJSBC është e organizuar në bazë të Universiteti dhe jo në bazë të njësive kryesore (fakulteteve). Njësia përbëhet nga 5 anëtarë nga të cilët 3 anëtarë janë staf akademik me kohë të plotë për çdo njësi kryesore, 1 anëtar i jashtëm ekspert në fushën e sigurimit të cilësisë, i cili emërohet nga Rektori si dhe një anëtar student i zgjedhur nga këshilli studentor. Për të kryer funksionet e saj dhe për të garantuar standardet e duhura të cilësisë për performancë më të mirë të veprimtarive të Universitetit, Njësia nëpërmjet Zyrës së Statistikave mbikëqyr hartimin dhe shpërndarjen e pyetësorëve të ndryshëm për studentët dhe stafin akademik në lidhje me programet e studimit dhe funksionimin institucional. Evidencë 74 - Emërimi i Njësise së Vlerësimit të Cilësisë Evidencë 75 - Modeli i pyetësorit Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njësise Vizita në institucion
Kriteri 2: Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	NJSBC vlerëson në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike funksionalitetin, efikasitetin dhe produktivitetin e stafit të UZKM në lidhje me veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore nëpërmjet pyetësorëve anonim një herë në vit që ju bëhen studentëve mbi aktivitetin mësimor, aktivitetin shkencor, infrastrukturën e institucionit, komunikimin me sekretarinë, administratën etj. NJSBC ka të drejtë të ketë akses dhe të kontrollojë në të gjitha materialet dhe të dhënat e institucionit në bazë të plani strategjik të zhvillimit të UZKM. UZKM ka në përdorim kabinete me infrastrukturë bashkëkohore për një mësimdhënie sa më të mirë. Cdo sallë lexioni ka infrastrukturë shumë të mire për mësimdhënie si video projektor, systemin grohjes dhe ftohjes së ambienteve në UZKM. UZKM në mënyrë të vazhdueshme ka ftuar e fton lektorë e Profesorë me përvojë akademike, profesionale të fushës së Gjinekologji dhe Obsetrikës si nga klinikat universitare të vendit tonë, por edhe nga universitete të huaja sidomos nga Italia falë bashkëpunimit institucional që ka UZKM. Evidencë 13 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Qendrës Universitare Obstetrike Gjinekologjike “Koço Gliozheni” Tiranë Evidencë 14 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Spitalit Rajonal Durrës

	Evidencë 14.1 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe "American Hospital" Sh.a Tiranë Evidencë 15 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Spitalit M.G Figlie di San Camillo G. Vannini Romë Evidencë 16 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Eurosanità S.p.a Policlinico Casilino Romë Evidencë 17 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe IGreco Ospedale Riuniti Evidencë 18 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Spitalit të Madh "Bianchi Malacrino Morelli" Evidencë 19 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Poliklinikës së Barit Evidencë 20 - Marrëveshje ndërmjet UKZKM dhe Fondacionit Leonardo Vizita në Institucion
Kriteri 3: Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	GVJ sic është shprehur edhe në kriteret e mësipërme ,si dhe në takimin e realizuar me studentët konfirmoi se UZKM garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies si: teste të standardizuara (pyetësor anonim një here në vit), dëgjime në auditor; vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës klinike në institucione të tjera spitalore , kryesisht nga mjekët mbikqyrës -tutorët. NJSBC përdor pyetësorë anonimë duke u përpjekur të formulojë pyetje të qarta dhe të thjeshta duke përdorur shkallën Likert (shkalla e gjykimit/ vlerësimit nga një në shtatë), duke u përpjekur të mbulojë fusha të ndryshme që ndikojnë në jetën mësimore të studentit brenda universitetit. Studentët referojnë se gjatë vititeve akademike, ata në formë elektronike plotësojnë një pyetësor anonim një herë në vit para provimeve. Pyetësori ka disa rubrika të cilat lidhen kryesisht me, programin e lëndës, syllabuset, mësimdhënia, performance e stafit akademik, ndihmës akademik, infrastrukturën etj. Studentët shprehin pa ndikim apo presion mendimin e tyre të lirë mbi rubrikat që ka pyetësori. Studentët janë pjesë e vlerësimit periodik institucional, jo vetëm me anë të pyetësorëve anonim on-line , por edhe me anë të takimeve formale dhe informale me studentët me koordinatorin e specializimeve, takimit me përfaqësues të stafit akademik dhe administrativ. Po ashtu një studentë është pjesë e GVB, për mbledhjen e informacionit dhe përgatitjen e RVB-së. Pas mbledhjes së informacioneve përkatëse të këtyre vlerësimeve, NJSBC bën një raport që ja prezanton drejtuesit të institucionit , për problematikat e dala , dhe për ti zgjidhur ato. GVJ gjatë guidës në institucion dhe referencave të vëna në dispozicion, nuk konstatoi ndonjë rast konkret problematike, që mund të kishte dalë nga ky vlerësim periodik institucional me anë të studentëve. Evidencë 74 - Emërimi i Njesisë së Vlerësimit të Cilësisë Evidencë 75 - Modeli i pyetësorit Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njesisë Evidencë 77 - Perceptimi i specializantëve Vizita në institucion
Kriteri 4: Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për	GVJ gjatë takimit me drejtues të institucionit, Zyrën e NJSBC, studentët u informua se me anë të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Njesisë së vlerësimit të brendshëm të institucionit bëhet e mundur kontrolli

sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	periodik i sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programit të studimit që ofron në specializimet afat gjata "Gjinekologji dhe Obsetrik". Qëllimi i këtij kontrolli periodik është të identifikojë pikat e forta dhe të dobëta sipas perceptimit të studentëve dhe të ndërhyjë, ku është e mundur, për të përmirësuar punën e kryer ose për të korrigjuar pikat e dobëta, duke krijuar kështu një filozofi pune që është e domosdoshme ndaj nevojave të studentëve, në këtë mënyrë institucioni, nëpërmjet NJSBC, synon të krijojë një kulturë të cilësisë në nivel institucional, të njësive përbërëse dhe të të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit. Evidencë 74 - Emërimi i Njesisë së Vlerësimit të Cilësisë Evidencë 75 - Modeli i pyetësorit Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njesisë Evidencë 77 - Perceptimi i specializantëve Vizita në institucion			
Konkluzione	<i>Institucioni ka një Rregullore të funksionimit të NJSBC, ka njësinë përkatëse institucionale të përbërë nga 5 anëtar, ka bazën materiale të funksionimit të NJSBC (pyetësor) zbaton politika e procedura transparente për sigurimin e cilësisë së programit të specializimit afatgjatë, "Gjinekologji dhe Obsetrik"</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2 Institucioni dhe njësia përgjegjëse monitoron dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të specializimit.	GVJ gjatë vizitës në institucion, takimit me stafin, studentët, NJSBC si dhe grupin e RVB, konstaton nga dokumentat e vëna në dispozicion dhe takimi me përfaqësues të tij se pranë UZKM-së është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorët institucionalë për matjen e performancës. GVJ sic është shprehur edhe në kriteret e mësipërme konstaton se UZKM, ka zhvilluar auditim të brendshëm periodik të institucionit me anë të pyetësorëve anketues me studentë me qëllim përmirësimin e procesit të vlerësimit të studentëve në programe specifike. Metodën e përdorur përfshijnë: Sondazhe të fokus grupeve të studentëve që ndjekin programin e studimit të programit të specializimit afatgjatë, "Gjinekologji dhe Obsetrik"; vlerësimi me anë të pyetësorëve anonym të didaktikës mesimdhënëse, kurrikulës. Kjo Zyrë përdor pyetësorë anonimë duke u përpjekur të formulojë pyetje të qarta dhe të thjeshta duke përdorur shkallën <i>Likert</i> (vlerësimi nga një në shtatë), duke u përpjekur të mbulojë fusha të ndryshme që ndikojnë në jetën mesimore të studentit brenda universitetit Provime me pyetje konceptuale dhe alternativa; Vlerësimi me pikë me anë testeve të ndryshme; vlerësimi i praktikës klinike në mënyrë periodike sipas rotacionit nëpër klinika universitare, vlerësimi i punëve individuale dhe punëve

	kërkimore,projekteve që kryhen nga studentët dhe në fund të vitit provimi përfundimtar. Të gjitha këto metoda të vlerësimit sondazhe e intervista të studentëve bazohen në rregullore të brendëshme institucionale dhe syllabuset e lëndëve përkatëse të programit të studimit së programit të studimit programit të specializimit afatgjatë, "Gjinekologji dhe Obsetrik". Metoda të vlerësimit për stafin akademik janë zhvilluar kontrolle të ndryshme në mënyrë periodike dhe sistematike nga eprori përgjegjësi nënjësisë bazë, dekani, koordinatori i specializimit. GVJ gja të vizitës në institucion konstatoi se Njësia përgjegjëse për monitorimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit është NVIQ. Kjo njësi, siç e kemi përmendur edhe më lart, mund të përfitojë nga bashkëpunimi i çdo strukture organizative, administrative, mësimore dhe kërkimore të Universitetit, që konsiderohet e nevojshme për qëllimet e realizimit të veprimtarisë së tij. Zyrat që ofrojnë më shumë mbështetje për Njësinë janë Zyra e Vlerësimit të Cilësisë dhe Kurrikulës, Zyra e Statistikave ,IT dhe Zyra e Orientimit të studimeve dhe punës, Zyra e Projekteve të Kërkimit dhe formimit etj. Në veçanti, Zyra e Statistikave e cila merret dhe është përgjegjëse për mbledhjen, menaxhimin e ruajtjes së të dhënave, përpunimin e perceptimit të studentëve për lëndët që u zhvillohen atyre. Evidencë 74 - Emërimi i Njesisë së Vlerësimit të Cilësisë Evidencë 75 - Modeli i pyetësorit Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njesisë Evidencë 77 - Perceptimi i specializantëve Vizita në institucion
Kriteri 2: Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të specializimit.	Në takimin me përfaqësues të insitucionit dhe dokumentat e vëna në dispozicion GVJ mendon se NJSBC përgatit dhe shpërndan një analizë të vlerësimeve periodike institucionale përmes anketimeve me pyetësorë dhe fokus grupe, i cili u vihet në dispozicion Dekanit Rektorit si raport vjetor. Në përpilimin e këtij raporti vjetor cdo strukturat drejtuese institucionale shpreh dhe raporton mbi aktivitetin e tij, në nivel departamenti, në nivel fakulteti dhe në nivel rektorati dhe më pas paraqitet në senat. Raportet e vlerësimit të NJSBC përfshijnë rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim shkencor për stafin akademik dhe studentët. Studentët shprehin mendimin e tyre në sondazhe, intervista të dryshme të realizuara nga Zyra e Karrierës dhe Alumni, apo nga e punëdhënësve të ndryshëm. Instrumentet kryesor që përdoren për përfshirjen e studentëve janë edhe zhvillimi i pyetësorëve online, fokus grupet, mbledhjet e hapura të departamenteve Evidencë 74 - Emërimi i Njesisë së Vlerësimit të Cilësisë Evidencë 75 - Modeli i pyetësorit Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njesisë Evidencë 77 - Perceptimi i specializantëve Vizita në institucion
Kriteri 3: Institucioni ka përcaktuar indikatorë dhe	GVJ në takimin me drejtues të UZKM-së dhe referencat e vëna në dispozicion, mendon se UZKM përgatit në mënyrë periodike analizat

tregues cilësorë të matshëm sasiore për programin e specializimit në kudër të vlerësimit të cilësisë së programit.	vjetore në bazë institucionale, në çdo njësi bazë. Aty përshkruhet pjesa më e madhe e informacionit mbi ngarkesën mësimore, aktivitetin shkencor, cilësinë e leksioneve të miratuara më parë në departament, të dhënat e dala nga monitorimi i vazhdueshëm i stafit. Ky raport më pas u dërgohet dhe vihet në dispozicion edhe stafit akademik dhe administratës. Gjatë vlerësimit GVJ konstaton se në zbatim të akteve rregullatore, UZKM përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve, të cilat kontrollohen nga NJSBC dhe që janë të përshkruara dhe në syllabuset e lëndëve përkatëse, të cilat janë miratuar paraprakisht nga institucioni. NJSBC mbikqyr hartimin e programeve dhe planeve mësimore të disiplinave mësimore si edhe harmonizimin e tyre. Këto institucione përdorin disa metoda për realizimin e vlerësimit, si: pyetësorë anonim me studentët, inspektime gjatë zhvillimit të mësimit, leksione të hapura e dëgjime në auditor, intervista, vlerësim të detyrave dhe të provimeve të studentëve, vëzhgime gjatë kqyrjes së praktikës klinike , kontroll i vazhdueshëm për cdo rubrik të planit mësimor. Evidencë 31 - Plani Mësimor i Programit të Specializimit “Gjinekologji dhe Obstetrikë” Evidencë 74 - Emërimi i Njesisë së Vlerësimit të Cilësisë Evidencë 75 - Modeli i pyetësorit Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njesisë Evidencë 77 - Perceptimi i specializantëve Vizita në institucion
Kriteri 4: Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	GVJ, bazuar në referencat e dorëzuara, takimin me drejtuesit e institucionit u informuam se grupi ynë (GVJ) i akreditimit për programin e studimit të Specializimit afatgjat “Gjinekologji dhe Obstetrikë” është për vlerësim të jashtëm të cilësisë për herë të parë. GVJ bazuar në, guidën në institucion dokumentat e vëna në dispozicion konstaton se, institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. NJSBC ka rolin kryesor në monitorimin e cilësisë. NJSBC monitoron procesin e vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike periodike, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. GVJ është shprehur dhe më lart se institucioni një herë në vit aplikon pyetësorët anonym për mbarëvajtjen e të gjithë veprimtarisë institucionale në këndvështrimin studentor me anë të pyetësorë anonimë duke përdorur shkallën Likert të vlerësimit. Pyetësorët janë të përpiluar saktë, thjesht, me pyetje: strukturore për të kuptuar disa mendime të studentëve specializant të studimeve afatgjat “Gjinekologji dhe Obstetrikë”; që lidhen me aspekte didaktike-administrative në nivel Programi Studimi; që lidhen me aspekte didaktike - administrative në nivel lënde/ moduli. Evidencë 31 - Plani Mësimor i Programit të Specializimit “Gjinekologji dhe Obstetrikë” Evidencë 74 - Emërimi i Njesisë së Vlerësimit të Cilësisë Evidencë 75 - Modeli i pyetësorit Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njesisë

	Evidencë 77 - Perceptimi i specialistëve Vizita në institucion			
Kriteri 5: Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ gjatë guidës në institucion dhe takimin me drejtues të institucionit konstatohet se institucioni për sigurimin e cilësisë përdor: pyetësorët anonim tek studentët për aspekte të ndryshme të veprimtarisë mësimore e asaj administrative, sipas Ligjit 80/2015 të IALP; takime formale dhe informale me studentët dhe koordinatorin e programit të studimit; takimeve me stafin akademik dhe administrativ nëpërmjet e-maili ose takime të drejtpërdrejta. NJSBC institucionale pas mbledhjes së të gjitha informacioneve nga metodat e përdorura, sic referuam më lartë bën në aspektin taktik, raportime periodike vjetore tek drejtuesi i institucionit. Raportet periodike përcillen te Dekani dhe më te rektori. Në analizat periodike nuk është konstatuar ndonjë mangësi apo problematik. Evidencë 74 - Emërimi i Njesisë së Vlerësimit të Cilësisë Evidencë 75 - Modeli i pyetësorit Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njesisë Evidencë 77 - Perceptimi i specialistëve Vizita në institucion			
Kriteri 6: Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	GVJ u informua nga koordinatori i programit të studimit, nga drejtuesit e institucionit se sic u shprehëm dhe më lartë, të dhënat e këtij monitorimi të mbledhura nga NJSBC diskutohen në njësitë bazë, dekanat, rektorat, senat dhe shohin mundësitë për përmirësimin e problematikave (nuk ka patur ndonjë rast konkret problematik). UZKM i është nënshtruar në mënyrë periodike vlerësimeve të jashtme (por jo specializimeve afatgjatë), dhe në vlerësimin përfundimtar ka qënë pozitiv dhe me një kohëzgjatje shumë vjecare, sikurse edhe për programet të tjera të studimeve që ofron UZKM, të cilat i nënshtrohen në mënyrë periodike procesit të akreditimit sipas Ligji i IAL-së. GVJ konstatoi se një figurë e rëndësishme në këtë proces akreditimi si pjesë edhe GVB është dhe roli i Koordinatorit të Programit të Specializimit, i cili ndjek ecurinë e specialistëve dhe i ndihmon ata në adresimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problemeve që lidhen me procesin mësimor. Evidencë 74 - Emërimi i Njesisë së Vlerësimit të Cilësisë Evidencë 75 - Modeli i pyetësorit Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njesisë Evidencë 77 - Perceptimi i specialistëve Vizita në institucion			
Konkluzione	UZKM ka njësi përgjegjëse (NJSBC) e cila në bashkëpunim dhe me zyra të tjera institucionale, bazuar dhe në rregulloren përkatëse, monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar realizimin e objektivave formuese sipas rubrikave të planit mësimor të Specializimit afat gjatë në "Gjinekologji dhe Obstetrikë"			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni dhe njësia përgjegjëse përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Vlerësimi i brendshëm i programit të specializimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit, apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	GVJ sic është shprehur edhe më lartë thekson se Institucioni UZKM i është nën shtruar në mënyrë periodike vlerësimeve të jashtme (por jo specializimeve afatgjat, është hera e parë e vlerësimit të jashtëm të këtij programi), dhe në vlerësimin përfundimtar ka qënë pozitiv dhe me një kohëzgjatje shumë vjecare, sikurse edhe për programet të tjera të studimeve që ofron UZKM, të cilat i nënshtrohen në mënyrë periodike procesit të akreditimit sipas Ligji i IAL-së. Vlerësimi i brendshëm i programit të specializimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi, duke qënë hera e parë e vlerësimit të jashtëm, GVJ mendon se këto vlerësime janë periodike bazuar dhe në RVB, referencat e vëna në dispozicion, informacioni i marrë nga takimet me drejtuesit e institucionit. GVJ konstatoi se një figurë e rëndësishme në këtë proces akreditimi si pjesë edhe GVB është dhe roli i Koordinatorit të Programit të Specializimit, i cili ndjek ecurinë e specializantëve dhe i ndihmon ata në adresimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problemeve që lidhen me procesin mësimor. Evidencë 74 - Emërimi i Njesisë së Vlerësimit të Cilësisë Evidencë 75 - Modeli i pyetësorit Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njesisë Evidencë 77 - Perceptimi i specializantëve Vizita në institucion
Kriteri 2: Për kryerjen e vlerësimit, Institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën që ka programi i specializimit.	Siç e kemi theksuar edhe më lart, edhe në takimin me specializantët GVJ u informua se çdo vit specializantët plotësojnë elektronikisht pyetësorët të tipit Likert (shkalat e vlerësimit nga 1-7 pikë) përmes të cilëve shprehin vlerësimin e tyre për stafin akademik, infrastrukturën, programin, sekretarinë etj. Në takim me koordinatorin, zyrën e NJSBC dhe zyrën e IT që bënë përpunimn statistikor të këtij vlerësimi periodik u informuam se në nivel të çdo programi specializimi, pjesëmarrja e studentëve në pyetësor ishte e lartë, morën pjesë 72% e të regjistruarve me një total prej 69 pyetësorësh të mbledhur dhe më konkretisht për programin e Specializimit të <i>Gjinekologji dhe Obstetrikë</i> , morën pjesë 86% e të regjistruarve duke dhënë vlerësimin 6.8 nga 7. Për qëllime të kryerjes së aktiviteteve të saj, Njësia përdor mjete të ndryshme (jo vetëm indirekte) për të mbledhur informacion. Organizon takime ose kërkesa për informacion (të shpërndara me email). Një mënyrë tjetër për të marrë komente nga specializantët është nëpërmjet takimeve që studentët bëjnë me Koordinatorin e Programit si figurë kyce të bashkëpunimit student -institucion. Evidencë 75 - Modeli i pyetësorit Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njesisë Evidencë 77 - Perceptimi i specializantëve

	Vizita në institucion
Kriteri 3: Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë.	GVJ konstatoi se UZKM në mënyrë periodike bën vlerësime të brendshme të institucionit për programe të ndryshme që ky Universitet ofron , por vlerësim i jashtëm për programet e specializimeve afatgjata është hera e parë. GVJ sic është shprehur edhe në standartet e mësipërme ka disa metoda të vlerësimit të brendshëm si : pyetësorët anonim të tipit Likert me shkallë vlerësimi nga 1-7 pikë, institucioni organizon takime ose kërkesa për informacion me anë të e-mail. Në takim me koordinatoren dhe studentët, GVJu informua se një mënyrë tjetër për të marrë komente nga specialistët është nëpërmjet takimeve të vazhdueshme që studentët bëjnë me Koordinatorin e Programit. Bazuar në RVB dhe referencat e vëna në dispozicion u konstatua se nga perceptimi i specialistëve për vitin 2022-2023, rezultatet janë mesatarisht të larta, 6.8 nga 7, duke i bërë pedagogët dhe institucionin të perceptojnë një nivel kënaqësie të mirë. Evidencë 75 - Modeli i pyetësorit Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njesisë Evidencë 77 - Perceptimi i specialistëve Vizita në institucion
Kriteri 4: Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit përdor metoda të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar, të personelit akademik, udhëheqësve dhe partnerëve.	GVJ sic është shprehur edhe në standartet e mësipërme ka disa metoda të vlerësimit të brendshëm si: pyetësorët anonim të tipit Likert me shkallë vlerësimi nga 1-7 pikë, institucioni organizon takime ose kërkesa për informacion me anë të e-mail . Udhëheqësit klinik bëjnë vlerësim në vazhdimësi të studentëve lidhur me praktikën klinike, aktivizimin, etikën e komunikimit, performancën, të cilat pasqyrohen në librezën e praktikës për çdo student dhe për çdo strukturë spitalore ku studentët shkojnë për praktikat profesionale. Në takim me koordinatoren dhe studentët, GVJ u informua se një mënyrë tjetër për të marrë komente nga specialistët është nëpërmjet takimeve të vazhdueshme që studentët bëjnë me Koordinatorin e Programit . Evidencë 50 - Procesverbal i mbledhjes për emërimin e udhëheqësve dhe pedagogëve Evidencë 53 - Libreza e Studentit – Template Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njesisë Evidencë 77 - Perceptimi i specialistëve Vizita në institucion
Kriteri 5: Mekanizmat e vlerësimit në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të programit, përfshijnë palët e interesuara, institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	GVJ në takim me koordinatoren dhe studentët, u informua se një mënyrë tjetër për të marrë komente nga specialistët është nëpërmjet takimeve të vazhdueshme që studentët bëjnë me Koordinatorin e Programit. GVJ gjatë vizitës në institucion u informua se në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin dhe mbarëvajtjen e programit bashkëpunojnë të gjitha palët e interesuara si: studentët, stafi akademik, udhëheqës klinik, institucioni, zyra e karrierës, zyra e IT, NJSBC, sekretaria etj. Evidencë 50 - Procesverbal i mbledhjes për emërimin e udhëheqësve dhe pedagogëve Evidencë 53 - Libreza e Studentit – Template Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njesisë Evidencë 77 - Perceptimi i specialistëve

	Vizita në institucion			
Konkluzione	UZKM ka jo vetëm strukturat përkatëse, (NJSBC) që ndjek ecurinë, mbarëvajtjen e programit ,por përdor dhe metodat e duhura për këtë vlerësim duke përfshirë të gjitha palët e interesuara, në bashkëpunim dhe me zyra të tjera institucionale .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e mara në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit.	GVJ gjatë takimeve të realizuara në institucion u vu në dijeni të vlerësimeve periodike të programit të studimeve afatgjata "Gjinekologji dhe Obsetrik". Bazuar në Statutin e UZKM, Rektori emëron anëtarët e Njësisë së Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë i përbërë nga 5 anëtar, si struktura qendrore që menaxhon mbarëvajtjen e këtij programi në bashkëpunim dhe palët e tjera të interesit. Njësia verifikon ecurinë e menaxhimit të Universitetit dhe të aktiviteteve e tij për të arritur objektivat, duke ofruar bashkëpunim dhe mbështetje për të gjitha organet e Universitetit për të përmirësuar dhe promovuar cilësinë e vetë këtij të fundit. Cdo vit përpilohet raporti vjetor ku dlin në pah pikat e forta, të dobëta si dhe mangësitë për tu zgjidhur. Evidencë 21 - Statuti i Universitetit Evidencë 22 - Rregullore e Fakultetit të Mjekësisë Evidencë 53 - Libreza e Studentit – Template Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njësisë Evidencë 77 - Perceptimi i specializantëve Vizita në institucion
Kriteri 2: Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit, dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në raportin vjetor , i cili përcillet në dekanat, Rektorit dhe Senatit të UZKM përshkruhet e gjithë puna e bërë nga NSBC në bashkëpunim dhe me zyrat e tjera dhe raportohet me hollësim si është mbikëqyrë hartimi dhe shpërndarja e pyetësorëve Likert për studentët dhe stafin akademik në lidhje me programet e studimit dhe funksionimin institucional, si ka funksionuar mësimdhënia, kërkimi shkencor dhe si mund të përmirësohet duke rekomanduar zgjidhjen e problematikave zyrove përkatëse. Në komunikim me drejtues të UZKM dhe koordinatoren e specializimeve nuk është konstatuar ndonjë problematikë në raportet e vjetore të paraqitura nga NJSBC. Evidencë 21 - Statuti i Universitetit Evidencë 22 - Rregullore e Fakultetit të Mjekësisë Evidencë 53 - Libreza e Studentit – Template Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njësisë Evidencë 77 - Perceptimi i specializantëve Vizita në institucion

Kriteri 3: Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës-akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Bazuar në rregullore të institucionit, rregullore të senatit akademik, Rregulloren e NJSBC është e përshkruar qartë detyrat e cdo pjesmarrësi dhe të cdo zyre që merrret me vlerësimin e dhe cilësinë e programit të studimit afatgjat "Gjinekologji dhe Obsetrik", pra e të gjithë palëve pjesmarrëse në këtë program NJSBC e ka për detyrë dhe zbaton në mënyrë rigoroze realizimin e pyetësorëve të ndryshëm me studentët, stafin akademik etj .Po ashtu NJSBC mund të thërrasë në një seancë dëgjimore Përgjegjësit e njësive të ndryshme organizative të universitetit, të cilëve u kërkohet të japin informacion dhe mund të kërkojë mbledhjen e përhershme të të dhënave të veçanta që konsiderohen të nevojshme për përgatitjen e raportit vjetor që dorëzohet te Rektori. Evidencë 21 - Statuti i Universitetit Evidencë 22 - Rregullore e Fakultetit të Mjekësisë Evidencë 53 - Libreza e Studentit – Template Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njësive Evidencë 77 - Perceptimi i specializantëve Vizita në institucion
Kriteri 4: Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi se, përfshirja dhe aktivizimi i grupeve të interesit në proceset e vazhdueshme të vlerësimit respekton integritetin akademik dhe shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve duke ruajtur dhe anonimin në pyetësorët e ndryshëm të vlerësimit. Sikurse është përmendur edhe më lart, Njësia e Vlerësimit të Brendshëm të UKZKM bashkëpunon me të gjitha strukturat për të mbledhur informacionin që i nevojitet, duke filluar me njësinë bazë që është përgjegjëse për këtë program studimi dhe me të gjitha zyrat mbështetëse. Mbledhja dhe analizimi i informacioneve kryhet në një mënyrë shumë profesionale, duke respektuar integritetin akademik të personelit dhe anonimin e tyre. Evidencë 21 - Statuti i Universitetit Evidencë 22 - Rregullore e Fakultetit të Mjekësisë Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njësive Evidencë 77 - Perceptimi i specializantëve
Kriteri 5: Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, mund të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	GVJ sic përshkroi dhe në kriteret e mësipërme konstatoi se, gjatë vlerësimit të cilësisë së programit të studimit, institucioni gjithashtu përdor, përveç stafit akademik të brendshëm, studentëve por edhe bashkëpunëtorë të jashtëm, në mënyrë që të sigurohet një përmirësim i vazhdueshëm i nivelit të cilësisë së vetë Programit të Studimit afatgjatë në "Gjinekologji dhe Obsetrikë". Institucioni organizon procedura për krahasimin dhe përfshirjen midis aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të Universitetit GVJ konstaton se në Rregulloren e funksionimit të NJSBC-së se kjo strukturë përbëhet nga 5 anëtar ku njëri prej tyre është ekspert i jashtëm. Ekspertët e jashtëm të cilët përfshihen në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit, kanë lidhje me programin e studimit dhe mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. Në përfundim, të gjithë aktorët e Programit të Studimit afatgjatë në "Gjinekologji dhe Obsetrikë", personeli teknik administrative dhe pedagogët, janë të

	përfshirë dhe përgjegjës në proceset e ndryshme të menaxhimit dhe zhvillimit të programit të studimit nëpërmjet konsultimeve, takimeve periodike në të cilat shtrihen problemet e ndryshme që shfaqen here pas here gjatë procesit mësimor dhe përcaktohen zgjidhjet për të siguruar nivelin e lartë të cilësisë së programit të studimit. Evidencë 21 - Statuti i Universitetit Evidencë 22 - Rregullore e Fakultetit të Mjekësisë Evidencë 74 - Emërimi i Njesisë së Vlerësimit të Cilësisë Evidencë 75 - Modeli i pyetësorit Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njesisë Evidencë 77 - Perceptimi i specialistëve			
Kriteri 6: Monitorimi i ecurisë akademike e programit dhe sigurimi i cilësisë, është pjesë e veprimtarisë së njesisë përgjegjëse që ofron programin dhe NJSBC.	GVJ sic është shprehur dhe më lart thekson se NJSBC bazuar në rregulloren e funksionimit të saj ka për detyrë mbarëvajtjen ecurisë akademike të programit të studimit aftëgjatë në “Gjinekologji dhe Obstetrikë”. NJSBC krahas aplikimit të pyetësorëve anonim të studentët, stafi akademik, mund të thërrasë në një seancë dëgjimore përgjegjësit dhe koordinatorët e njësive të ndryshme organizative të universitetit, të cilëve u kërkohet të japin informacion për mbarëvajtjen e procesit mësimor apo problematikave që mund të kenë hasur. Si përfundim, të gjithë aktorët e programit të Specializimit të Gjinekologji dhe Obstetrikë, studentët, stafi tekniko- administrativ dhe pedagogët janë të përfshirë në proceset e ndryshme të menaxhimit dhe zhvillimit të programit të studimit nëpërmjet konsultimeve dhe takimeve periodike në të cilat trajtohen problemet e ndryshme që dalin herë pas here gjatë procesit mësimor dhe që identifikojnë zgjidhjet për të siguruar nivelin e lartë të cilësisë së programit të studimit. Evidencë 21 - Statuti i Universitetit Evidencë 74 - Emërimi i Njesisë së Vlerësimit të Cilësisë Evidencë 75 - Modeli i pyetësorit Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njesisë Evidencë 77 - Perceptimi i specialistëve			
Konkluzione	<i>UZKM ka strukturën e NJSBC e cila mbikqyr mbarëvajtjen e procesit mësimor duke përfshirë në vlerësim anonim stafin akademik, studentët e programit të specializimit aftëgjatë në “Gjinekologji dhe Obstetrikë”, krijon raportin vjetor dhe informon palët e interesuara, Rektorin në lidhje me rezultatet dhe masat e mara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1: Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ në fokus të politikave ,procesit dhe veprimtarive për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë konstatoi se Njësia e Vlerësimit të Brendshëm të UKZKM, në përputhje me rregulloret dhe ligjin mbi privatësinë dhe etikën akademike, publikon raportet e veta dhe shpërndan informacionet. Kjo vlen si për pedagogët dhe administratën, ashtu edhe për studentët. Njësia e Vlerësimit të Brendshëm të UKZKM përfundon raportin e vet duke treguar rekomandime të shoqëruara me një analizë përmbledhëse SWOT. Këto rekomandime janë shumë të rëndësishme për autoritetet vendimmarrëse të Universitetit, në mënyrë që ato të arrijnë të marrin vendimet e nevojshme në kohë reale. Njësia e Vlerësimit të Brendshëm të UKZKM e vë raportin e vet vjetor në dispozicion të Rektorit dhe Senatit dy organe të rëndësishme vendimmarrëse të Universitetit. Evidencë 7 - Emërimi i Komisionit për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë Nr. 290 Prot datë 12/08/2024 Evidencë 21 - Statuti i Universitetit Evidencë 74 - Emërimi i Njesisë së Vlerësimit të Cilësisë Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njesisë Evidencë 77 - Perceptimi i specializantëve
Kriteri 2: Institucioni dhe njësia përgjegjëse publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ, konstatoi sic e kemi përmendur dhe në standartet e mësipërme se, UZKM ka transparencë në publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Evidencë 21 - Statuti i Universitetit Evidencë 74 - Emërimi i Njesisë së Vlerësimit të Cilësisë Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njesisë Evidencë 77 - Perceptimi i specializantëve Vizita në institucion
Kriteri 3: Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ konstatoi bazuar në RVB, në takimet me grupet e interes se cdo raport mbi Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë shërben dhe shoqërohet me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive apo dobësive të evidentuara në këtë program studimi. Në raportet vjetore të realizuara nga UZKM nuk është konstatuar ndonjë mangësi që ka nevojë për zgjidhje të saj). Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njesisë Evidencë 77 - Perceptimi i specializantëve Vizita në institucion
Kriteri 4: Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Po kështu GVJ vuri re se institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive të realizuara nga njësia bazë, koordinatori gjatë procesit të vlerësimit të cilësisë, e cila ndikon në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit të specializimit afatgjatë në “Gjinekologji dhe Obstetrikë”. Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njesisë Evidencë 77 - Perceptimi i specializantëve Vizita në institucion
Kriteri 5: Institucioni dhe njësia përgjegjëse organizon veprimtari periodike me personelin akademik	Gjatë takimit me stafin akademik, koordinatori e studimeve të specializimeve afat gjata në UZKM, studentët, GVJ konstatoi se institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin

përgjegjëse dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit.	afatgjatë të cilësisë së programit të studimit jo vetëm të programit të studimit të specializimit afatgjatë në “Gjinekologji dhe Obstetrikë”, por për të gjitha programet e studimit që mbulon UZKM. Evidencë 76 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njesisë Evidencë 77 - Perceptimi i specializantëve Vizita në institucion			
Konkluzione	<i>UZKM, me anë të rregulloreve të të ndryshme institucionale ka politikat, e nevojshme për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë , duke i bërë transparente dhe efektive, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit të studimit të specializimit afatgjatë në “Gjinekologji dhe Obstetrikë”.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të tretë Studime Specializuese Afatgjata në "Gjinekologji dhe Obstetrikë" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti Katolik Zoja e Këshillit të Mirë"

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Diplomë me standarte të BE pasi programi i Specializimit afatgjatë në "Gjinekologji dhe Obstetrikë" zhvillohet në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata", Itali.
2. Marrëveshjet e bashkëpunimit me klinika universitare kombëtare dhe ndërkombëtare, pasi studentët specializantë kanë mundësinë të kryejnë periodikisht veprimtari praktike në Universitetin e Romës "Tor Vergata" dhe në strukturat e lidhura me marrëveshje.
3. Diplomë e cila mund të ushtrohet si profesion jo vetëm brenda vendit, por edhe në vendet të BE-së, universiteti ka një strategji të ndërkombëtarizimit të profesioneve.
4. Ofrimi i mësimit në gjuhën italiane mundëson përhapjen e kulturës europiane në vendin tonë dhe transmetimin e vlerave tona kulturore në skenën ndërkombëtare.
5. Staf i akademik është i përbërë nga profesionistë të kualifikuar, me diploma dhe certifikata të njohura ndërkombëtarisht, me përvojë të gjerë në fushën e gjinekologjisë dhe obstetrikës.

Pika të dobta:

1. Mungesa e mjediseve të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e formimit profesional për studentët e Specializimit afatgjatë në "Gjinekologji dhe Obstetrikë" brenda institucionit, pavarësisht se ka vënë në funksionim Spitalin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", duke filluar nga viti 2022.

Rekomandime:

1. Sugjerojmë që të përshtatet plani mesimor sipas kriterit të përcaktuar për raportin e lëndëve formuese.
2. Sugjerojmë që për studentët e huaj, përveç dokumentacionit të plotë i cili ishte dorëzuar korrekt sipas legjislacionit shqiptar të ekuivalentimit të diplomës, të shoqerohet edhe me lejen e ushtrimit të profesionit të njohur nga institucioni i duhur Shqiptar. Për studentët e diplomuar në të njëjtat programe jashtë shtetit, duhet të paraqesin diplomën dhe lejen për ushtrimin e profesionit të njohur nga institucioni shtetëror përgjegjës.
3. Sugjerojmë që Institucioni të insistojnë për paisjen me regjistrat model për vlerësimin në vazhdim nga QSHA.
4. Sugjerojmë që të gjitha dokumentacionet në institucion duhet të jenë edhe shqip ashtu sic janë edhe italisht, pasi jemi në institucion shqipëtar dhe punojmë sipas legjislacionit shqipëtar të arsimit, pavarësisht bashkëpunimit me universitetin e Romës, Itali.

5. Sugjerohet që në rregullore të përcaktohen/ përfshihen tregues matës të plagjiaturës së punimit shkencor për mbrojtjen e diplomës së specializimit, ku niveli i ngjashmërisë së punimit të diplomës të jetë më pak se 30%.



Evaluation's conclusions for the third cycle in program Long-Term Specialization in "Gynecology and Obstetrics" offered by the Higher Education Institution Catholic University "Our Lady of Good Counsel"

Strengths and Affirmations:

1. Diploma with EU Standards: The long-term specialization program in "Gynecology and Obstetrics" is developed in collaboration with the University of Rome "Tor Vergata," Italy, offering a diploma that meets European Union standards.
2. Collaboration Agreements with National and International University Clinics: Specialized students have the opportunity to periodically carry out practical activities at the University of Rome "Tor Vergata" and at affiliated institutions under collaboration agreements.
3. International Career Opportunities: The diploma can be practiced not only within the country but also in EU countries, as the university has an internationalization strategy for professions.
4. Teaching in Italian Language: Offering classes in Italian promotes the dissemination of European culture in our country and the transmission of our cultural values on the international stage.
5. Qualified Academic Staff: The academic staff consists of professionals with internationally recognized diplomas and certifications, and extensive experience in the field of gynecology and obstetrics.

Weaknesses:

1. Lack of Sufficient Facilities for Professional Training: There is a lack of sufficient facilities within the institution to meet the professional training needs for students specializing in "Gynecology and Obstetrics" although the Catholic University "Our Lady of Good Counsel" has been operational since 2022.

Recommendations:

1. We suggest adapting the curriculum plan according to the criteria defined for the course subject report.
2. For foreign students, in addition to the complete documentation submitted in accordance with Albanian legislation for diploma equivalency, a permit for practicing the profession, recognized by the relevant Albanian institution should also accompany it. Students graduating from the same programs abroad should present the diploma and the permit for practicing the profession, recognized by the responsible state institution.
3. We recommend that the institution insist on acquiring model registers for continuous assessment from the National Center for Quality Standards (QSHA).

4. We suggest that all documentation in the institution be provided in both Albanian and Italian, as we are an Albanian institution and operate according to Albanian educational legislation, despite the collaboration with the University of Rome, Italy.
5. It is recommended that regulations define/include measurable indicators for plagiarism in the scientific work for the defense of the specialization diploma, where the similarity level of the diploma work should be less than 30%.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. KUADRI I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT SPECIALIZIM AFATGJATË				X
II. ORGANIZIMI, STRUKTURA DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT				X
III. BURIMET NË FUNKSION TË PROGRAMIT SPECIALIZIM AFATGJATË				X
IV. KËRKIMI DHE EKSPERIENCA KLINIKE /DIAGNOSTIKUESE				X
V. STUDENTËT				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË NË PROGRAMIN E SPECIALIZIMIT AFATGJATË				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X